

NUHI VESELAJ

M Ë S I M E

N Ë P Ë R P Ë S I M E

(shfaqje teatrore)

Prishtinë, tetor 1996

MËSIME NËPËR PËSIME

(shfaqje teatrore për shkollarë e mbishkollarë)

(1956 - 1964)

P a r a t h ë n i e

Gjatë periudhës së viteve 1956 - 1963, si mësues i ri, në aktivitetet e lira, në punën me nxënës në shkolla fillore dhe përgjithësisht, e kemi pasë praktikuar që së paku për çdo mbledhje të prindërve, përkatësisht me rastin e çdo solemniteti a tubimi të caktuar, të shfaqnim me nxënës ose me të rinjtë e të interesuarit përkatës skeçe, recitime etj., por herëpsherë edhe ndonjë pjesë teatrore, të gjitha këto në funksion jo aq të argëtimit sa në atë të mësim-edukimit, goftë shkollor, goftë atij të përgjithshëm shoqëror, tekste këto të cilat zakonisht i krijonim apo i modifikonim vetë ose në bashkëpunim me shokë. Si rezultat i një veprimtarie të tillë, si me thënë, "u lindën" dhe patën fatin të ruhen, si tekste vëllimisht më të vërejtshme këto 5 dorëshkrime, të cilat, tashti, gjithsesi të përpunuara, po i paraqiten lexuesit dhe dashamirësve të skenës me titullin **Mësime nëpër pësime** (shfaqje teatrore për shkollarë e mbishkollarë).

Ndonëse këto *shfaqje teatrore* janë shkruar për qëllime praktike thjesht amatore, siç u tha, pa pretendime që të jenë konkurruese nga ana cilësore stilistike e përmbajtësore në kuadër të zhanrit të vet, megjithatë nuk do të thotë se edhe nga këto pikëpamje nuk bën të vlerësohen. Për mendimin tim, për tematikën specifike dhe atë universale që trajtojnë, me mesazhin: *nga pësimet me nxjerrë mësim*, këto tekste, do të mund të shfrytëzoheshin po për të njëjtat qëllime si atëherë edhe aktualisht, edhe pse, jam i vetëdijshëm se metodologjikisht disa finesa të poentave ideo-edukative të shfaqjeve tashti mund të realizohen në mënyra më pak të imponueshme dhe gjithsesi me një transparencë tjetër paksa më të fshehur. Gjithashtu tashti ka mundësi që skenimi të përcillet me mjete përkatëse plotësuese bashkëkohore, siç veprohet b.f. me teknikën e teatrit të kukullave, të institucioneve filmike, siç janë aparatet audio-vizuele etj., teknologji kjo të cilën ne atëherë as që mund ta ëndërronim e jo më ta parashihnim të zbatuar në skenë.

Pothuajse të gjitha këto pjesë, përveç titullit të fundit, janë shfaqur tërësisht ose pjesërisht para publikut. Titulli i parë **Detyra**, me sa më kujtohet, është zgjerim i një dramatizimi të një pjese të leximit të klasave të ciklit të ulët të fillores. Së pari është luajtur në Grejçec, në natyrë të hapur para nxënësve dhe prindërve, pastaj në Duhël (Suharekë) në vitin 1957 me rastin e një tubimi masiv popullor. Po kjo pjesë është shfaqur në Shtimje në vitin 1959 si dhe dy vjet më vonë në Ferizaj, nën regjinë e aktorit Matej Serreqi.

Titulli **Statuja e çuditshme** është shfaqur disa herë, së pari në Mushtisht (1952), pastaj e modifikuar është shfaqur në Muzeqinë (Shtimje) dhe në Ferizaj (1961). Më duket se është një përpunim a zgjerim i një syzheje (skeçi) që e kisha parë të shfaqur më përpara. Sigurisht këtu del paksa me përmbajtje të zgjeruar dhe të modifikuar. Edhe titulli i tretë **Nëpër pësime mësime** që është përpunuar në Vojnoc (1958) është shfaqur për të parën herë në Muzeqinë, e pastaj edhe në Shtimje (1959). Pjesa dramatike **Nota e dobët** që propagandon bashkëpunimin shkollë - familje, ka filluar të shkruhet në Myzeqinë (1959) dhe është përfunduar në Ferizaj 1961, pjesërisht është luajtur nga nxënësit në Ferizaj po atë vit. Ndërsa pjesa e fundit **Jo shkulle po përngulle** ka filluar të shkruhet në Vojnoc, sipas idesë së kolegut Sulejman Mehmeti dhe është përfunduar në Ferizaj në vitin 1963. Për arsye objektive që lidhen me tematikën specifike që trajtohet në të, as që ka pasur mundësi ta shohë dritën e skenimit atëherë kur u shkrua, madje as deri në ditët e sotme, ngase autorit i ishte ndërprerë me dhunë aktiviteti me nxënës dhe përgjithësisht sipas etiketimit të ashtuquajtur: *papërshtatshmëri moralopolitike!*

Sidoqoftë, lënda e shtruar në këto "*shfaqje teatrore*" shpresoj se nuk do të jetë e pavërejtshme edhe sot e mot jo vetëm nga lexuesit e rëndomtë, por edhe nga profesionistët si dhe nga mësuesit e dashamirësit e skenimit të shfaqjeve të caktuara teatrore.

Prishtinë,
Me nderime,

tetor

1996

Autori.

DETYRA

(dramatizim për fëmijë)

Personat:

1. Fatmiri
2. Laci
3. Imituesit: 1) Qeni, 2) Zogu, 3) Bleta 4) Buburreci;
4. Pyllruajtësi
5. Fatosi.

/Pjesa mund të luhet, sipas rrethanave dhe mundësive, edhe në ambient të hapur. Sidoqoftë, skena paraqet një pamje të pyllit. Në skenë duket Laci (fillorist), i cili me një llastik dore merr në shenjë prenë, por para se ta tërheqë e shqetëson zëri i Fatmirit./

Fatmiri:

O Lac, o Laco, o Laco! !

(Laci nuk përgjigjet por jep shenja nervozimi. Ofshan pse e humb koncentrimin gjatë të marrët në shenjë. Ndërkohë Fatmiri e gjen dhe e tërheq lehtë.)

Uh Lac, u bë mirë që të gjeta! Ç'je bërë kështu si njeri i malit, pse nuk po më përgjigjesh. *(Laci i largon krahun rrëmbimthi.)* Ti edhe nuk po më flitke fare! Më thuaj ç'të keqe të kam bërë?

Laci:

A pak të keqe-a! Ma prishe koncentrimin. Më iku zogu. Sigurisht do ta vrisja e ti: "o Lac, o Laco"! Ç't`u desha unë?

Fatmiri:

Ua, pse po flet kështu! A s'paske tjetër hidhërim-a! Lëre zogun në qetësi. Asnjë të keqe s'ta ka bërë ai. Ti e di se ai është madje shumë dobiprurës. Ai është pastrues dhe zbukurues i pyllit!... Lër zogun në punën e vet. Lëri ato gjëra. Eja tashti të shpejtojmë për në shkollë, se koha po na ikën fort shpejt. Druaj se mund të vonohemi sot!

Laci:

Eh, edhe kjo jetë: shkolla, mësuesi, detyrat... Kryeje këtë, mos e bëjë atë!? ... Urdhëresa, ndalesa!... Këto gjëra ma kanë mërzhitur shpirtin! Dua të jem i lirë, plotësisht i lirë. S`dua urdhëresa, ndalesa, detyra! Dua të jem, si thonë, vetë pashë vetë subashë!

Fatmiri: *(Si me të qeshur, sa për shaka.)*

Po ti i lirë je, liria është fituar që kur përfundoi lufta!
E me pashë e me subashë mos na kthe shekuj mbrapa!

Laci:

Fatmir mos bën shaka. Kuptomë: *(E ngre zërin.)* **Sot fare nuk do të shkojmë në shkollë!** Madje fundi i fundit çka po na duhet shkolla! Dëgjo! Më ka lindur një ide: sot me bredhë të lirë në natyrë. Të dëfrehemi, të gjuajmë zogj. T'i pjekim mish në hell! Shkrepsë e kripë kam marrë me vete! I kam në çantë. *(Ia tregon.)* Shkarpa, dushka e krënde të thata ka mjaft pylli. A s'të pëlqen ty mish i pjekur i zoçkave!? He, Fatmir, folë!

Fatmiri:

Sa i çuditshëm që je! Çfarë fantazie! Po si, more, të harrojmë ne detyrën tonë: shkollën! Pikërisht për sot arsimtari i dituri - natyrës na ka thënë se do të na presë me një befasi. Eja të shohim se çfarë *surprize* na ka përgatitë ai!

Laci:

Ti edhe më i çuditshëm po më dukesh. S'ka befasi në shkollë. Në shkollë ka vetëm këshilla e fraza të thata dhe asgjë tjetër! Të gjitha këshillat gati-gati bajat m'u kanë bërë! Unë për sot kam vendosur të mos shkoj fare në shkollë dhe ti merre si punë të kryer këtë që po ta them. Madje dija për nder që po të pranoj në shoqëri për pa më dorëzuar lutje me shkrim! *(I afrohet.)* Dëgjomë! Në shkollë nuk po shkojmë fare, e kam llastikun, *(Ia tregon.)* gjuajmë zogj, e kam briskun presim shtaga, shkopinj, thupra ..., madje dhe diçka ... topin e kam marrë me vete! *(E nxjerr nga çanta një top llastiku gjysmë të shfryrë.)* E gjejmë ndonjë lëndinë të përshtatshme: luajmë top, çfarë të duash more shpirt! S'ke pse vret mend për gjëra të shkollës, bile sot për sot mos e bën llaf punën e shkollës! Po dëshirove mund të luajmë edhe pullash!

Fatmiri:

Ne mund të lozim lloj-lloj lojrash edhe në shkollë e sidomos gjatë pushimeve e pas mësimit, por, pikë së pari, s'duhet harruar detyrën që kemi si nxënës. Atje duhet të paraqitemi domosdo me kohë. Për nxënësin mësimi është edhe lojë edhe punë!

Laci:

Jo atje, në shkollë, thashë, nuk do të shkojmë fare dhe mos më fol më për të. Ti e di se unë nuk i luaj fjalët. Kam vendosur dhe pikë, jo dhe jo!

Fatmiri:

Lëri fjalët, mos të bëhemi shkas që për ne të përflasin *uuu e buuu* të tjerët. Unë jo se jo, nuk e lë pa shkuar në shkollë, po as ti s' bën pa ardhë me mua!

Laci *(E ndërpret.)*

E dija se ti s'ke zemër. Je frikacak. Ty po të bën uthull, qoftë nga shokët, nga mësuesi, qoftë nga prindërit, nga rrethi ... e ku ta di unë!

Fatmiri: *(I hutuar nga kjo e papritur)*

Si, si!...

Laci:

Ti mos më bën "*si, si*"?! Unë do ta bëj timen edhe pikë! Kurse ti duhet të më dëgjosh, nëse më ke shok, përndryshe prishesh me mua!

Fatmiri:

Lac, më kupto, të lutem!... Unë s'mundem... S'mund të ndahem nga shkolla, nga shokët! Si të gënjej prindët, mësuesin! Jo!...

Laci:

Ikë pra! Mos më bën *xër-xër* e *vër-vër* te veshi! Nuk jam ngushtë për ty!?

Fatmiri:

Po më dhimbsesh, ti po sharron keq. Për hiç gjë do t'ua prishësh dëshirën prindërve. A të kujtohet ç'na ka thënë mësuesi: Ai që nuk i ndjek mësimet me rregull në shkollë. Ai që i thyen rregullat e shkollës do të pendohet gjatë tërë jetës!...

Laci: *(E ndërpret.)*

Ai që mbyllet në shkollë nuk e gëzon jetën! Po dhe ti kot më flet, nuk të dëgjoj dot.

Fatmiri:

Shok i dashur mos u mashtro. Mos u ndaj nga shokët. Dituria fitohet në shkollë.

Laci:

Peshku në det, fulterja në zjarr. Dituria nuk është bar e fleta vetëm kap e mbush thesin e, atë bar e ato fleta, veç shko e merri nga shkolla e qitju dimrit dhive në grazhd e ato të japin pastaj qumësht?! Unë po të them: ti mos u ndaj nga unë e jo unë prej teje!

Fatmiri:

Askush nuk ka lindur i ditur, gjërat me vlerë fitohen me vullnet, dalëngadalë. Me punë të pandërprerë tejkalohet çdo vështirësi. Ne e kemi për detyrë që të përpiqemi deri në fund për dituri. Deri në fund, deri në fitore!

Laci:

Mjaft më, tashti po flet fjalë e llafe të huaja, të cilat as ti nuk po i merr vesh! Po më dhimbesh ti që po mundohesh ta shesësh mallin e huaj, por unë as që jam myshteri me ta ble atë mall. Koha e mirë është, pikërisht për ta gëzuar njeriu në natyrë të hapur. Prandaj vendimi im është i prerë: *sot do të dëfrehem në natyrë*. E ti fjalën "shok" për mue e paske pasë *falls!*

Fatmiri: *(E ndërpret.)*

Gjithkush dëfrehet dhe gazmohet në punën e vet. Për ne si nxënës shkolla është dëfrim, përparim, shpresë e lavdi e jetës. Eja të fton e mira të gëzohesh dhe ti me ne, me shokë, me shoqe! Se ai që kërkon të mos vijohet shkolla ai nuk është shok, po bën punë armiku! Ai është *falls* vetë!

Laci:

Tash dhe ti, vërtet, po flet fjalët e tjetërkuj. Fjalët tua të kanë humbur! Të thashë se nuk do të vij edhe pikë! Ma ke bërë trurin çorbëlinë. M'i turbullove mendt. Mos folë më se fjalët tuaja po ma shtojnë dhimbjen e kresë. Po më bëjnë që si ilaç me kërkue gjumin. *(E shtron pallton dhe bie.)*

Fatmiri:

Këtë s'po mund ta besoj, unë të vete në shkollë pa ty?! Po edhe kjo po u bëka!

Laci:

Unë të thashë ti rri me mua... e ti... shkollë se shkollë!...

Fatmiri:

Ta merr mendja, pa shkollë nuk mund të mendohet përparim as jetë e mirë. Ne duhet të mësojmë për të ditur dhe për të pasur fitim. Ne duhet të mendojmë dhe për ardhmërinë.

Laci:

Mjaft, pusho! Fjalë për të tashmen dhe për të ardhshmen mos më thuaj! Largohu prej këndeje dhe më lë të qetë. Ma rëndove kryet. Dua të flë. Dua ta bëj një sy gjumë rehat. Shko!

Fatmiri:

Po shkoj, po shkoj, por zemra po më dhemb!... Ty patjetër duhet me t`u mbushë mendja që në shkollë me ardhë sa më parë. Nuk jetohet larg shoqërisë. Eja tash me mua, ndryshe **do të më kërkosh**. Po të thërret e mira: eja në shkollë si bota e mos u kap punëve të kota!... Pa vonuar **ke me më kërkue!**

Laci: *(E ngrë kokën, gëlthet me të kanosur.)*

Unë me të kërkue ty?! Unë me ra në zor për ty?! Kurrë! Kurrë!... Ikë, shporrmu sysh! *(Nuk e ulë kokën deri sa Fatmiri nuk duket më.)* ...Iku, shyqyr! Çudi, sa mirë flet kopili. I mban mend fjalët si t'ishte mësues. Vërtet, është i shkëlqyer, po edhe mësuesit po i mbajnë pajë. Arsimitarët të gjithë e duan, ashtu edhe shokët! Besa edhe çikat! E ka vënë re sa ëmbël i buzëqeshin atij! S'di kush nuk e do?! Edhe unë e dua, por, me thënë të drejtën nganjëherë edhe i kam zili! Sot më është bërë mendja top nuk e dua dhe nuk e dua! Dhe kam të drejtë mos me e dashtë se ai nuk po më ndëgjon! Kush e lë shokun vetëm ai nuk është shok i mirë!... As lamtumirë nuk më tha!... Gjoja se është hidhëruar me mua! More unë jam më idhshëm në të se!... Qysh nuk e kapa ta shtrija plaf për tokë! *(I ngrë duart në pozitë si për grushtim.)* Atëherë kishte me më folë më urtë e butë. Te unë nuk ka vërrca-vërrca. Po-në e kam **PO** si dhe jo-në e kam **JO** të madhe, si burrat, si trimat! *(Mendohet pak duke e vënë gishtin në tamth.)* Vërtet, vetëm pa askënd s'kam se si të luaj, s'kam se si të argëtohem, po... Më mirë tash të mendohem ratë, symbyllur. Më e mira e së mirës është të bëj një sy gjumë, e pastaj shohim e bëjmë! Sa herë kotem më kthjellohet mendja. *(E mbulon kokën.)*

Pamja e dytë

/Skena po ajo, mundësisht jepen imitime si b.f. fërfëritja e gjetheve nga era e lehtë, gurgullima e përroit nga afërsia si dhe cicërrima e zogjve të pyllit. Atmosferë për të fjetur. Laci duket se është duke fjetur. Ndërkohë vjen Fatmiri vetë i katërt: janë dy shoqe dhe dy shokë. Mund të kenë maskat përkatëse ose secili fshihet pas një degëze me gjethe që e mban përpara në dorë. Ecin në maje të gishtave në mënyrë që mos ta zgjojnë Lacin. Pas pak dëgjohet (imitim) një e lehur qeni: Ham-kham-ham...!./

Laci: *(Si nëpër gjumë, pa e ngritur kokën flet.)*

He, more qen, pusho, mos ma nxir gjumin. Mos ma prish qejfin se po u çova të gjuaaj me gurë, të rrah me shkop! Por... edhe ty po të marr lakmi që po e ndien dhe atë që nuk e sheh. I lumi ti, përherë je i lumtur, je i lirë, s'ta lodhë kush kryet me detyra! I lumi ti i lumi. E shfrytëzon natyrën. Kënaqesh, shëtitesh kot së koti kah ta dojë qejfi!

Qeni:

Ham-kham-ham! Jo lumi unë, por lumë njeriu që di gjithçka. Unë njeriut i shërbej. Unë kryej detyrat që m'i cakton ai. Njeriu me shkollë e pushton tërë botën. Ai po sheh dhe po ndjen shumë e shumë më tepër se hunda ime! Kham-ham-kham! ... Njeriu ka hapur shkolla edhe për qen... e ti gjoja je njeri e shkollën e ke lënë! Turp të keshë! Kham-kham-kham! Unë nuk e kaloj kohën kot.

Laci: *(E ngrë pak kokën.)*

Si në përrallëza, m'u duk se më foli qeni. *(E ndjell me fërshëllimë)*, Kuto-kuto! Asgjë nuk pipëtin. S'ka qen as kurr gjë! Sigurisht më bënë veshët. *(Përsëri mbulohet; Fillon me kërrhatë. Pas pak fillon imitimi i zogut, ciu-ciu- cërr, cërr-ciu-ciu! Jepet incizimi ose imitimi i ndonjë zogu: cërr-ciu-ciu!... Laci sipërgjumshëm.)* Pusho zog! Mos më pengo. Dua të flë. Ti vetëm dëfrehesh kot. Nëse s'më lë rehat ta rrëfej punën ty me këtë llastik! *(E ngrë pak dorën, ngase llastikun e ka në grusht dhe përsëri mbulon kokën.)*

Zogu: *(Njëra nga imitueset.)*

Cërr-ciu-ciu, cërr-ciu-ciu ! Unë, vërtet, fluturoj dhe qëndroj nëpër druj e degë më degë, por nuk fluturoj ashtu kot, unë kryej detyrën time: Gjuaaj krimba, larva e miza që janë të dëmshme për bimë, kurse ti, alamet djali dhe nuk e kryen detyrën tënde! Nuk bën asnjë punë të mirë! Në këtë kohë të mirë! Vetëm rri e përpiqesh të flësh, kurse unë punoj dhe këndoj... cërr-ciu-ciu, cërr-ciu-ciu! Kot nuk rri, e ti?!... Turp të keshë! Ke bërë përpjekje edhe të më vrasësh! Turp të keshë!

Laci: *(Ngrihet me rrëmbim, njëherë ulur, pastaj në këmbë. Shikon rretheqark.)*

More ky vend mos qenka i mallkuar!? Mos qenka i zanuar e i shituar! - siç thonë plakat! Këtu një sy gjumë s'mund ta bëka qetë njeriu!? Si në ëndërr m'u duk se më foli zogu. Vend i mallkuar, i zanuar!...

(Pas pak qesh me zor.) Jo more! *(E prek kokën me duar.)* Unë bestyt dhe frikacak nuk jam. Gjërave të tilla nuk u besoj ... Me siguri ëndërr, por edhe dyshime plot e përplot jam mbushur! S'di çfarë po ndodh me kokën time. Në vend që të më pushojë dhimbja ajo gjithnjë e më shumë po më rëndon. Veshët po më ushtojnë, sigurisht për gjumë e kam. Si të kotem edhe pak të gjitha do të më kalojnë. *(E ngrë zerin.)* Kam vendosur me fjetë edhe pikë!

(Pas pak fillon imitimi i bletës.)

Bleta: *(Me maskën vizatim-blete ose e fshihur pas një çufrroje të vogël.)*

Zzzz-ë, zzzz-ë, zzzz-ë, zzzz!

Laci:

Ku shkon ti moj bletë? Pse s` më lë të qetë? Lumja ti, je mbretëreshë e lumturisë, bredh shetitësh lule më lule. Ti vetëm dëfrehesh! Sa mirë që bredh nëpër natyrë sa herë të teket, ashtu kot!

Bleta:

Vërtet, shëtis lule më lule. Jeta ime gjason me një lojë të këndshme. Po kjo lojë imja është punë... Gjithkush duhet të gëzohet në punën e vet me punën e vet. Por unë nuk bredh kot ashtu, por gjatë shëtitjes punoj: thith nektarin e ëmbël të luleve, e mbledh me kujdes dhe e çoj në zgjua për mjaltin që gjithkush e do aq shumë. Jam shërbëtore e vetvetes, e njeriut dhe e natyrës, sepse unë edhe shumoj lulet. E bëj natyrën edhe më të këndshme, më të larmishme edhe më të llojllojshme. Shkova se më presin shumë punë. Unë nuk bredh kot, a more vesh?! E ti ç`bëke këtu?! Mos, vallë, ti rrike kot? Po-a! Turp të keshë!

Laci: *(Ngrihet i hutuar.)*

More diçka po ngjet me mua. *(Shëtit andej e këndej, pas pak e mban kokën me duar.)* Unë kokën e kam në vend, ja mbi qafë... Veshët? *(I prek.)* - Po; sytë, po!; duart - po!; gjuhën - po! këmbët - po! Mirë po shoh, mirë po dëgjoj, mirë po ec, mirë po flas! Ç'është kjo që po ndodh me mua!? Mos po më shtiret ndonjë shpifje silugati, që po më flet kështu si me qenë një shoqe a shok klase! Pikërisht kështu po më shtiret disi! *(Pas pak qeshet me zor.)* Po këtu s'ka kurrfarë dreqi, qoftëlargi, s'ka zana ... exhina!... Çka po ndodh me mua kush e di?! *(Pas pak i kthehet vetvetes.)* Jo more Lac! *(I vë gishtin tëmthit.)* Jo more Lac frikacaku, mbaje

veten! Këtu s`ka shpifje fantazme! Vendi sigurisht pak me lagështi e po më shpifjen ëndrrat hala pa fjetë mirë. Ta ndërroj vendin. *(Zhvendoset pakëz më tutje.)* Jo more po unë nuk u frikohem askujt, aq më keq nëse filloj të frikohem nga ëndërrat e mia?! Ha-ha-ha ! *(Qeshet me zor.)* E dija veten se jam trim, po tash po e shoh se qenkam jo edhe aq. E them të vërtetën, ngapak edhe po më merr fllad përmbasa! Po s'di përse!... He more Lac, duhet të jeshë trimosh! Ti nuk frigohesh prej askujt, prandaj mos u friko as nga ëndërrat tuaja!... Edhe njëherë do të përpiqem të flë. Dhe pasha qiell e tokë! Pasha pemë e drunj! Pasha këto flokë e pasha këto duar! Pasha këta thonj... që i paskam pak pa pre!... Nuk do të luaj vendit deri sa të ngopem mirë e mirë gjumë. Në fund të fundit për inati të Fatmirit! Do ta mbuloj mirë kokën dhe s'do të dëgjoj më askënd, as ëndërrat e mia! *(Mbulohet mirë, dhe si fillon të kotet vjen "buburreci" /alias Fatmiri si imitues/ dhe lehtë - lehtë e prek në dorë dhe në fytyrë më një kashtë disa herë dhe tërhiqet. Laci reagon duke e shkundë dorën.*

Laci:

Edhe ty more buburrec të doli punë me mua! Kalo tjetërkah, mos u sill kësajtpari se po u çova ta ndrydh kokën, more mistrec! More punëkot! Herë ma prek herë cullakun e dorës e herë atë të fytyrës?!

Buburreci: *(Me maskën vizatim buburreci a fshehur pas një rrembthi.)*

Më falni, kujtova se mos është ndonjë coftinë! Nuk e besoja se njeriu i gjallë mund të rrijë shtrirë i vetëm në këtë kohë, në këtë vend, kur të gjithë kryejnë detyrat e veta!... Çuditë sidomos me zotëroten që nuk dija se unë kurrë nuk rri kot, por bashkë me shokët e mi punojmë pa u ndalë. Madje tërë familja ime punon dhe për atë e çojmë jetën me gëzime dhe jemi përherë të lumtur... Vallë, për ty nuk qenka turp e marre të shtrihesh në këtë vend kur të gjithë shokët dhe shoqet punojnë, lozin, argëtohen, qoftë në shkollë, qoftë në shëtitje të organizuara apo gjetiu, kur të gjithë kanë qëllim të caktuar, kurse ti na qenke njeri pa qëllim!?... Ua, nuk thuhet kot se pa punë as armikun mos e pafsha! Ika, s'mund të shoh kështu njeriun që bjerrka kohën kot! Turp të keshë! *(Tërhiqet me shpëjtësi bashkë me imituesit e tjerë.)*

Laci:

(Brof i hutuar) More, ç'më gjeti kështu!? Trupi po më dridhet. Këtu duhet të ketë hile, madje hile të mëdha!... S'mund të duroj më! *(Thërret me zë të lartë, pak si i trishtuar.)* O Fatmir, O Fatmiro! M'u shtir zëri i Fatmirit, ndoshta e kam prej mllefrit për shkak se më la vetëm! Më mirë të ikë nga ky vend! *(Fillon me i mbledhë plaçkat.)*

Pamja e tretë

(Skena e njëjtë, po në pyll. Mund të jepet zhurmë e llojllojshme, e pyllit edhe krrokatje korbash!)

Laci: *(Përsëri thërret.)*

O Fatmir, o Fatmiroooo!

Pyllruajtësi:

Hej, kush je ti more, që thërret kështu! *(Pyllruajtësi i afrohet)*

Laci:

Unë jam Laci. Jam një nxënës i...!

Pyllruajtësi: *(E ndërpret.)*

Po ç'bën ti këtu, pse je nda nga tufa. A mos të paska ra të fikët e tash paske ardhë në vete. Këtu është vend i ftohët, pasha bacën! Ju që po shkoni në shkollë po dini bukur shumë sende, po dëgjo çka po të thotë ky mixhoku ty: dy gjënave duhet ditun shyqyrin: shëndetit dhe punës. Shëndeti e bën njeriun të punojë, kurse puna e mban njeriun të shëndetshëm dhe të lumtur. Po shëndetin duhet me e ruejtë, sidomos atë shëndetin e mendjes. Për të të riun shkolla është puna më e mirë. Shkolla, more bacë, po t'i çelke sytë, edhe sytë e ballit, edhe sytë e dijes. Pa shkollë je si pa sy. Më mirë shpo sytë me therrë murrizi se sa të mbetesh pa shkollë. Unë shumë po ju marr lakmi tash ju të rinjve. Juve që kini shkollë dhe bjeshkën do ta njihni më mirë se ne që u rritëm dhe po plakemi në të. Tash sa i pashë do fëmijë që mblidhnin kandrra, dikush fleta, e .. dhe shumë u çudita! ... Po ty çfarë të ndau pre tyre!

Laci:

Po mbase edhe unë duhet të jem me ata, por ...!

Pyllruajtësi: *(E ndërpret.)*

Po-po, në këtë mot të mirë na është mbushur bjeshka me vocrrakë. Edhe mësuesit ishin me ta!... Bile u thashë mësuesve le të kujdesen se mos po ndez zjarr ndonjë axhami e kështu na shkon pylli!

Laci:

S`bëka me ndezë zjarr në pyll-a!?

Pyllruajtësi:

Po unë çka po ruaj. Unë e kam pushkën për me i vra dëmtuesit e pyllit, çka po kujton ti! Një xixë e vogël po iu fut dushkut të thatë ai merr flakë, hec e fike pastaj. As ushtria s`mundet me e shukë zjarrin e bjeshkës?!

Laci:

Nuk më ka shkuar mendja se në pyll nuk bëka me ndezë zjarr!

Pyllruajtësi:

He, sa duhet me dijtë njeriu! Ti hajt, pashë bacën, mos u ndaj prej shokëve? He, sa axhami kam pa unë! Mund të ju ndodhë ndonjë e papritur! Mos u shkepni, dhia që ndahet nga bylyku e ha ujku!
(Pyllruajtësi shkon dhe flet duke qeshur.) Ha ha ha! Mbaje mend me të gjetë ratë në pyll edhe breshka e zhapini munden me t'hangër e lë më dhelpna a ujku! *(Pyllruajtësi ikën pyllit.)*

Laci: *(Flet me veten.)*

Ujku e ha atë kafshë që ndahet nga tufa!? - këtë fjali e kam dëgjuar edhe më përpara!... More, çfarë u bë me mua?! Askush nuk po më lë të qetë... Fatmiri, ëndërrat (qeni, zogu, bleta, bubrreci) tash pyllruajtësi!... Kurrgjë nuk po kuptoj. Pyllruajtësi më tha se paska shumë nxënës këndeje! Mos!... *(Përsëri thërret):* O Fatmir, O Fatmir-ooo!

Fatosi:

O Lac, këtu qenke, të kam kërkuar gjetiu por të gjeta këtu!...

Laci:

Ç'të duhem ty Fatos, unë nuk i duhem askuj!?

Fatosi:

More, ti pse po flet përçart? Ç'ka ndodhur me ty. Si me u pasë çue jerëmnga gjumi! Fatmiri më tha se të gjejë këndeje dhe në bazë të fjalëve të tij erdha këtu. Tash tërë klasa do të kalojë dhiarës tutje dhe do të këthejmë me pushue tek ajo lëndina atje më poshtë. Ti a nuk paske mbledhë gjë-a! Mbase ke tubuar material po i ke lënë diku?!

Laci:

Po ju a për mua paskët ardhur-a! *(Gati me buzë në vaj).*

Fatosi:

Vërtet, çka ke, pse po shtireshe?! Në bazë të fjalës së Fatmirit, arsyeja pse ti i njeh shtigjet e pyllit mjaft mirë ashtu si edhe emërtimet e bimëve dhe të barnishtave, mësuesi të propozoj e ne pranuar që ti të bëhesh udhëheqës i grupit të *natyralistëve të rinj*, e ti?! Ti diçka po fsheh nga unë!

(Në këto çaste vjen Fatmiri.)

Fatmiri:

Lac ne arritëm. Sot në këtë shëtitje do të plotësojmë dhe pasurojmë herbariumin tonë të shkollës me insekte dhe me gjethë të ndryshme të pyllit vendës. Ku i ke lënë ti gjërat e grumbulluara?! *(Fatosi*

largohet Laci i afrohet Fatmirit.)

Laci:

Fatmir!... Unë asgjë fare nuk po kuptoj!?

Fatmiri: *(Me zë më të vogël.)*

Lac, të lutem, eja në vete. Ne sot në bazë të pëlqimit të mësuesit të dituri-natyres formuar grupin e *natyralistëve të rinj* a si miq të natyres dhe dolëm shëtitje jo vetëm për argëtim por edhe për të zënë krimba, buburreca e insekte të ndryshme e për të mbledhë gjethë bimësh të lloj-llojshme. Kjo ishte ajo befasia surprizë, që na e patë paralajmëruar arsimtari. Na tha se ky mësim është paraparë me program. Eja të shohësh "aparartet" që i kemi marrë me vete. Pos tjerash edhe shishe, fletëza mbështjellëse, alkool të fortë e mjete të tjera dezinfektuese, ballsamuese!

Laci:

Po unë si të vijë. E di ti!...

Fatmiri: *(E ndërpret.)*

Eja, more, se të kam shpëtuar ty dhe veten. Kur u ndava prej teje, mjaft u nguta, por u vonova pakëz. Sa arrita mësuesi na bëri me dije për këtë shëtitje. Unë i mbushur frymë ndërhyra se ti si *adhures i natyres* e kishe parandie këtë surprizë dhese pikërisht po na prisje këtu në pyll! Pastaj të zgjodhëm udhëheqës të grupit. Eja, tash mos u korit, përvishju punës edhe ti, të mbledhim sa më shumë gjëra me vlerë me të cilat do të pajisim herbariumin e shkollës! Unë diçka kam mbledhë, diçka mblidh edhe ti e pastaj shohim e bëjmë. Mësuesi nuk e di se çfarë tentove të bësh!? Vendtakimin tashti e kemi atje më poshtë, te ajo lëndina përtej përrockës. Eja, mos vono!

Laci:

Fatmir, eja të përqafoj njëherë. *(E përqafon.)* Më paske shpëtuar! Ma paske zbardhë fytyrën që desha vetes t'ia nxi. Me të vërtetë, ti e ke gjakun e ëmbël, të dashur.

Fatmiri:

Leri ato. Të mirë e të ëmbël njeriun e bën puna dhe pastërtia. Duke i kryer detyrat në bëhemi të mirë.

(Dëgjohet kënga e nxënësve.)

Fatmiri:

Eja, mos harrove gjë. Unë ika te shokët.

Laci: *(Mbetet vetëm.)*

Sa i ëmbël është Fatmiri. Sa shok i mirë. *(I nxjerrë plaçkat nga çanta.)* Këto gjëra nuk i duhen nxënësit *(Së pari e shkyen me brisk topin edhe ashtu copë-copë e hedh poshtë; llastikun e bën copë-copë dhe e hedh.)* Kësaj here s'di se si shpëtova, por tjetër herë s'kam me gabue më. *(Kthehet kah pylli dhe qielli.)* **Zotohem e betohem se do të jem i dëgjueshëm dhe i kuptueshëm si i ka hije nxënësit. Do t'i ndjek mësimet me rregull, do të jem i pastër.** Nuk do të ndahem nga shokët e mirë shkollarë!

Fatosi: *(Dëgjohet nga larg.)*

Lac, eja prina shtigjeve të kërkimit!

Fatmiri: *(I dëgjohet vetëm zëri.)*

Shokeshoqe, nxënës shkollarë,
Për me qenë në mësimet të parë
Duhet kryer si çdo detyrë
Dhe mësim-shëtitjen në natyrë!...

(Bie perdja) (FUND)

Grejçec (Duhël - Suharekë), prill 1957)

SHTATORJA E ÇUDITSHME

Personat:

1. Xha Moni (pronar i statujës);
2. "Shtatorja" (Musë Shakaxhiu)
3. Pastruesi
4. Tre fëmijë
5. Fotografi
6. Vasha
7. Mësues-poeti

Pamja e parë

/Ngjarja zhvillohet në oborr-parkun përballë rruge të shtëpisë së Xha Monit, pasanik (profiter i dyshimtë!), blerës i shtatores. Në një kënd është vendosur Statuja e mbuluar me çarçafë, por në atë mënyrë që koka dhe gjymtyrët të mund të zbulohen dhe të lëvizin pa vështirësi. Statujën në fillim mund ta imitojë (i maskuar) edhe ndonjëri nga "aktorët"./

Mësues-poeti: *(Pasi e shikon mjaft me interesim statujën.)*

Jam i porositur nga Xha Moni që një tekst-poezi t'ia kushtoj kësaj statue, por këtë s'mund ta bëj dot, ngase kjo vërtet nuk ka kurrfarë përmbajtje të meritueshme. Dihet se shtatore (statujë a trupore) i kushtohet ndonjë shëmbëlltyre historike të dalluar, qoftë kombëtare atdhetare a familjare, qoftë kulturore të karakterit universal e ... kjo statujë, siç po shihet, sipas çdo kriteri që ta vlerësosh del e papërcaktuar. S'di njeriu çfarë mbishkrimi a titullimi t'i vërë e jo më të shkruajë këngë-poezi për të! Si duket, ata zotnajtë e përtej detit, ia kanë shitë Xha Monit një plaçkë jo aq me vlerë. Me fjalë të tjera ky e ka gëlltitë, pa ia kuptuar mirë domethënien. Shihet qartë se Xha Moni ka vepruar kështu nga fodullëku, vetëm sa për t'u lavdëruar zotërotja e tij para të huajve si dhe para nesh këtu, gjoja se ai si njeri i civilizuar, si qytetar i parë e fisnik që është do ta "hijeshojë" oborr-parkun e tij në këtë qytet me një simbol: shtatore të arrirë! Me sa po shoh unë, kjo statujë, nëse nuk përpunohet, vërtet nuk ka vlera, prandaj as pronarit dhe as qytetit nuk do t'i sjellë kurrfarë nderi. Kjo është arsyeja që në vend të lavdërimit Xha Moni ka "fituar" përqeshje të meritueshme, sidomos nga Musë Shakaxhiu! ... Më duket se po vjen dikush! Më mirë për mua është të largohem që këtej pa u vërejtur, mënyrë kjo e mirë për mua për t'iu shmangur zënkave me Xha Monin!. *(Del, ndërkohë vjen Xha Moni.)*

Xha Moni:

Jam tejet i gëzuar në këto çaste. (*Fërkon duart dhe qesh me të madhe.*) Ha-ha-ha! Dy dëshira m'u kanë plotësuar po sot: e para, *Statuja* për të cilën ka kohë që jam lavduar se ka me më ardhë, më në fund, ja arriti dhe e dyta, ia kam dredhë *Musë Shakaxhiut*, hajgarexhisë e pijanecit më të njohur të qytetit tonë... (*Përsëri qeshet dhe duke mos mundur të ndalë gazin rrëfen.*) Për Statujën dhe vlerën e saj si dhe për punën time si veprimtar të parë të kulturës në këtë qytet, sigurisht ka me folë historia, ndërsa unë do t'i them dy fjalë për Musën dhe si u hakmora në të! ...E gjeta Musën të dehun tapë. Ha-ha-ha! I dhashë edhe pak të pijë! E trulloja edhe më mirë! Pastaj?!... Ee!... Pastaj e rehatova qysh e meritonte! Ha-ha-ha! Në vend se ta çoja në shtëpi të tij, i thashë se po të çoj në sallonin e shtëpisë sime. E gënjeva rrast, e çova jo në sallon po ... në ahër! Po-po, në ahër të kalit tim! Ha-ha-ha! Ia hoqa rrobet, ia fsheha... Ha-ha-ha! Dhe e vuna ashtu të flejë në grazhd. E kam mbulue me plaf të kalit dhe... Ha-ha-ha!... ai tash sa kohë po i kënaqet gjumit! Kur të bëhet solemniteti i përrurimit të kësaj Statuje, në valën e koktejit, do t'ia heq pijen tue ia derdhë një kove ujë të ftohtë fytyrës, trupit. Dhe pastaj?! Ha-ha-ha! Ashtu ... qullumak, do ta sjellë këtu "pehlivan me kocka jashtë"! Oh, sa gazi i madh ka me u bë në hesap të tij! Ha-ha-ha!... Do të thoni se mos më idhnohet! Punë e madhe! Lehtë e kam me të! Do ta qeras me një gotë raki dhe... Ha-ha-ha!... Kështu e ka rakixhiu! (*Qëndron pak dhe vazhdon.*) Po pse ia bëra këtë mund të pyesni! Kam arsye të forta të hakmerrem kështu! Sepse ky farë shakaxhiu s'e këqyr hallin e vet, por po bëhet vegël e atijfarë mësues-poetit tonë, i cili edhepse, për punën që bën, me rrogën që merr, mëzi arrin të sigurojë bukë për vete e për familje e sa për veshë e mbathë mos të pyesim fare. Ai po shitet si i kulturuar, po më përzihet në autoritet!... Ky farë mësues-poeti, edhepse e luta me një bakshish të majmë, jo vetëm s'deshti me ma ujdisë një këngë për këtë vepër monumentale që e kam bërë për me e hijeshue qytetin, por si fshehtas po më merr nëpër gojë dhe po lëshon romuze kundër meje, gjoja se... (*I shqipton fjalët me ngjyrim diksioni si të mësues-poetit.*) *Statuja* duhet të simbolizojë diçka të madhe, goftë nga historia e familjes, goftë nga historia kombëtare a universale e jo sa për me thënë, prandaj kjo duhet të përpunohet, të ndryshohet e vetëm pastaj të përrurohet! (*E rikthen ngjyrën e zërit.*) Po ama edhe Musa ka faj pse po bëhet vegël e tij! Ai po ma këndon një këngë me thumba që si duket ia ka mësue mësues-poeti! (*Qeshet.*) Kënga fillon kështu:

*O more Mon, o Mon Kuleta
Shumë po vuen për mendt e shkreta!...*

Do ta shohim kush i ka mendt më të shkreta, unë apo ata! Kësaj

radhe po ia dredh Musës, e... atij mësuesit, nëse nuk ma shkruen këngën qysh due unë, tjetërherë! Ata do të vuanjë për mend e jo unë! Edhe pak përpara e kërkova mësues-poetin gjithkrah, në shtëpi, në shkollë për me m'i shkruer fjalët e përurimit, po s'e gjeta kund. E kishte lëshuar toka! Do t'ia kallëzoi qejfin atij, veç sa ta shti në dorë!... Është e vërtetë, se unë po kam qejf me më dalë nami i mirë, me më përmend historia për të mirë. Këtu s'ka kurrfarë të keqe apo jo?! Ha-ha-ha! Kush është ai që nuk e do famën! Unë bashkë me këtë Statujë veç po hy në histori, prandaj s'duhet kurrkush me më xhelozue, apo jo?! Ha-ha-ha! (I afrohet statujës.) Pyh, sa pluhur i paska rënë. (E shtynë ngapak me dorë.) Këtë duhet me forcue. Më thanë me pritë për ta çimentua, për t'i vënë datë e mbishkrim e ku ta di unë, po mua nuk po më pritët!... Ehua! Deri sa të formulohet titullimi a mbishkrimi, derisa të bëhet ndonjë përmirësim etj. po ikën koha. Shpirt po bajmë, hej!... Sot thashë, sa i ka miqt e largët këtu, ta shpallin të përuruar e pastaj shohim e bëjmë!... Më duhet tash për tash me e gjetë një pastrues që t'ia heqë sadopak pluhurin dhe ta rregullojë paksa vendin rretheqark, kështu që ky vend historik të ndrijë nga pastërtia! E le të thotë mbasandej Musa: Statuja e pistë e pareve të pista! (Përsëri qesh.) Ha-ha-ha! Do të kënaqen të pranishmit kur ta shohin Musën si *pehlivan me kockat jashtë!*... Le të guxojë ai përsëri me më përqeshë me ato fjalët e mësuesit. Musë thuthuqi, kur flet zë në thue, bën: thu-thu-thu e bu-bu-bu! - në anën tjetër nuk i zë vendi vend: (E ndryshon paksa zërin.)

*Eu, ky Mon Napoloni, ky Mon kuleta
Ka pare shumë, po mendt e lehta!
Ka ble statujë sall me u lavdue ndër burra,
po që s'merr erë fare për nga kultura!*

(Flet inatçe.) Kaçiku i tij me më përqesh mue! Ai farë thuthuqi e bubuqi.
(Përsëri e bën zërin si të Musës.)

*Mon Napoloni ka pague këtë statujë veç me rritë mendjen e jo për
t'i shtuar vlerën kulturës së qytetit tonë!* (Tërë gaz e normalizon zërin.)

Ha-ha-ha! Po kush ka meritë që t'i bëhet bustë a statujë në qytetin tonë përveç meje?! Me ia bë një hoxhe, idhnohet prifti, me ia bë priftit idhnohet hoxha. Besa, për do punë të mëdha edhe hoxha edhe prifti po i shtinë veshët në lesh! Me ia bë bajraktarit idhnohet pleqnari; Me ia bë një pleqnari, idhnohet politikani!... Me ia bë një të dekuni ai s'ka se si me më falenderue. Me ia bë një të gjalli, ku me dijtë se qysh do të sillet në të ardhmen me mua, ndoshta më idhnon!? Me ia bë vetes?! Është mirë, por po thonë ende është herët! Më mirë thashë mos ta emnoj fare. Miqt e përtej detit

më thanë bleje këtë, kështu të gatshme se për bustin tim personal duhet porositë, ai do të bëhet më vonë! Unë për mos me u kthye duar thatë e bleva këtë. Mësues-poetit kjo s'po i pëlqyeka! Dynja e parehatueshme: jo ashtu po kështu, jo kështu po ashtu, gjuha prej tuli!... Tash për tash po shkoj për pastruesin. Po po, miqt e përtej detit po më thonë se për këso vepre madhështore sigurisht duhet të më kushtohet këngë e vërtetë lavdërimi e jo si ajo e Musës. Unë s'due me pritë deri sa të më përmend historia më vonë. Unë po due që tashti me m'u këndue kënga! Me ndie me veshët e mi! Tek e mbramja do të paguej diku e dikë për me ma qitë këngën se e meritoj apo jo?! Ha-ha-ha!

(Del.)

Pamja e dytë

(Ndërkohë në skenë paraqitet një njeri vetëm me brekusha veshur dhe i hutuar prezentohet. Ka të folur (diksion) karakteristik flet si me thë-thë.)

Musë Shakaxhiu: (E mban kryet me duar.)

Hej, Musë, Musë, kuku për krye tënd e për mend që s`pate! Nuk thuhet kot: kush përqesh vetë e vesh! Sall pse e mora nëpër gojë Xha Monin, apo e shihni se çka më gjeti! O bobo, as hasmin mos e pafsha në këtë siklet! (Ndalet pak, i vë gishtin kokës.) Po më kujtohet si nëpër ëndërr. Po vetë, ai Mon Napoloni, parelia, më ka gjetur të dehur tapë. Në vend se me më çue në shtëpi ai më ka hdënë edhe më raki dhe më ka shtri të fle në ahurin e kalit të tij... Po kali, faleminderit prej tij, si më ka diktue aty ka nisë me më tërfatë e me më lëpi fytyrës e trupit, fytyrës e trupit... deri sa ma ka nxjerrë pijen! Po ... rrobot, vallë, ku do të m`i ketë fshehë ai Hahaha trashamani?! Në ahur e rretheqark i kërkova, nuk i gjeta! Si t'ia bëj unë i shkreti!? Si të shpëtoj nga kjo situatë!? Sigurisht pa më përqeshë e pa më ngjeshë, pa më poshtnue mirë e mirë s'do të m'i kthejë rrobot!... Eh moj raki, raki e shkretë!... Më marrose, ma more fytyrën!... Nuk durohen fjalët e hallkut e as ato shakatë e Xha Monit, i cili s' di me qeshë si qesh bota, po di veç me bë: Ha-ha-ha!... Mirë thotë fjala: "Rakia edhe xhepin ta shter, edhe fytyrën ta merr!". Pikërisht kjo më ndodhi!... Mos me më pasë lëpi e tërrfatë kali i Xha Monit sigurisht hala do të isha shtritë atje! E tash?! (I mëshon kokës së vet.) Hej, ti moj rradakë a je kungull a je kumbull. A ke fara a bërthamë brenda! A mos je bosh?! Nëse ke brenda vetëm kashtë më mirë t'i jap fjakë le t'i dalë tymi jashtë! Hajde bën diçka, oj kokë! (E shikon shtatoren, fillon ta imitojë.) E hëëë! E gjeta! I lagëti për shi s'ka dert! (Sillet rreth statujës dhe fillon t'ia heq ngapak çarçafin. Statuja lëkundet.) Kjo rradaka ime ka bërthamë jo kashtë! E gjeta: ai mue, unë atij! (E bart shtatoren në anën tjetër përtej binës dhe vetë zë vendin si statujë.) More, s'di sa do t'u bjerë në sy kjo lojë! Por le të dalë ku të dalë! (E vë maskën, çarçafin, merr pozitën sikur Statuja që e hoqi dhe flet.) Ja a u bëna **statujë e çuditshme**?! Sigurisht jo më e çuditshme dhe më me pak përmbajtje se ajo që e ka ble me napolon - ari Mon Hahaha-ja! (Përsëri i drejtohet publikut.) Shët, se po më duket se po vjen dikush. (Gjithnjë qëndron si statuja që e kishte e hequr më përpara.)

Pamja e tretë

/Ndërkohë hyn Xha Moni me pastruesin./

Xha Moni:

Ja këtë do ta pastrosh. Ti e di qysh duhet. Ha-ha-ha! Unë di veç me të pague edhe me të thënë se duhet ta bësh punën sa më mirë! Vënia mirë çarçafin në fund, mos harro! *(Para se të ikën i drejtohet pastruesit.)* Dëgjo, kam ftuar zonja e zotnij edhe nga jashtë për këtë solemnitet. Ka nga të ftuarit miq të pushtetit e të kulturës. Ata njëherë i pres në sallon të shtëpisë, po këtu në natyrë kam ndërmend ta shtroj një koktej sa modest sa madhështor. Mundesh edhe ti me u ndalë. Tashpërtash pasi ta pastrosh Statujën duhet me shtrure tavolinën, mbasandej duhet me i heqë trellat që mbesin. Mos më ik pra. Unë do të paguej mirë! Ha-ha-ha! Në fund do ta jap një bakshish të majmë!

Pastruesi:

Po Zotni, po unë jam njeri fukara, dua të më paguajsh bile pakdiçka më përpara, t'u çoj njëherë bukë fëmijëve dhe të blej sapun për me e pastrue këtë. Pastaj shohim! Më kanë thënë se ty të dhimbsen shumë paratë për hyzmetqarët, pasi të kryhet puna, pale!

Xha Moni:

Të ka mashtrur kush të ka thënë ashtu. Ha-ha-ha! Jo, unë jam dorëlibër. Ja diçka po të jap menjëherë, kurse bakshishin prite pas koktejit. *(Ia jep ca të holla.)*

Pastruesi:

Faleminderit! Faleminderit!... Po unë s'di çka është ai farë kokteji, qysh duket?!

Xha Moni:

Ha-ha-ha! Kokteji është zifafet me sytë e zi, more! Ha-ha-ha! Sot jam shumë - shumë i disponuar. Më ka dalë interesi mjaft i leverdishëm nga Banka! Madje me natën e sotme unë po hy në histori, si njeri i kulturës! Rrofshin miqt, rrofshin paret e depunuara! Ha-ha-ha! *(I jep sërish edhe ca të holla.)* Mos harro nëse punon mirë bakshishin do ta keshë jo pak të majmë! Unë po shkoj se mos dikush nga të ftuarit më ka ardhë në shtëpi nga hyrja tjetër. *(Niset por ndalet në çast.)* Ah po, përpak harrova! *Sërish i drejtohet pastruesit.)* Ha-ha-ha! Nëse vjen një fotograf me një vashë, bukuroshe, thuaju le të më presin këtu. Po ashtu nëse vjen ëmbëlsirashitësi edhe atij thuej le të presë këtu me ëmbëlsira.

Pastruesi:

Ani Zotni, ani!... *(Kthehet kah shtatorja.)* Po kjo!... *(E shikon dhe e prek ngapak, edhe në vende delikate. "Shtatorja" paksa reagon sa për të zgjuar kërshërinë e publikut.)* O zotni Moni, ndalu pak! Po kjo mos është send i gjallë, Zotni!... M`u duk se lëvriti!

Xha Moni: *(Kthehet dhe qesh me zë.)*

Ha-ha-ha! Po kjo është **statujë**, more hej! Statuja s`ka si të jetë e gjallë! S`ka se si të lëvizë. Po mos e shtyej shumë se hala bazën s`ja kemi forcue qysh duhet... *(Kthehet nga publiku,)* Sa çudi me njerëzit tanë të thjeshtë: fukara nga malli, fukara nga mendja! Ha-ha-ha! Nuk janë mësuar me statuja. E sa kam pa unë në botën e jashtme: statuja, piktura! Ehya!

Pastruesi: *(E shplon pak çarçafin. Prek ngapak nyjet e shlirshme.)*

Çudia e zotit, edhe mua po më duket si me qenë njeri i gjallë! Po shkoj me i marrë almiset e mia. *(Del.)*

Xha Moni: *(Edhe ky e shplon pak sa për ta shikuar.)*

Vërtet, duket si njeri i gjallë!... *(E mbulon përsëri, por tash e prek ngapak me bastun nga jashtë.)* Hej more hej, çka bëka arti! Për ata mjeshtrit e tillë quhen artistë, piktorë a skulptorë, s`di si u thonë, po veprat e tyne, ama, gjithmonë u rrinë si të gjalla. Kujtimin e përjetësojnë!... *("Shtatorja" përpiqet të mos luajë vendit, kur Xha Moni e ngacmon me shkopin e tij, madje edhe duke i rënë ngapak. Pas pak Xha Moni, del.)*

"Shtatorja" (Musë Shakaxhiu): *(Ofshan thellë.)*

Ufa, shyqyr, shpëtova kësaj radhe! Nuk më njohu Hahaha-ja!

Pamja e katërt

(Skena e njëjtë. Vijnë tre fëmijë jo dhe aq të vegjël, që në lojë e sipër ngrehin ca talla e shkopinj duke i imituar si dikur "kuajt" dhe bëjnë gara se cili di më mirë ta lavdërojë "kalin e tij".)

Fëmija I:

Ja unë si di edhe tash ta lavdoj "kalin" tim: Dio, dio, hajde Gjok, të qes, baca, taxhi me okë!

Fëmija II:

Ndërsa unë: Hajde Allxho, dio-di se të ka, baca, për hijeshi!

Fëmija III:

Edhe unë: Hajde Dori, hajde Arap, ke me dalë më i pari në vrap!

Fëmija I: *(Ndalet para Statujës.)*

Ua, sa interesant, shihni, shihni se ç'farë trupore ka ble Xha Moni! *(Të gjithë ndalen, e shikojnë.)* I ka ardhë sot prej së largu. E ka ble, po thonë, me pare të majme vetëm e vetëm për me i tregua botës sonë se ky është më i kulturuari i qytetit!

Fëmija II:

Pare të majme, po ato pare po thonë i ka fitue në mënyrë pak si "të lehtë" jo të ndershme. S'dihet se si, po ai ka deponue kështu si ortak në bankë të huej shumë napolona-ari e tash i ka dalë fitim-interesi shumë i madh!

Fëmija III:

Ndoshta edhe ka punuar atje diçka bashkë me ortakun e pastaj pasurinë e vet e ka shitë! Ndoshta ka fituar në lotari. Ndoshta i ka shërbye dikuj gjatë luftës! S'dihet, ndoshta edhe i ka zhvoshë diku! Nuk dihet!

Fëmija I:

Ndoshta! Po, sidoqoftë, ai ka të drejtë me u lavdue, - ka thënë baba im,- se edhe është më i zoti se të tjerët. Është gjindur në situatë. Kush ka pare ka të drejtë edhe me shitë mend, me shitë kulturë! *(I afrohet shtatores.)* A është prej gjipsi, argjili a prej bote së pjekur! *(E prek ngapak.)* Po kjo vërtet qenka e butë dhe e nxehtë si njeri, prej kocke e prej tuli!

Fëmija III:

Jo ore, është prej guri a prej bronzi me ngjyrë njeriu! Kështu

kanë thënë. *(E prekin ngapak, i shtinë gishtat edhe nën çarçaf; "Shtatorja" reagon, bën grimasa, jep shenja qesharake të cilat publiku i heton lehtë.)*

Fëmija I:

Po ky qenka si njeri, i gjallë, i butë, i ngrohtë! Nuk qenka gur. Qenka baltë e butë, po pse e ngrohtë, ore!

Fëmija II:

T'ia shti tallën në sy, këtij farë lloçi të papjekur mirë! Çudi, po pse s'po rrëzohet, pse s'po copëtohet?! T'ia bëj një vrimë me shkop! T'ia lë një shenjë! *(Tenton me majë të shkophit.)*

Fëmija III:

T'ia pres gishtin me brisk a ia lë shenjë! *(E nxjerr briskun. "Shtatorja" mbrohet nga fëmijët duke dhënë shenja të çuditshëm. I bën shikuesit të qeshin.)*

Fëmija I:

Ikni se po na ha! Ky qenka dreq, lugat! *(Statuja lëviz!)*

Fëmija III:

Eja ta gjuajmë, këtë besheret!

Fëmijët:

Ky qenka dreq! *(I mëshojnë me tallë (thupra) dhe ndonjëri me ndonjë copë dheu a guralec.. . Statuja reagon domosdo.)*

Pamja e pestë

(Ndërkohë kthehet pastruesi.)

Pastruesi:

Ikni more dreqën mos ma ndyni statujën?! Kush ju ka lejuë me hy në oborr të huej! (Fëmijët ndalin ngacmimet.)

Fëmija I:

Po kjo nuk është shtatore!

Fëmija II:

Është vetë dreqi i gjallë me fytyrë të çuditshme!

Fëmija III:

Rueju prej këtij lugati të ditës!

Pastruesi:

Ikni more, ju jeni dreqën të natës e të ditës se kjo është diçka e shenjtë! Kjo do të na hijeshojë qytetin tonë për jetë! Unë ia di për nder kësaj statue se kjo u ba sepse e unë mora pare nga zotni Moni që e njohim të gjithë si koprac të madh. Por për sot, mos qoftë për kob, e kish çelë zemrën! Ishte bërë shumë i mëshirshëm. Në qoftë kysmet do të marrë madje edhe një "bakshish" të majmë pas atij "koktejit me sytë e zinj!" të tij! Ikni, shkoni!

/Fëmijët ikin pastruesi fillon ta punojë: një herë me fshisë mbi çarçaf, pastaj vende - vende edhe nën çarçaf me sfunjjer (a rube) të lagur me shkumë-sapuni që e merr nga një kusi me ujë. "Shtatorja" natyrisht reagon: nganjëherë bën grimasa të ndryshme që bën të qeshin publiku. Në momente kur pastruesi shkon kah kusia për ta lagur sfunjjerin a arrnën statuja e shtyn nga mbrapa. Pastruesi gati rrëzohet, por nuk dyshon. Kjo përsëritet disa herë! / Po pushoj pak se m`u duk se rrëshqita. /E shikon statujën ajo nuk lëviz fare. Pastruesi këndon si nëpër hundë duke e shikuar statujën.)

Moj e mira që shkon me dhen-e...

nuk po të lutna, për asnjësend - e...

Se asnjësend paska ble Moni,

Po i rrrnofte kuleta, napoloni!

(Përsëri vazhdon ta pastrojë me fshesë fytyrës etj.)

Zotni Moni sigurisht do të më japë bakshish për këtë punë. T`ia pastroj më mirë, bile këtë farë face t`ia sapunoj! *(Por sa herë i kthen shpinen "Shtatorja" e shtyn dhe bën grimasa të çuditshme. Pastruesi fillon të dyshojë, madje dhe të frikohet... Kthehet kah publiku.)* More, ja unë s`jam sot diçka në rregull, ja këtu ka diçka të çuditshme!? *(Shtatorja e shtyn më me forcë, ai rrëzohet.)* Kush më shtyni?! Ç`është kjo që po ndodh! *(Shikon anash.)* Askush nuk është!... *(Përsëri e shtyn "Shtatorja", ai rrëzohet. Mundohet ta fshijë përsëri. "Shtatorja" e shtyn disa herë kështu.)* More ky farë sendi qenka vërtetë vetë shejtani! Mirë e patën fëmijët. Fëmijët janë vetë melaqe, janë pa sherr! Ata e paskan pa këtë send që është dreq! Ky qenka, me të vërtetë, mallë për dreq. Të ik sa më parë

prej tij. Nuk dua as bakshish as kurrgjë, veç të shpëtoj nga ky farë hukubeti!... Mjeri ai që pushon në këtë farë parku! Mjer zotni Moni që ia ka ble vetes lugatin me pare! Me dorë të vet do ta vrasë veten?! Mjer qyteti për këtë farë shenjë dreqi! Nuk po e pres as fotografën, as atë farë vashën bukuroshe, madje as ambëltarin! as at farë koktejin me sytë e zinj! as bakshishin e majmë!...

"Shtatorja": *(Ndërkohë ia derdh kusinë, por ai e kap para se të zbrazet krejt dhe ia hedhë ujin e mbetur në fytyrë. I rregullon çarçafin dosido edhe ikën. "Shtatorja" pasi e heq shkumën nga fytyra (maska) dhe përsëri merr qëndrimin si statujë, ngase duket se dikush po afrohet.)*

Edhe prej këtij shpëtova, e tash ku me dijtë se në çfarë sprove kam me ra?!

Pamja e gjashtë

/Në skenë futet fotografi me një vashë./

Fotografi:

Sa pamje e mrekullueshme, shumë joshëse.

Vasha:

Pamje piktoreske! Sa kam dëshirë të kem një foto nga një ambient i tillë. Një foto-kujtim pranë Statujës së parë *grandioze* që erdhi në qytetin tonë!

Fotografi:

Po bukuroshe menjëherë për hatrin tënd po shkrep jo një pozë, po më shumë! Merr qëndrim pranë statujës, buzëqesh, të lutem! ... Ashtu!

Vasha: *(Pozon pranë statujës, buzëqesh. Statuja bën grimasa të përçudshme ndaj bukuroshes.)*

A jam mirë! A po dukem bukur?!

Fotografi: *(Shikon në objektivin e aparatit.)*

E mirë je dhe mirë po rri, tash buzëqesh! ... Ashtu!... More!!... Por... disi po më duket se po lëviz Statuja! Diqysh si me dashtë me të hangër! *(Kur ky shikon statuja drejtohet. Pas ca qastesh përsëri shikon në vrimëzen e objektivit.)* Mbase me mue, me sytë e mi, ja me aparatin tim, diçka s'është në rregull! S`di mbase po më bëjnë sytë apo vërtet po lëviz statuja!... Mbase bukuria jote po më mahnit! Mbase xhelozia! *(Afrohet tek ajo. Mundohet ta rregullojë, t'ia përshtat profilin në harmoni me pamjen e statujës, mirëpo kur shkon me e shkrepë "Shtatorja" përsëri ndryshon qëndrimin, e nxjerr gjuhën etj.!... Nga veprimet e tilla bën të qeshet publiku, gjë që fotografi habitet shumë dhe kjo e bën nervos. Më në fund shtyp sustën.)*

Me shëndet! *(Dhe fill shkon me vajzën e ulet në një ndenjësë dërrase jo fort larg statujës. Bisedojnë kokë më kokë. Aty pranë duken edhe disa karrige dhe një tavolinë, por jo të vendosura sipas rregullit. Ndërkohë vjen ëmbëltari.)*

Ëmbëltari: *(Reklamon me zë.)*

Tullumba, karamele,
llokume, sheqere!
tespishte, furulldak,
të mira për merak!...
Ja, këtu, ëmbëlsira,
sa t' shijshme, sa të mira!...

(Fotografi me vajzën e ftojnë. Ai u afrohet ata blejnë diçka. Fotografi paguan. Ëmbëltari vazhdon t'i përsërisë fjalët reklamuese dhe ulet në bazamentin e statujës. Fillon t'i njuhë të hollat. "Shtatorja" mundohet me ia "vjedhë" ndonjë para, por nuk mund t'i mbërrijë. Pastaj tenton të mbërrijë tepsinë. Atë pak e afron me këmbë. Nga tepsia që e ka lënë ai pak si mbrapa, kap pa vështirësi ndonjë copë ëmbëlsirë. Këtë e vëren qartë publiku, ndërsa ëmbëltari jo, i cili flet.)

Kam fituar sot bukur mirë, por si më tha Xha Moni duhet me sjellë këtu edhe më shumë ëmbëlsiqe të llojllojshme. S`di sa mund t'i besohet atij! *(Përsëri fillon të reklamojë.)* Ëmbëlsira, ëmbëlsira - sa të ëmbra

sa të mira!... Të shohë sa copë i shita nga kjo tepsi. *(Fillon me i njuhë... Ndërkohë "Shtatorja" merr edhe copa të tjera ëmbëlsirash, të cilat i gëlltitë me shije, duke lëmuar fytyrën, gjoksën, barkun... Të gjitha këto i shikon publiku. Mirëpo kur tenton me marrë më shumë, një qeske me sheqerka derdhet. Këtë e vëren ëmbëltari! Ngrihet. Shikon anash.)* More, frymë nuk pati, po kush drejtin m'i derdhi?! *(E shikon tepsinë më mirë.)* More po unë pata më shumë copa, kush m'i mori!? Unë i njeha, ku më shkuan! *(Bërtet.)* Kush m'i mori ëmbëlsirat?! Sheqerkat!?!... *(Sillet rreth e qark.)* Nuk po vërej asgjë, po ku më shkuan ëmbëlsirat, gjanëm?! Ndoshta kam gabuar në të njehur. *(Edhe njehëre i numëron. Përsëri ndalet me shpinë kah statuja. Veprimi përsëritet nga Shtatorja. Pas pak kur kthehet dhe konstaton se ëmbëlsirat vërtet po i pakohen nuk duron. Ngrihet i nervozuar. Dyshon në fotografën dhe vajzën. të cilët ende bisedojnë kokë më kokë! Ëmbëltari shkon drejt te ta, më të cilët edhe ngatërrohet.)* Mos i fshehni fytyrat! Pse m'i morët ëmbëlsirat?!

Fotografi dhe Vasha:

Ç'ke more, të lutem, mos na trazo?!

Ëmbëltari:

Si mos na trazo! Kjo që bëtë nuk është punë e ndershme! Qyqyqu e quququ, kokë më kokë, e këndeji ëmbëlsirat m'i zhvoshët!

Vasha:

Po ne asgjë nuk bëmë për marre!

Ëmbëltari:

Nëse jeni në atë ditë dhe nuk keni të holla me pague tregoni, zotnija juej e ti zonjushe!? Turp për ju! Keni vepruar si hajna! Më ka ftuar Xha Moni të vijë këtu. Bile deshta me i lënë këto këtu me m'i ruejtë ju e vetë me shkue me pru të tjera e ju po m'i vidhni ndër sy e mbas sysh! Hajna!

Fotografi:

Mbyll gojën! Ne nuk kemi dalë këtu me na ofendue gjithsekushi!?

Vasha:

Jo ne ato që t'i morëm t'i paguam?! Mos na bie në qafë?!

Fotografi:

Ti duhet të përgjigjesh për këtë ofendim. Ne jemi të ndershëm. Ne jemi fisnikë. Nuk jemi hajna!

Ëmbëltari:

Po shoh ndershmërinë e juaj! Po kush m'i mori atëherë ëmbëlsirat a e patë ju dikënd që kaloj kësajdpari përveç jush? Jo! Unë qorr nuk jam. Përveç jush kurrkush nuk ka kaluar këndeji! Ëmbëlsirat dikush i mori. Ja tepsia gati m'u boshatis! Pse nuk po pranoni?. Mos u pastë hije! Do të ju padis!

Fotografi:

Pasha nderin nuk t`i kemi marrë, mos na bjerë në qafë.

Vasha:

Pasha kryet e nanës nuk t`i kemi marrë! As që kemi luejtun prej vendit! Mos na merr fytyrën pa kurrjë!

Ëmbëltari:

Le ti kryet e nënës! Le fytyrën e buzët e kuqe! Po lugati nuk erdhi këtu me m`i hangër mua ambëlsinat. E kisha gati plot tepsinë e ja tash këqyre, gati u boshatis?! Turp të keni!? Edhe po gënjeni!
(Dëgjohet një kollitje paralajmëruese.)

Fotografi:

More veç mos bën gjurullti se po të paguaj. Veç mos na merr fytyrën para Xha Monit e të tjerëve! Po të paguaj diçka, veç hiqnau qafet!
(Ndërkohë hyn Xha Moni.)

Ëmbëltari:

Nuk po ju marr as qafën as fytyrën as fytin që e ëmbëlzuat, por po i kërkoj paret e mia?!

Xha Moni:

Mos u grindni!... Mos u grindni! Për çka është fjala?

Ëmbëltari:

Këta m`i morën ëmbëlsirat dhe nuk po m`i paguajnë!
(Fotografi me atë vajzën mundohen të arsyetohen, por ëmbëltari bën më shumë zhurmë.)

Xha Moni: *(Pasi lë një qeskë me rrobe dhe mantelin që e mbante anash në krah në një karrige afër tavolinës i ndërpret.)*

Mos u ngatërroni. Këtu ju jeni miq të mi. Tash edhe pak na vij në edhe të ftuar të tjerë. Edhe dikush nga jashtë që e kam në sallon! Ti moj vashë, moj lulë e bukurisë, mos u merakos fare! Ha-ha-ha! Ëmbëlsira e çfarë të dojë zemra do të keshë me bollëk! Edhe ty fotograf do të qeras vetëm na i bën fotografitë e mira. Kujtimi të na mbetet i përjetshëm! Ëmbëltar, ti shko e sill këtu edhe tepsiat e tjera a s` më njihke mua, të gjitha këto edhe të tjerat do t`i paguaj sonte unë! *(I jep ca të holla.)* Rregulloje tavolinën! Pastruesi muk paska ditur! Vër sofrabezin! Pasi të bëhet përrurimi këtu do të shtrojmë koktej. Pak do të pimë e do të argëtohem ngapak. Dikush këmbë e dikush ulur. Ja këtu jashtë, në ajr të pastër! Le të na shohë tërë qyteti! Ha-ha-ha! *(Ndalet te karrigia ku e ka lënë pallton.)* Këtu do të ngre dollinë përshëndetëse unë! Aty musafiri i rrallë! Të tjerët munden edhe në këmbë! Ti bukuroshe mbase edhe do të na këndosh!

Ëmbëltari: *(I vë çarçafin tavolinës. Aty e lë tepsinë. Rregullon karriget.)* Tash zotni po shkoj me i sjellë ëmbëlsirat e tjera si dhe gotat për pije. Këto t'i keni nën kujdes! *(Del.)*

Xha Moni:

Sillnai edhe bidonin me raki! Mos harro edhe gramfonin për muzikë! Ndërsa unë, ha-ha-ha!... Unë po shkoj me pa atfarë fakir Musë Shakaxhiun a po bën gjumë të mirë në grazhd të kalit! Ha-ha-ha! Do ta zgjoj, pasi të shpallet përurimi. Atë si surprizë do ta sjellë këtu. Me të do të qeshim e do të argëtohem si me arushë! *(U drejtohet të pranishmëve.)* Keni dëgjuar për Musë Shakaxhiun e kam mbyllë në ahur. Aty e ka zënë gjumi, në grazhd! *(Qeshet me zë.)* ... Ha-ha-ha! Teshat ia kam fshehë, qe ku i kam në këtë qeskën këtu. Atë atje e kam mbuluar me plafë të kalit. Ha-ha-ha! Ia kam dredhë mirë atij! Veç në brekusha e kam lënë! Ha-ha-ha! Vetëm pasi të na bëjë me qeshë mirë e mirë do t'ia jap rrobet të vishet! Ha-ha-ha!... Po kësaj udhe po shkoj me i nxjerrë jashtë mysafirët kurse ti bukuroshe, priti në selamllëk me buzëqeshje qysh ia ke zanat! Pastaj, kur të vijë çasti, me zërin tënd bilbile edhe do të na këndosh apo jo?! Mos i harro pa i shtue edhe këto vargje pas çdo kënge a strofe: *(Ja reciton.)*

*Mu në park të Monit-e, Monit-e,
Këtu në mes të qytetit-e, 'tetit-e
Dalin vashat me gjëzdisë,
Për kujtim të dashurisë !*

Hajde ta përsërisim së bashkëu! *(E këndojnë së bashku sipas melodisë: O vemi!)*

(Xha Moni i afrohet statujës.) Mirë qenka pastruar, po kishte mundë edhe më mirë! Po ku paska ikur, xhanëm, pastruesi! Ha-ha-ha! Çudi pse paska ikur pa e marrë bakshishin!? Ndoshta kthehet. Sigurisht edhe ai do të vijë pak pa u derdhë tubimi! *(Largohet ngadalë duke kënduar vargjetë e mësipërme dhe në çast ndalet dhe i drejtohet publikut.)* Kështu diqysh po due me m'u këndue kënga e jo si atë që ma kanë kurdisë për të zi Musë Shakaxhiu me atë mësues-poetin!... Po shkoj veç me pa atëfarë Musë Shakaxhiun dhe pas pak do ta zgjojë me një kusi ujë të ftohët fytyrës! Ha-ha-ha! *(Ende pa dalë nga skena Xha Moni "Shtatorja" shpejt e shpejt e heq çarçafin dhe e vesh pallton e Xha Monit dhe e merr qeskën me rrobet e veta në dorë...Të gjithë mbesin të hutuar.)*

Musë Shakaxhiu: *(Ju flet të pranishmëve.)*

Mos u merakosni, mos u merakosni. Kjo është një shaka për zotninë Hahaha! *(Ndërsa Monin fillon ta përqeshë.)*

*O ti Mon, o Napolon!
Mos u zverdh bash si limon!
Musa i vogël, mor zotni...
Ta lëshoi dredhë me kopili!*

(Xha Moni kthehet shpejt. Përpiqet ta rrahë me bastun. Musa fillon të ikën.)

Xha Moni:

Musë, çapkën-çapkëni! Kopil-kopili! Mantelin mos ma merr, hej! Statujën hej... Budalla!

Musë Shakaxhiu:

S'jam budalla, o zotrote *Hahaha!* Statujën e ke pas murit shëndosh e mirë! Po e vërteta është qysh po të thonë: *Statujën e ke ble për mendje të madhe, ajo s`ka kurrfarë manaje!* *(Vazhdon përqeshjen.)*

*More Mon, o Mon kuleta,
Shumë po vuen për mendt e shkreta...
Në daç vetes zë me i qitë
Tjetër statujë me porositë
Ose këtë godite së mbari:
Tue i dhënë fytyrë prej atdhetari!
Tue i vënë plis, pushkë e allti,
T'na i kujtojë luftat për liri!*

Xha Moni:

Po ti çka di se ç'është *liria, plisi, pushka e alltia, ti di veç çka është rakia, more pijanec, rakixhi!* Do t'ma paguajsh këtë gafë more grindavec! Asnjë pikë raki pa pare s' ke me pasë prej meje!...

Fotografi dhe Vasha:

Ja ku doli hajni i ëmbëlsirave!

Xha Moni:

Ky është rrebel, hajn, i paskrupull! *(U lutet fotografit dhe vashës.)* Hajde, ju lutem, më shpejt ta kthejmë statujën në vend, e mos të koritemi bile para jabanxhive! *(Me fotografin e bartin në vend statujën, ndërsa vasha i vë çarçafin, maskën.)* Mos ia varni atij shakaxhiu që s`di çka është arti. Ai kurrë s`ka dalë me pa Evropën e Amerikën e qytetnueme!
(Duke vënë Statujën. Dëgjohet muzikë. Bie perdjë.)

Pamja e shtatë

Mësues- poeti dhe Musë Shakaxhiu dalin jashtë skene, para perdes.)

Musë Shakaxhiu:

A ja rrotullova mirë atij Mon Napolonit. Me ble statujë pa kurrfarë simboli është marri.

Mësues - poeti:

Çfarëdo statujë e blerë vetëm si statujë nuk e bën njeriun e kulturuar, nuk e nderon as vendin. Prandaj ka të drejtë ai që e përqesh dhe e kritikon Xha Monin për fodullëk a po jo!?

Musë Shakaxhiu:

Thuani: Pooo!

Mësues-poeti:

Statuja mund t'i kushtohet simbolikisht ndonjë dijetari, ndonjë atdhetari, ndonjë luftëtar, apo jo?!

Musë Shakaxhiu:

Thuani: Pooo!

Mësues-poeti:

A po bindeni se sa i mençëm është Musa kur nuk pi raki?!
Përgjigjuni: Pooo!

Musë Shakaxhiu:

Çfarë më thoni a ta lë rakinë! JO a PO.

Mësues-poeti:

Thuani: -Pooo!

Musë Shakaxhiu:

Pra do të përpiqem me ju ndëgjue! Faleminderit!

(Fund.)

/Muzeqinë (Shtimje), nëntor 1958/

NËPËR PËSIMË MËSIMË!

(shfaqje teatrore)

(Ngjarja supozohet të ketë ndodhur në vitet e pas luftës.)

Personat:

1. Col Verbani (me dëmtim në njërin sy)
2. Lif Çalamani (me dëmtim në njërën këmbë)
3. Hanxhiu
4. Një kalimtar

Skena e parë: Në rrugë

/Në rrugë, në kalim e sipër, dy djelmosha, njëri e ka syrin e djathtë lidhur, ndërsa i dyti që bart një çantë çalon në këmbën e majtë, duke shpejtuar në të njëjtën rrugë në tejkalim e sipër ndeshen me njëri-tjetrin./

Lifi:

Uh, more ti, a pak të dalka rruga andej po ndeshe në mua, a s`ke sy me pa! Nga pakujdesi yt pësova!

Coli:

Ti more çalo, çalaman i keq, pse nuk po këqyr rrugën më mirë. E di veten qysh je e nuk po zgjedh rrugë. Ma lëndove syrin a po sheh! Nga pakujdesi yt pësova!

Lifi:

Faji është yti, ti nuk e mbajte anën drejt, rruga gjërë e gjatë e ti erdhe e ndeshe në mua. I pamarrë vesh! E sheh, ma lëndove këmbën!

Coli:

Shih, shih, ti na qenke i marrë vesh e unë jo -a?! Po të ishe i mirë do t'i kishe këmbët si duhet!

Lifi:

Po edhe ti po të ishe i mirë do t'i kishe sytë te dy, por të është bërë njëri si qelbësirë!

Coli:

Qelbësirë je vet, pse më shikon ashtu, more bishtec!

Lifi:

Bishtec, spec e kastravec je vet, e ke bërë syrin gozhdë, por kush ia mban naltë i vret poshtë!...

Coli:

Mos i jep Larojës ujë ku s'ta qet se pendohesh, mos kujto se po të frikohem, unë nuk i frikohem askuj.

Lifi:

E paske fjalën pushkë, por plumbat tuaj t'i mbaj në grusht, as vër syri nuk më bën për ty.

Coli:

As mua nuk më trembet syri aspak!

Lifi:

Ti s'ke sy për me t'u trembë. *(Lifi e tërheq për jake)* Pushka t'u bëftë top, të shtyesh me mua e ke kot. *(Lifi e ngrë me të gërrithur.)* Ik tutje, më gërrithe! Ti gërrithke si macja ... Unë macës ia shtyp turinjtë.
(Zbrapset dhe i matet me shkop.)

Coli: *(I inatosur e përqesh me lazdrim.)*

*O topall, o topall,
je rënduar si hamall,
ik, more, mbyllu në shtëpi
se nuk është rruga për ty!...*

Lifi:

Ndali fjalët more fjalaman se të bëj me të qa e zeza nanë!

*Sy nuk ke sy dhe mend nuk ke
edhe rrehen nuk po e sheh.
Ndali fjalët more lazdran!
se për jetë të bëj pishman!*

/E çon shkopin me i ra, me të cilin mbahet gjatë ecjes./

Coli:

Vetë je i lazduar. Eja, eja more këmbëkeq, se edhe tjetrën do t'a ndreq! *(E kap një gur.)*

Lifi: *(I flet me lazdrim.)*

*Xër, xërr, vër, vërr
Unë me sy e ti pa sy
Unë sy shkruem
e ti i verbuem!...*

Coli:

Thonë kush s'ka mend ka këmbë, e ti as mend as këmbë!

Lifi:

Ti e paske mendjen e madhe çka është e zeza e kresë tëndë. Mos shit shumë, se kush shet shumë pak ndal për vete.

Coli:

Edhe ti shumë po flet e kush ha shumë i bën zullum. Ikë more, he sytë mos t'i pafsha!

Lifi:

Ma plase zemrën he të plastë mushkënia! *(E ngre shkopin për ta goditur.)* Mos të paça në qafë!

Coli:

Hiqe atë kashtë, se ti jap gjashtëdhjetë e gjashtë! *(Gurin nuk e lëshon nga dora. Ndërkohë dëgjohet zëri i një kalimtari.)*

Kalimtari:

Mos u zini more grindaveca! More naiva! A pak halle e telashe të tjera keni e po grindeni njëri me tjetrin!

(Ata largohen nga njëri tjetri. Perdja bie.)

Skena e dytë: Në bujtinë

Pamja e parë

(Në një dhomë hani, një krevat i ngushtë, i mbuluar me një batani.)

Hanxhiu: *(Duke i rregulluar bataninë krevatit këndon.)*

*Unë kot nuk prita,
Biletat sot i shita,
Kam fituar bukur mirë
Me: Urdhëroni dashamirë!*

(Flet.) Prej krejt hanit, vetëm ky krevat më ka mbetur bosh, ndoshta edhe këtij do t'i dalë nafaka. Po fundi i fundit këtë mund ta shfrytëzoj edhe për vete. Po, s'i dihet punës! Ndoshta vjen ndonjë hallexhi! Phyh, ende paska mbetur pluhur! *(I bie pak me dorë.)* Lloj-lloj nevojlie sjell nata. Këtë e kam krevat të rezervës! *(Merr e shkund bataninë dhe duke e rivendosur mbi përsëri këndon si ndërhundë.)*

*Unë kot nuk prita
Biletat i shita...
(...etj.)*

Coli:

O Hanxhi, o hanxhi!

Hanxhiu:

Bujrun myshteri, urdhëroni dashamirë!

Coli:

A ke një vend të pushoj deri sa të vijë treni i mengjesit?

Hanxhiu:

Të gjitha vendet i kam të zëna, s'di si t'ja bëj. Dëgjova se sonte edhe gjetiu të gjitha hanet vendet i kishin të zëna!...

Coli:

Të lutem, jam njeri i ngratë, bëma një çare! ... Po të paguaj!

Hanxhiu:

Jam shumë i ndieshëm! Duhet me ta bë një çare. Po të dhimbka veshi-a?!

Coli:

Jo veshi, po syri.

Hanxhiu:

Po po, syri!... Vendet e tjera i kam të zëna, vetëm ky krevat më

ka mbetur. Ky është krevat i zorit, por edhe i hajrit. Këtë për çdo rast herë e ruaj për vete, herë për nevojli. Ky shtrat duken nuk e ka aq, por të madhe e ka nafakën, Dhe mjeku që i shëron të sëmurët ndodh të pushojë ndonjëherë në këtë krevat. Madje ndodh që t`i porosisë nevojtarët për me ardhë me ra bile një natë në këtë krevat!

Coli:

Mirë de mirë, po shihet mos e lavdo. Jam në zor!... Sa me të pague?! (*I paguan.*) Ruajma pra këtë vend se po shkoj me ble buletën.

Hanxhiu: Si quhesh?

Coli:

Më thonë: Col Verbani.

(Hanxhiu del me të dhe kthehet me para ndër duar.)

Hanxhiu:

Sa njeri për seri ky Col Verbani. (*E shënon.*) Të hollat m`i dha e buletën nuk ma kërkoi. Hani është si ura, jeta kalon si uji nën të, po dhe mbi të gjithkush kalon. Fati im, nën urë e mbi urë, po unë po jetoj nga fitimi që po më jep hani. (*Vazhdon të këndojë.*)

Unë kot nuk prita...

Pamja e dytë

/Skena e njëjtë. Ndërkohë thërret Lifi/

Lifi:

O Hanxhi, o hanxhi *(Futet brenda duke çaluar i mbushur frymë./*

Hanxhiu:

Urdhëroni, çka deshe?! Çka je fryrë kështu?!

Lifi:

Më fal! Jam lodhur shumë. *(I tregon çantën.)* Të lutem më gjej një vend të pushoj deri sa të vijë treni i mengjesit. Buletën e trenit e kam nxjerrë më herët e tash kam nevojë veç me pushue një kohë.

Hanxhiu:

Po më vjen keq, vend të zbrazët nuk më ka mbetë!

Lifi:

Auuuh, sa i pa fat që jam! Kah t'ia mbaj tash? Ku të shkoj, unë i ziu kështu, ku të shlodhem tani!

Hanxhiu:

Ma ligështove zemrën! *(Jep shenja cinike tue i fërkue duartë.)* Ty, sa po shoh, po të dhimbka barku-a!

Lifi:

Jo barku, po këmba!

Hanxhiu:

Popo, këmba! S`di si t`ja bëj?! Jam shumë i ndieshëm! Po ta gjej një krevat që e ruaj për zor!. Krevat, po krevat të shenjtë, pa feder e dyshek të mirë, por dhembje e brenga ama t'i hjekë si me dorë, por duhet të paguani pak!...

Lifi:

Po të paguaj he burrë, jo pak po sa ka hak! Ja të hollat. *(Hanxhiu i merr.)* A s'po ma kthen kusurin-a?

Hanxhiu:

Po more si jo. Për pak qesh tue u koritë. Po unë ma shumë kam qejf me i ndihmue myshterisë pa pare se me pare! Njeriu për njeriun s'dihet se kur bjen në zor! Më fal që u hutova! *(Ia kthen ca të imta.)* Po nuk i paskam të gjitha! Ndërkohë mund ta kthej kusurin.

Lifi:

Për pak s`pata me pasë gajle, po edhe unë hallexhi jam, për shumë po më djeg kurrizi i zemrës!

Hanxhiu:

Të falemnderit për fjalët e mira! Kurr s'pakam dëgjuar për *kurrizin e zemrës!*

Lifi:

Veç kur të dhemb atëherë e njeh! I sëmuri ka nevojë më tepër se gjithkush edhe për fjalë të mira, e sidomos për sjellje të mirë. Dhe unë pasi po kërkoj ilaç, shumë lehtë po i besoj çfarëdo këshille. Ku është ai krevati?! Të shlodhem pak.

Hanxhiu: *(Duke treguar krevatin.)*

Ky është ai krevati i shenjtë. Mos i shiko gunën po punën, i thonë fjalës. Unë sa herë pushoj këtu më shlodhet shpirti. Ai *kurrizi i zemrës* më mbushet me gëzim dhe e mbara gjithnjë më prihet!

Lifi:

Po më duket se qenka shumë i ngushtë!?

Hanxhiu:

Eu, i ngushtë po të duket -a! Ky bën për dy, por edhe për tre vetë! Këqyre sa i gjatë është?!

Lifi:

More kur s'ka shi, thonë, bën breshën! *(Vendos çantën te kryet e krevatit.)* Po dal veç pak për nevojë. Ma trego vendin! Nevojat e njeriut më! *(Me shkop duke u mbajtur niset me dalë kah dera.)*

Hanxhiu:

Jo andej po këndeje. Po më thuej si quhesh?

Lifi:

Lif Çalamani, më thonë.

(Dalin së bashku.)

Hanxhiu: *(Kthehet. E merr në shënim.)*

Eu, ç'ua përzjeva punët Col Çalamanit e Lif Verbanit. A thua çka do të bëhet!? Një çorr e një sakat në një krevat! *(Qeshet me zë.)* Hi-hi-hi e hu-hu-hu! Një mendje po më thotë mos bën kështu, tjetra po më thotë, bëju lyes e lasë se qëllimi është vetëm pare me pasë! Pa pare s'ka çare! A thua se edhe xheneti fitohet me pare!? Nuk e di kush! Ja të hollat e fituara! *(I nxjerr të hollat dhe fillon me i njehë.)* Këto virane s'po të lejshin kurrfarë fytyre! Po me to njeriu po gjen çare. Çareja është më e madhe se fytyra! Dihet se fytyra lahet me sapun, edhe sapuni blehet me para!? Apo jo? *(Pyet publikun. Del.)*

Pamja e tretë

(Skena e njëjtë. Kthehet Lifi dhe ulet në karrige afër krevatit. S'vonon vjen dhe Cifi dhe kalon në anën tjetër të dhomës. E shikojnë njëri tjetrin habitshëm.)

Lifi:

Po ty çka të qiti këtu?!

Coli:

Çka të qiti ty se ?!

Lifi:

Po ti më gjete këtu, ç'kërkon këndeje?

Coli:

Erdha të flë në krevatin tim. Këtu isha më përpara. E pagova e pastaj shkova me e ble buletën. Mos vallë, edhe këtu do të më pengosh?!

Lifi:

More ç'je kah thua? Unë e kam paguar pak përpara. A s'e shihke çantën-a! Ky krevat është imi. Këtu s'ka mosmarrëveshje! Po ikë këndenaj!

Coli:

Shporrmu sysh se po ta thej edhe këmbën tjetër!

Lifi:

Hiqmu sysh se po ta shpoj atë synin e katallanit që të ka mbetë!
(Ia kallëzon shkopin.) Pse po më ndjek si majmun! Kah shkoj unë ti zatet dand-e-dand në mue?!

Coli:

Unë si majmun a ti si qen i keq, endacak! Paske ardhur të më shesish bejleg-a, por ti s'mundesh me mua! *(E kap për jake dhe në përleshje e sipër e hedh tutje.)* Atje do të flesh ti!

Lifi: *(Ngritet dhe çantën ia hudh tej në dysheme.)*

Ti hyn nën krevat, si lehësi nën hambar.

/Në përleshje e sipër bëjnë shamatë. Ndërkohë vjen hanxhiu./

Hanxhiu:

Ç'është kjo shamatë, se ma çuet hanin peshë. Ende nuk jeni rehatuar-a?!

Lifi:

Ja ky verbani, qorri i keq, po më ndjek, përzine të lutem!

Coli:

Jo hanxhi, ky topalli, çalamani i keq, si rriqna më është ngjitur, ky shpifan vendin e paguar po do me ma zënë.

Hanxhiu:

Pushoni, pushoni, heshtni që të dy! Ku i keni buletat? *(Ata ngurrojnë të habitur.)*

Coli:

Po ti paret m'i more e buletën nuk ma dhe!

Lifi:

Po ti paret sa m'i more, bile kusurin ende s'ma ke kthyer tamam! Buletë nuk më preve!?

Hanxhiu:

Unë qenkam fajtor-a! Unë s'e dikam detyrën time-a! Unë nuk marrë pare pa lëshuar buletë? Po ju buletat s'i paskët paguar apo i paskët humbur edhe tash po bëni zhurmë e shamatë! Heshtni mos folni se e thërras policinë e ju nxjerrë jashtë të dyve ose ju shtie të paguani!!... Nëse jeni në zor dhe keni nevojë që të dy duhet të flini në këtë krevet. *(E ia kthen pak si me lajka.)* Më besoni. Në këtë krevet të shenjtë bëhet më kabull të flenë dy vetë se një. *(I thekson fjalët e fundit.)*

Lifi:

Çka, unë, s'mundem me fjetë me këtë merimangë?!

Coli:

As unë nuk fle me këtë rrashtbreshke?! ...

Hanxhiu: *(Me urdhërim.)*

Ndalni fjalët, se ju dëboj të dyve! Silluni urtebutë! Buletat nuk i keni! Me sa di unë edhe emnat nuk m'i keni dhënë qysh duhet. M'i jepni lejet e njoftimit! *(Ua merr dhe i lexon.)* Ti Col Çalamani zyrtarisht e paske emrin *Sokol Mirani*, kurse ti Lif Verbani e paske: *Arif Sukani*! E... a po shihni se në fillim asnjëri nuk m'i keni thënë emrat qysh duhet. Kjo është shkelje e ligjit! Shikoni!...

Falenderonju bëmirësisë sime, se qe qebesa, nëse nuk silleni mirë mund të thërras policinë. Dhe kur t'u them unë atyre, të vërtetën(!), se ju te dy më keni hy me zor në han (!), ngase jeni pa buleta dhe se emrat e vërtetë i keni fshehë! Ata do të më besojnë mua e jo juve! Përveç gjobës mund të hani edhe dajak, burg a ku ta di, madje mund të keni edhe pasoja të tjera! Ju duhet t'i tregoni përherë emrat e vërtetë, emrat zyrtarë e jo ashtu qysh po ju quajkan të tjerët! Mbanie mend çka ju thashë! Çka ju mësova! Çdo mësim paguhet. Tash hajde shtrihuni me fjetë! Falenderomni për mirësinë time dhe rehatohuni!

Lifi:

Zori është i biri thiut! Po qysh me ra?!

Coli:

Ti a po do me na shti si peshq në konservë-a!

Hanxhiu:

Kur s`keni çare tjetër, pra, s`duhet me pasë as zënka as fjalë. Atëherë heshtni, gojës veni dry dhe flini.

Coli:

Qysh të bijmë, s'paske vend as kurrgjë, spaske as gjysmë krevati e pagesën e bëra për një krevat tamam!

Lifi:

E paret tamam m`i more sa për një krevat!

Hanxhiu:

Mos bëni fjalë më. Ja kështu duhet të flini. Njëri kokën andej e tjetri këndej! Duhet të ma dini për nder që po jua mundësoi pushimin në këtë krevat të shenjtë. Mos e harroni mirësinë time! Mos harruat se vetë më lutët. E dini se ju keni nevojë për pushim, unë jo! Hajde, ju urdhënoj: bini shpejt. Pos setrave e këpucëve tjetër gjë mos hiqni nga trupi!...

(I detyron me ra në anët e kundërta. Këmbët e njërit nga koka e tjetrit. I mbulon me të njëjtën batani.)

Coli:

Si të zgjohem në kohën e caktuar?!

Lifi:

Të lutem mos harro më zgjo me kohë, që mos të më ikën treni!

Hanxhiu:

Flini pa merak, e kam kurdisur zilen e orës. Po unë detyrimisht me kohë do t'ju ndez dritën. Me siguri do t'ju zgjoj me kohë. Si ta dëgjoni zilen ngrihuni shpejt e shpejt dhe tfilloni secili në rrugën e vet. *(Duke e mbyllë derën.)* Edhe njëherë po ju them mos u merakosni se unë do ta ndez dritën bile pak pa rënë zilja e zgjimit. Pra, gjumin e ëmbël në krevatin e shenjtë! *(Pasi ata shtrihen ai kah del e fik dritën.)*

Coli: *(Pas pak.)*

Krevat jo i shenjtë po i gemtë!

Lifi:

Krevat i mallkuar! Krevat i zanuar!

Coli:

Krevat i dreqit, he kuku për mua!

Lifi:

Kuku për mua që më ra hise me fjetë me ty!

Coli:

Hajde t'i lëmë zënkat, kërrri-kërrë, kush bën zë, është më i keqi sa s'ka më ...

Pamja e katërt

/Skena e njëjtë. Fillojnë gjoja të flejnë. Kërrhatin, herë njëri e herë tjetri, herë të dy... Kah rrotullohen herë në njërin herë në tjetrin krah e ngacmojnë njëri tjetrin. E tërheqin batanijen herë njëri herë tjetri. Japin shkas për të qeshur shikuesit. Pas një kohe bie zilja. Ata zgjohen me rrëmbim dhe prej hutimit të njëjtës pallto ia shtijnë krahët në mëngët e kundërta. Kështu që kur duan të shtijnë dhe dorën tjetër puqen shpinë për shpinë.

Coli:

Lëshoma pallton more sherran.

Lifi:

More mos ma merr pallton ti, a s'po të punuakan dritat-a!

(Kështu këta fillojnë të zihen dhe në këtë moment hyn kalimtari.)

Kalimtari:

Ç'po ngjet kështu, more djelmosha! Ç'është kjo grindje mes jush!

(E ndez dritën.) Secili pa panik le t'i gjejë rrobat e veta. *(Ata vishen e mbathen.)*

Lifi:

Ky gjithmonë po më ngacmon, e sheh edhe pallton deshi me ...

Coli: *(E ndërpret.)*

Jo ky gjithmonë po ngatërrohet me mua!

Kalimtari:

Po ju u zgjuat të hutuar. Dhe s'keni pasur faj, se këtu nuk patët mjaft dritë. A po shihni se palltot i paskët të njëjta! Dale, dale, po ty të dhimbka syri, *(I drejtohet Colit.)* Po edhe ty po të dhimbka këmba *(I drejtohet Lifit.)* Pse po e shikoni ashtu me urrejtje njëri tjetrin? Çka jeni habitur kështu? Pse po më shikoni dhe mua ashtu si të mpirë. Çfarë mosmarrveshje ka ndodhur mes jush? Më duket se ju ini ata që u zutë dje në rrugë për asgjë, apo jo?!

Lifi:

Po ky m`u ka matë me shkop me më ra.

Coli:

Ky m`u ka matë me gur me më gjuejtë!

Kalimtari:

Shumë keq! Ajo çfarë ka ndodhur qoftë e harruar. Njeriut mund t'i ngjajë gjithçka, por me arsye tejkalohen të papriturat. S`ka pasur nevojë të ngatërroheni njëri me tjetrin fare. Pse të mbusheni vrer,

kur mund të mbushet njeriu me gëzim. Kushti i parë i mbarësisë është që njeriu ndaj njeriut duhet të ketë mirëkuptim! Njëri tjetrit kurrkush, as ju të dy, nuk i ka borxh fjalë të rënda a fjalë të ëmbla po. Nuk duhet helmuar rininë tuaj për asgjë. Gabime të rastësishme ndodhin. Njeriu që gabon duhet të kërkojë falje për gabimin e bërë. Është turp të grindeni për lëshime të vogla. Nga ngatërresat e vogla mund të pasojnë rrjedhime të mëdha. Nëse e keni vetëm atë që ka ngjarë dje, atëherë ju nuk keni asgjë të keqe njëri me tjetrin apo jo?! Unë ju kam parë dhe në rrugë. Pastaj isha këtu në dhomën fqinje dhe kam dëgjuar të gjitha edhe këtu. Për ata edhe erdha tek ju.

Lifi:

Kurrnjë të keqe nuk kemi pasur kurrë, por ky rrugës...

Coli:

Po dhe ky më ka folë fjalë të rënda ...

Kalimtari: *(I ndërpret.)*

Fjalët i merr era! Ju thash se i di të gjitha. Dhe i kuptoj të gjitha. Gabimet e juaja janë më tepër gabime të rastit. Pa paramendim. Kanë ndodhur papandehur e pa qëllim. Ju duhet t'i kërkonit falje njëri tjetrit për ato të ndodhura. Ne të gjithë njerëzit kemi nevojë për ndihmën e njëri tjetrit.

Lifi:

More vetëm le të më hiqet qafet se nuk e dua ndihmën e tij.

Coli:

Edhe unë nuk kam nevojë për të, vetëm le të më shporret sysh.

Kalimtari:

Ju ende po flisni si nuk ju ka hije. Me gjakftohësi merren gjykime të vërteta, të shëndosha e të drejta e jo kështu. Juve po ju mungon gjakftohësia në gjykim. Po për ku po udhëtoni?

Coli dhe Lifi: *(Që të dy.)*

Për Shkup! Për Shkup!

Kalimtari: *(I drejtohet Colit.)*

Për se?

Coli:

Për vizitë mjekësore te specialisti, për shkak të syrit. Ma ka lëndue flaka e barutit. Më kanë thënë se syri do të më shërohet, por më duhen edhe disa vizita te mjeku specialist. Tashti, ç'është e vërteta, unë nuk po shoh aq mirë me këtë sy dhe po ndjej dhembje herë-herë.

Kalimtari:

Po ti? *(I drejtohet Lifit.)*

Lifi:

Dhe unë kam një udhëzim për te mjeku dhe më duhet të shtrohem në spital se kanë me ma rioperuar këmbën. Më kanë thënë se më janë zënë keq disa damarë dhese nuk mund të drejtohen pa një ushtrim të specializuara pa një operacion tjetër. Pastaj, shpresoj, se do të mund të ecë pa çaluar. U bë luftë në lagjen tonë dhe unë qeshë plagosur bukur rëndë në këmbë. Më shëroi sa munda mjeku atëherë, besa edhe më kanë operuar njëherë, por tash më kanë udhëzuar te specialisti për mjekime të mëtejshme.

Kalimtari: *(E ndërpret.)*

E shihni, e paskët rrugën e njëjtë. *(Serioz.)* Më thuani drejt e shkurt, për çka ka nevojë të ngutshme secili prej jush?!

Coli:

Unë kam nevojë për një udhërrëfyes, se spitalin nuk e di se ku ndodhet. Po do të pyes rrugës, mbase do të ndesh ndonjë njeri të mirë që të më tregojë. Po as gjuhën e huaj s'e njoh sa duhet?!

Kalimtari: *(Lifit)*

Po ti?

Lifi:

Unë rrugën e di shumë mirë, kam qenë në atë spital dhe gjuhën e huaj e njoh, por kam nevojë për një njeri që të më ndihmojë rreth çantës, sidomos gjatë hypje-zbritjes nga treni. Po mbase do të kem fat ta takoj ndonjë njeri të mirë të më ndihmojë!

Kalimtari:

Unë po i gjej secilit prej jush nga një njeri të mirë që po kërkoni!

(Të dy shikojnë me habi dhe mirëkuptim. Kalimtari i mëshon zërit.) NDIHMONI NJËRI TJETRIN!

Coli:

Unë mund të bart, por ...

Lifi:

Unë shoh mirë dhe rrugën dhe gjuhën e di, por ...

Kalimtari:

S'ka por, por!... Tash menjëherë mund ta ndihmoni njëri tjetrin!, Por përpara kësaj ju duhet t`i kërkonit falje shoqoshë për ato të pamira që ndodhën rastësisht midis jush nga naiviteti. Jeni sivëllezër të dy. E shihni se të dy jeni viktimat e luftës. Keni pësuar fatkeqësi nga i njëjti armik. Prandaj duhet të keni mirëkuptim ndaj njëri tjetrit. Tash pasi edhe keni rrugë e halle të njëjta ju duhet të ndihmoni shoqishë. Madje edhe nëse shtrohet kush në spital mund t`i gjendeni pranë njëri-tjetrit. *(Ata i shtrijnë dorën njëri tjetrit dhe kërkojnë falje.)*

Mos harroni se ju ka shëmtuar lufta, po ju veten me fjalë mos e shëmtoni! Lini në harresë zënkën e mëparshme të rastit. Si thamë njëri njëriun në jetë duhet ndihmuar e jo penguar. *(Ndërkohë vjen hanxhiu.)*

Hanxhiu:

Përsëri janë ngatërruar-a?!

Kalimtari:

Jo patën një mosmarrëveshje të vogël për shkak të mungesës së dritës. Ta dijsh se faji është yti.

Hanxhiu:

Nëse janë pajtuar duhet me më qerasë që të dy!

Coli:

Vërtet, prej ngatërresave nuk ka asfarë dobie.

Lifi:

U bëmë gaz i botës për kurrjësend!

Coli:

Shumë kemi gabuar.

Lifi:

Vërtet, më vjen keq për atë që ka ndodhur, më fal shok!

Kalimtari:

Mirë e tha Hanxhiu, duhet qerasje për këtë punë edhe këtë qerasje, para se t`ia bëni ju njëri-tjetrit, duhet ta bëjë menjëherë vetë Hanxhiu për ta pastruar ndërgjegjën e vet.

Hanxhiu:

Pse unë, nëse kam lëshime vërtet do ta bëjë, ndryshe duhet këta, se këta u pajtuan, u shëruan! E unë pak përpara jam pastrue me ujë të vakët, për ata edhe u vonova pak!

Kalimtari:

Uji ta pastron fytyrën, por jo ndërgjegjën!

Hanxhiu:

Pse, ku kam gabue aq rëndë?!

Kalimtari:

A s'është lëshim yti mosndezja e dritave që u bë shkas i zënkës së fundit?! E për lëshime të tjera duhet të mendosh vet. E vërtetë se këta, u pajtuan, u shëruan (!), po edhe ti duhet ta shërohesh dhe ta pajtosh ndërgjegjën! Me një cigare s'nderen dy vetë, kur e ke paqetën plot!

Hanxhiu:

Të lutem, ma thuaj më qartë?

Kalimtari:

Po këta të dy a kanë fjetë në një krevat. Biletat për sa krevatë i kanë paguar?!

Hanxhiu:

E kuptova, vërtet, ashtu është, prandaj unë po jua kthej të hollat në shumën për gjysmë bilete sa është çmimi! *(Secilit ua kthen nga ca të holla. Ata i marrin dhe i falenderojnë të dy.)*

Kalimtari:

Ja tash po ndihet sirena e trenit. Hecni djelmosha. Çdo rrugë le të jetë hallkë mirëkuptimi dhe bashkëpunimi që duhet t'i lidhë të rinjtë tanë! */Ata nisen. Coli e merr çantën e Lifit, ndërsa Lifi prin. Kalimtari vazhdon.)*

Udhambarë, djelmosha! Qofshi faqebardhë! **Kudo që të jeni mendjen ta keni!** Mos harroni: **Edhe nëpër pësime merren mësim,** të cilat s'duhet harruar kurrë! *(Del edhe Kalimtari. Pa rënë perdja Hanxhiu lavdohet.)*

Hanxhiu:

A nuk është ky krevat i shenjtë që pajton zemrat! Kush nga ju ka ngatërresë me ndonjë shok le të urdhërojë në hanin tim! Ha-ha-ha! Ja krevati i shenjtë pajtues i shpirtave të lënduem! Po ta dini se te unë paguhet buleta tamam!

(Bie perdja) (Fund.)

(Vojnoc (Shtimje) - Ferizaj), nëntor 1958)

NOTA E DOBËT
(shfaqje teatrale)

Personat:

Bardhi (nxënës)
Zekë Rrafshaku (i ati) dhe Nëna (gruaja e Zekës);
Mixha Liman (plak me autoritet);
Bardhyli (fqinj i Zekës).
Fatmiri, Një nxënëse dhe nxënës të tjerë);

Skena e parë

Pamja e parë

/Ngjarja zhvillohet në rrugë para shtëpisë së Zekë Rrafshakut. Një grup nxënësish kalojnë me librezë e libra-dhurata nëpër duar. Të gjithë duken shënd e verë. Këndojnë hareshëm dhe lëshojnë ndonjë gazmore. Ndalen afër pemës që ndodhet buzëgardhit, në afërsi të dverve hyrëse të oborrit të Zekës./

Nxënësi I: *(Pasi hyp në një tumë buzërruge reciton.)*

Shihni nxënësin shembullor
që librezën e mban në dorë!...

Nxënësi II:

Të gjithë po kthehem shënd e verë,
Sikur tash si tjera herë!...
Nuk na shkoi, jo, munda kot,
të shkëlqyer si për mot!

Nxënësi III:

Edhe unë shpërndaj urime:
Sa më tepër gëzim në pushime!

(Nga grupi i nxënësve dëgjohej duartrokitje si dhe urimet nga zëra të ndryshëm.) Bravo, bravo !
URIME, FALEMINDERIT! PUSHIM TË KËNDSHËM! FALEMINDERIT! *(Secili ikën në anën e vet.)*

Pamja e dytë

/Rrugës në të njëjtin vend pas pak vjen Bardhi i dëshpëruar, me vaj në buzë./

Bardhi: *(Përvajshëm.)*

Ja mbeta vetëm, kurrkush nuk po më shoqëron. Të gjithë po fluturojnë nga hareja a unë?! ... Unë, i ngarkuar me halle të rënda mbi kurriz, mëzi po ec! ... Këtë vit mbeta me notë të dobët. Nota e dobët si akreb po më lëviz nëpër kokë, nëpër krejt damarët e shpirtit!... *(Dënes me zë.)*... Më mirë të mos jem fare. *(Vazhdon të dënesë.)* ... Unë notë të dobët e ata dhurata!... Unë isha nxënës i shkëlqyeshëm viteve të tjera... Sivjet pse rashë kaq poshtë!? Dua të qaj. Kam nevojë të qaj, të shfryhem, por lotët nuk më dalin më!... Më janë shterë! Edhe lotët paskan rrënjë!... Kuku bre kuku!...Kuku për mend që s'pata! O lot, dilni! Dilni krejt me rrënjë! O kuku nënë, po çka më duhet jeta kështu! ... Më mirë ta mbys veten! *(E heq rrypin. Jep shenja se gjoja do të varet. E prek qafën. E afron rrypin te qafa. E shikon degën mundohet ta mbërrijë.)*

Zeka: *(Vetën zëri i dëgjohej.)*

O Bardh -o! Krejt fëmijët erdhën, ç'u bë me të!?

Bardhi:

Baba po më thërret, çka po i duhem, ndër gjithë shokët e shoqet e klasës unë i ndarë për të keq. Babës, vërtet, nuk i prishet qejfi me më nda nga shkolla, po jo kështu të poshtnuem si ngelcan! Këtë nuk e prisja!... Unë që me ditën e sotme nuk kam mbetur më për asgjë. Më ka humbë krenaria! *(Bie si palmuç.)*

Nëna: *(Duket gjithandej dhe e sheh Bardhin afër pemës ashtu të molisur rëndë.)*

Kuku, qyqja! Më paska shkuar djali!... *(Vrapon kah ai. E kap për krahësh, mundohet me e ngritë.)* Uh, birë, ç'ka të paska ikur gjaku kështu!? Kush të ka rrahë, çka je molisë kështu!? Mos je rrëzue nga druri!? *(E shikon degën.)* Mos pate ndonjë mundim?! Mosallah! Mos të ka rënë të ligët! Mos të ka prekë ajo e tokës!?!... Mos pate mendim të keq?!... Uuh, qyqja nëna, çka të gjeti kështu! Djali im, i miri i nënës! Çka je kadaluar sot. A s'po e ndien babën që po të thërret-a!... Thua j nënës çka ke! Pse nënës nuk po i përgjigjesh?!

Bardhi:

Nënë, kam ngelë me notë të dobët! Të gjithë më quajnë ngelcan dhe kanë të drejtë! Ja libreza! *(Ia ofron. Ajo e merr.)*

Nëna:

Uh, birë, birë, a për ata e ke-a?! ... Po ty të pastë nëna! Për atë punë mos u gajlo hiç! Hajde, me nënën, ta kam zie një vezë.

Për darkë nëna do ta presë një pulë! Supa e nxehtë të bën hajr! Qetësohu shpirti i nënës! Paj, as babë as babëgjysh prej kësaj dere s'kanë pasë shkollë e kurrëgjë s'i ka gjetë. Për ata ti hiç mos u gajlo!

Zeka: *(Afrohet.)*

Po ju ku jeni bre, a ju lëshoi toka-a! Pse nuk po bëzani?!

Nëna:

Qe, qe, ku jemi. Djalnin nuk e paskemi mirë!

Zeka:

Çka ka ky melun i rrugëve. Krejt erdhën me kohë tue kërcye si edhat veç ky jo! *(I drejtohet Nënës.)* Po ti moj grua, çka ke dalë këtu. Të kam thënë se kah sokaku nuk është mirë me u sjellë grueja!

Nëna:

Po dola nga zori se venerova prej së largu se djalnin nuk e kishim mirë, a po e sheh, qysh i ka ikë gjaku!

Zeka:

Ju gratë e kini zemrën e lepurit!... Mos u tut se kurrëgjë nuk ta gjen sendin e keq!... Ky që u vonue sot meriton një shuplakë të mirë. Dajaku që e bjen në vete hajvanin i bën nganjëherë mirë edhe insanit! Njeriu që shkon në shkollë edhe më tepër duhet me dashtë shtëpinë, s'duhet të ndalet rrugëve. Edhe ky e di se na mbeti lopa mëshelë.

Bardhi:

Po, babë, unë...

Zeka:

Mos më bën mëk-mëk!... Hajt lëshoje lopën! Merre një copë bukë e djathë në dorë! Ti duhet të bëhesh vetë merak me i shërbye shtëpisë tënde. Kjo është shkolla e vërtetë e jetës. Unë kur i kam pasë vjetët tua i kam ruajtë njëzet frymë lopë e ti një edhe atë nuk po e këqyr me zemër!... Besa, merre edhe krahnin me vete e krihe ndonjë herë. Çoje te livadhi, se atje do të vij dhe unë. Kam me pre do therra. Na duhen për me i zënë gardhiqet.

(Bardhi ikën ngadalë me Nënëen.)

Zeka:

Oj ti, ndalu pak. Desha me të pvetë diçka.

Nëna: *(Kthehet dhe i flet Zekës.)*

Aman, njeri, mos i folë djalit aq rrebët. Po druej mos po na trenohet!

Zeka:

Po çka ka djali? Pse po duket aq i thyem?! Mos e halit me kili-vilet e tua! Fëmijës duhet me i folë rrebtë se ndryshe ai ta merr zemrën!

Nëna:

Qyqja unë, qe tue na shkue djali. Po tutna që po na vdes! Po tutna edhe po na mbetet me ves! A e pa vetë?! Iu ka bë fytyra verdh si dylli. Mos po na gjën ndonjë hata, Largqoftë!... Rrypin ia gjeta ndër duer!...

Zeka:

Po, të pveta, pse, çka e ka gjetë?! Çfarë sikleti paska?!

Nëna:

Nuk paska kalue në shkollë. Kish marrë nota të dobëta në librezë. Qe kjo shihe vet. Kjo ia ka dhanë djalit iletin e sikletin! *(Ta jep librezën.)*

Zeka: *(Me librezë-nxënësi në dorë.)*

Puna e fëmijës, mendtë e papjekne. Pse nuk ka kalue nami nuk është bë. Bash qejfi po më bëhet. Në mot nuk e çoj hiç. E ndali kah shpija. A pak punë ka shpia-a!? Djali në shtëpi lumë prindja. Djali në shkollë, mjer shpia! Me shkollë bëhet djali i dynjasë e jo i shtëpisë. Më mirë na bjen ne nëse ngel krejt nga shkolla. Edhe na jetuem pa shkollë e kurr gjë nuk na ka gjetë. Babë e babëgjysh kështu u trashëguem dhe kurrkush nuk luejti menç!

Nëna:

Mirë a keq unë nuk di, por djali tutna që po na shkon! Mos i bërtit aq shumë, allahile! Merre djalin me të butë. Ti i di më mirë këto punë, po qe unë s'po durohem pa të thënë. Po më dhimbet shumë!...

Zeka:

Mendja e grues, a mue s'po mu dhimbka-a! Shko ku të thash, atje e ke vendin ti. *(Nëna shkon.)* Qyqy, puna e fëmijës ... pse s'paska kalue qenka sëmuni. Axhamia! Me të drejtë kanë thënë se axhamia është më i zi se i trenti! Po a merr njeri siklet për shkollë, bre hej?!

Për shtëpinë e vet nuk mërzhitet e për shkollë po!?!... E pashë edhe vet se i kishte ikë gjaku. Unë thash se mos e ka prej tutës teme e ai e paska pasë zorin ngjeti. *(Librezën që mban në dorë e shikon.)* Kjo po dojka me ma mbytë djalin-a?! ... Moti u mbytshin gjinja me dru, ja me pushkë t'hekrit dang-dang edhe hajt. Dihej dorasi. Kush ish i zoti e nxirrte hakun e dikush jo. Po hyhej ndër pleq. Jepej besëpaqe, bëhej pajtimi... Edhe kjo e ka pasë hijeshinë e vet! E tash? Letrat po na përzihen në shtëpi si për të mirë si për të keq!... Letrat e sotme, edhe po të mbytkan dhe gjak humbës po të lënkën! Vërtetë, i ka pasë thënë njëfarë *delovoxhe në bivshe Jugosllavi* babës, kur ia çoj një dash për me ndërhy te *daskalli* për me më heqë krejt prej shkolle. Tash po e shoh se shkolla, vërtet, po del telashe. Shkolla po të le pa hajrin e fëmijës. Ja e ftohë prej punës, ja si ta kryen shkollën fëmija ik dikah, he telashja i vraftë sebebqarët e këqinj!... *(Librezën fillon me e shfletue.)* E si të dija se çka shkruan këtu?! Di ngapak me lexue, po këtu qysh po shkruajnë këta mësuesit "shkarravina" si do doktora, mos me i marrë vesh kush, veç ata të zanatit të vet! *(Një nxënëse kalon asajtpari. Ia sheh librezën në dorë)*

Një nxënëse:

Axha Zekë, që kur ti me librezë të nxënësit në dorë?! Si duket vonë të ka ra ndërmend *(Flet si me lazdrim.)* Bardhi të ka mbetë me notë të dobët për shkak tëndin. Arsimitari ka thënë se kjo ka ndodhë me fajin e prindit. Me miratimin e prindit Bardhi ka bërë shumë mungesa të paarsyeshme. Po me fajin e prindit ai s'ka qenë dhe aq i pajisur me mjete mësimore. Në kohë të fundit nuk ka shprehur aq interesim për shkollë, ndërsa prindi fare nuk është përkujdesur për të, përkundrazi...! *(Pa përfunduar ajo ikën duke qeshur pak si me lazdrim.)*

Zeka:

Shih melunja edhe po qesh edhe po ta lllapangjeshë! *(Ndërkohë vjen një nxënëse.)*

Fatmiri:

Mirë dita mixha Zekë. Çka tek je ndalë këtu në këtë kohë.

Zeka:

Qe, më duket se shkela në sofrën e xhinave dhe mbeta i zanuem në vend!

Fatmiri:

Pse çfarë të mirë të ka ndodhur, mixha Zekë? Çfarëdoqoftë, e mira e ndaftë!

Zeka:

Të lutem apo ma këndon këtë? *(Ia jep librezën.)* Çka po shkruen këtu se unë edhe s'di mirë edhe qe besa edhe kam nisë mos me pa bash mirë. Po edhe me lexue përpak e hiç, s'po kuptoj!?

Fatmiri:

Me gjithë qejf dhe pa farë mërzie. *(Lexon ngadalë dhe me qartësi.)*

Nxënësi Bardh Zekë Rrafshaku nga Boka e Zezë përcillet në riprovim me një notë të dobët nga lënda: gjuhë amtare.

Vërejtje: Nxënësi nuk ka të meta trupore. Ka zgjuarsi, por me gjasë nuk ka hasë në mirëkuptim në shtëpi me prindin e vet. Nuk ka qenë i pajisur sa duhet me tekste shkollore. Kah fundi i vitit shkollor ka bërë shumë mungesa të paarsyeshme. Literaturën shkollore-mësimore fare nuk e ka lexua. Përkujdesi i prindit për mbarëvajtjen e tij në shkollë pothuajse ka munguar fare! Te nxënësi këtë vit shihet një ftohje ndaj shkollës. Po t'i jepej zemër e vullnet ky mund të bëhet një ndër nxënësit më të dalluar të klasës, siç edhe ka qenë viteve të tjera.

Arsimtari kujdestar : Ismet Luboteni

Zeka:

Hajt bilbil, bre! Sa mirë ma këndove, si makinë: vër-vër-vër!

Fatmiri:

Po edhe Bardhi yt lexon mirë si unë. Provoje, provoje, sa bukur lexon ai. Tash po shkoj, lamtumirë! *(Shkon Fatmiri.)*

Zeka:

Udha e mbarë të qoftë, bëfshhajr! ... *(Pas pak.)* Sa mirë ma lexoi shejtani, përnjëmend shkolla shumë e mirë është, por ... Baba i Fatmirit ka edhe djem të tjerë. Disa mund t'i shpërndajë në shkolla, kurbete e kudo ngjeti. Ndonjërin, atë më të hajrit e më punëtorin, mund ta ndalë për shtëpi. Kurse unë e kam vetëm një. E atë po ia dhashë shkollës, atëherë do të mbetem pa asnjë. Kështu është. Po s'i eci shkolla, atëherë i shkon shpija, po i heci shkolla nuk i hec shpija. Këto të dyja më ka thënë dikush nuk bëjnë bashkë. Dy bostana nuk mbahen me një dorë! Vallah, s'di andej - këndeje, po shpija po shkon poshtë për çoban. Shkolla po na lë pa hajrin e fëmijëve tanë. S'di qysh do të mbesim gjallë, s'di çka do të ndodhë me ne... Çfarë rrnese do të kemi!

Nëna: *(E thërret.)*

O njeri, hajde se djalit i ka ra njëfarë simundimi! Po vjell!

Zeka:

Po edhe kjo më gjeti. Haj-haj, çfarë e keqe më polli kështu! *(Niset.)*
(Mbyllet perdja)

Skena e dytë

(Ngjarja zhvillohet brenda oborrit të Zekës. Në skenë duket Mixha Liman, plak me autoritet.)

Mixha Liman:

O Zekë, o Zekooo! A je kësajd, o i zoti i shpisë!

Zeka:

Po, po, kësajdpari jam. Mysafiri gjithmonë e ka derën çelë tek unë! Urdhno he burrë! Çka je ndalë aty, po hajde e hyjmë në odë.

Mixha Liman:

Jo mbrenda s'po hymë. Na të huej nuk jemi. Koha e mirë tek është! Po rrimë pak këtu përjashta. Ma tepër po kam qef me ndejtë te ky cungu në rreze në këtë lëndinë këtu se me hy mbrenda. Po t'i silli, në mos pritofsh, dy postaja. Kam ndie se e ke pasë djalin pak paqejf e shyqyr Zotit që të ka bënë më mirë! Për ata erdha edhe për urim, por edhe për me ndërrue ndonjë llaf goje me ty! Jemi kushurinjë e shumë rrall po takohemi.

Zeka:

Oj ti, sillnaji dy postaja dhe vëne gjygymin për çaj! *(I drejtohet Mixhës Liman.)* Faleminderit për urimin, por edhe më shumë për zijaretin që po ma bën!

Mixha Liman:

Nuk due kurrgjë. Ndjeva që djalin e ke pasë pak paqejf e thashë të këthehem për qejf, se ... *(Me të shpejtë nëna i sjell postajat dhe përshëndetet me Mixhën Liman.)*

Nëna:

Qysh jeni o, Liman aga, a ta qes një kafe deri sa të përvlohet çaji?!

Mixha Liman:

Mirë jemi. Falemnderit moj fisnike, shyqyr që djali ju ka bënë më

mirë! As kafe as çaj nuk due. Nuk është rendi i tyre tash. *(Kthehet kah Zeka.)* U plaka, o Zekë, e plaku e kish synin e untë, më të untë se të fëmijës, por po u duhke me e ndalë veten si me kafe e qaj, si me bukë, besa edhe si me duhan. Mirë kanë thënë moti: gjella do krypë, po krypa me karar. Me pi më pak kafe më mirë për shëndet. Po unë më unët po jam për llafe se për bukë e për kafe. Plaku kish dëshirë me pasë e me pa sa ma shumë. Për ata dhe unë po kam dëshirë t'i vizitoj miqt e dashamirët, besa edhe kushurinjtë se nuk dihet. Shpirt po bajmë, o Zekë, e shpirti, qysh u mahitke babëgjyshi, krejt budallë mundet me u bë: njëherë del kishe me shetitë e më s'di me u kthye! *(Flet dhe qeshet me zë.)* Merr udhë tjetërkah! Po edhe për zijarete s' po kam mjaft kohë se po më duhet me u gjetë kah shpija!... Miqasi e gjanë!

Zeka:

Zoti të paftë e të ruajtë dhe ta kthefsha me të mira! Bëne mirë që erdhe. Diçka nuk jam mirë. Më kanë pjellë një telashe që nuk e mendoja si telashe të madhe, mirëpo koha si duket ma ka sjellë dhe s'po mundem me ia gjetë ilaçin. Edhe njëherë po të them, bëne mirë që erdhe se s'po kam me kënd me qajtë dert!

Mixha Liman:

Telashet i kanë të mirat mbrapa. Plot telashe e plot gëzime është jeta. Kryesorja me shëndet e me qef me qenë njeriu mirë se për të tjerat i sjellë Zoti. Po ti thueje atëfarë halli. Ishalla s'është hall i madh.

Zeka:

Hala me djalin nuk i kam punët mirë. Diqysh nuk është mirë as me qejf e as me shëndet!

Mixha Liman:

Çfarë të miren ka tash?!... Ndjeva se ka bë më mirë!?

Zeka:

Më mirë po, por jo bash mirë. Atij iu ka prishë qejfi shumë që nuk kishte kalue në shkollë.

Mixha Zekë:

Me dije, kur të sëmuhet njeriu ai mbetet mbrapa shokëve, prandaj s'është çudi, pse djali edhe ka marrë nota të dobëta?!

Zeka:

Dikund tjetër është puna. Ai ka qenë i ftohun prej shkollës e nuk ka qenë i sëmuni. Pak u nda prej shkollës vetë e pakashumë i kam pri punës edhe unë. Po tash m'u ka sëmuni prej merakut?! Puna e fëmijës, po them! Mua fare nuk më është prishë qejfi. Babë e babëgjysh jemi rritë pa shkollë e nuk na ka gjetë gjë e keqe. Po ta them haptas, s'di se qysh, po m`u pat bë qejfi, kur e pashë se i pat humbë disi merakun për shkollë! Po kam qejf me ngarkue me punët e shpisë. Ndoshta mbetet kah shtëpia! Tash e mbas unë gjithnjë kam me e ndi mplakjen.

Mixha Liman:

He more Zekë, po thue me e ndalë në shpi, po pvet njëherë a po e mban shtëpia se!? Tash erdhën kohë të tjera o Zekë Rrafshaku! ... Fëmijën kurrë nuk duhet të mësohet me kohën e babës po me kohën e vet, kështu gjithmonë na kanë thënë të mençmit. Fëmija nuk rritet për shpinë tënde, por për shtëpinë e vet, për kohën e vet.

Zeka:

Tjera kohë po, po ka mbetë te njeriu po ai bark, po ajo gojë që po lyp me hangër e me pi. Po nuk u punua fusha nuk ka bukë, po nuk u mbajt lopa, s'ka njeriu me çka me e lagë kafshoren, s'ka me çka me pritë mikun. Në tjetrën anë more edhe mësuesit nuk po i kqyrin punët e veta bash si duhet. Më duket se m'ia kanë bë djalit pak si me hile. Ma kanë bë djalin me plasë. Ndoshta pse asnjëherë nuk i kam hatrue me kurrëgjë. S`i kam marrë në zijaftete! Djali po digjet flakë nganjëherë. Edhe pak më përpara m`u duk se e kapi njëfarë simundimi. Po plaka ia lagi ballin me do arrna të ftohët dhe më duket se i kapërcej. Po merakun i shkollës tash nuk po i hiqet kurrqysh. S`po i hiqet mendsh nota e dobët, thuese u ba nami! Edhe në jermi po i dëftohet.

Mixha Liman:

Paj njeriu i ri, prej merakut edhe mundet me u bë qartaqejfas, po me kohë besoj se i kalon! Po për atë notë të dobët qenka sëmuni-a?! Unë nuk e paskam dijtë. Ndjeva diqysh e tash e mësova punën qysh paska qenë.

Zeka:

S'di qysh me të thënë. Popo, ku është peni më hollë thonë aty këputet. Mendja e fëmisë është shtalb, hala pa u pjekë!

Mixha Liman:

Madje djali i dëshirit është si zogu i qurës, lehtë sëmuhet... Djalit me siguri i kalon... Kur kalon njëfarë kohe harrohen shumë punë të pamira. Njeriu kur po bjen në zor po e fajson gurin e drunin, e jo vetveten. Pak përpara më the se *edhe ata mësuesit kanë faj!...*

Zeka:

Po ashtu është. Për telashet e mia, në të vërtetë, ka gisht, si të thash, shkolla. Kanë hile bash ata mësuesit.

Mixha Liman:

Zekë, unë të due dhe për ata ta them drejt ndër sy se ma merr mendja se puna nuk është bash ashtu. Edhe mësuesit janë djemtë tanë. Ata nuk na duen të keqen. Ata po i kryejnë punët ashtu qysh po dihnë e sa po munden, në mënyrë që fëmijët tanë të bëhen më të dijsëm, më të sjellshëm. Ne duhet të kemi besim te ta. Di je mirë se ata janë veç hyzmeqarë të familjeve tona. Me shikue pak më gjanë ata janë sherbëtorë të kombit. Ata na duhet me i ndihmue e jo me i sulmue, ndoshta për të metat që i kemi na vetë. Po dihet nuk ka njeri pa kusure e mbasi edhe te ata njerëz janë, por t'i sulmosh për gjithçka është gjynah!

Zeka:

Na besim te ta po, po edhe ata besim te na duhet me pasë. E se qysh po na i mësojnë fëmijët atë mos ta flasim, pasi unë i shkollës vet nuk jam, por djalin çok ma sëmune ata, ja u sëmune prej sherrit të tyne!

Mixha Liman:

Të thashë, Zekë, mos hyn në gjynah. Besa unë për vete jam befasue për të mirë rreth kësaj pune. Para nja një vjeti isha edhe unë në shkollë. Çka me pa: gëzim, hare, këngë e lojna. U bënë dofarë xhadallash qysh i bënim ne ndonjëherë nëpër darsma e nëpër ndeja e festa të mëdhaja. "Shfaqje" po u thoshin tash. Zemra të kënaqej vetëm t'i shohësh se sa gëzoheshin fëmijët. Edhe luejshin edhe mësojshin. U kënaqnin edhe prindja, por edhe na pleqt që qëlluem aty. Një fëmijë sa llulla na mbajti fjalim: *ding e ding*, hiç pa iu tremb syni. E kam një çikë të djalit, të vogël fare, deri dhe asaj i erdh radha me dalë me recitue, besa edhe me vallëzue. Pak e ungja kryet, ku ia pashë buzefaqe ngapak të kuqëlueme, demek të ngjyeme si nuse, po nejse!... Kur e pashë se kurrkush nuk më shikoi shtrembët dhe ajo u përzi me shoqe, atëherë i shikova bash drejt dhe me plot gaz. Sa mirë loznin kopileshat, si flutura!... Shfarë

gëzimi! Sa fort u gëzuan edhe ata që i shikonin po edhe edhe që luenin. Në fund kur u dorëzuan nga një libër - dhuratë, sa shuplakat u rrahën. Mashalla u thashë... Edhe unë u gëzojsha bashkë me fëmijët. Dyqind a kushedi sa vetë rrap-rrap-rrap shaplaka! Deshta edhe unë, po duert më shkuen si kur po bajmë amin mbas namazit! (Qeshet.) Po shyqyr kurrkush nuk më vuni re. (Përsëri qeshet.) Tjetër herë edhe unë kam me rrahë shuplaka! Ndëgjo Zekë, çikë të djalit e kam veç, pasha atë Zot, m'u ka mbushë mendja e, do t'i thamë edhe djalit, se nga shkolla mos me e ndalë kurrë. Deri sa t'i ecë, le të vazhdojë. Madje edhe do t'i jap vullnet. Fëmijës s`duhet me ia ftohë shkollën. Duhet me ia ble librat e fletoret e krejt çka i duhen. Kur ta kryen shkollën le të bëhet e zonja e vetes. Mbas tashtit kush s'ka shkollë do ta ketë më të vështirë jetën. Shkollarët nuk mund askush me i marrë nëpër këmbë aq lehtë qysh na kanë marrë e po na marrin ne të pashkollëve. Femën më, duhet fejuë, duhet martue. A po e mban burri, a s'po e mban?! A po i pëlqen vendi a nuk po i pëlqen?! E kështu kur ta merr shkollën bile veten në e marrtë në qafë le ta marrë! Tash, more Zekë, kanë dalë e kanë me dalë edhe më shumë bidate e marifete të reja! Fundi i fundit ai që është për shkollë është edhe për shpi e ai që s'është për shpi s'është edhe për shkollë! Një zabit kish thënë qysh e ke djalin në shpi ashtu është i djathtë edhe në ushtri!

Zeka:

Çikë është edhe po do me çue në shkolla të nalta - a!

Mixha Liman:

Po kur shkova në një zyre e takova një nëpunëse që dinte me folë si na, më shkoj mendja e qysh me qenë edhe bijat tona qashtu të zonjat e me i zënë ato vende.

Zeka:

Edhe mue më ka shkue mendja kur më ra me shkue te doktori. Shyqyr që qëlloi një çikë e farës tonë, se kjametin qeshë tue pa! S'dijsha me u marrë vesh.

Mixha Liman:

Nuk je i pa mençëm, o Zekë! Po ato nuk bëhen nëse ne nuk i çojmë djemt e çikat tona nëpër shkolla. Dikuj s`ka çare pa i hec mësimi. Fëmijët tanë duhet me i zënë ato vende, si në hyqymet, si te mjeku, si në shkollë e kudo që do të ketë nevojë. I mjeri ai që nuk ka shkollë. Edhe ma i mjerë është ai që ka mundësi e nuk e ndihmon shkollën. Mbas tashit do të vijë koha që të jetë zor me të dhënë kush nuse për djalë po nuk kreu djali shkollë! Besa ka me u bë zor

edhe me dhanë çikën e pashkollueme! Po dihet se edhe shkolla ka vështirësi. Me marrë shkollë, thonë se është vështirë sa me mbajtë shpi.

Zeka:

Evladi evlad, po dhimbet, e dikush po luan me të si fëmija me gogla t'lloçit. Vërtet unë nuk ia bleva do libra që më tha djali më tepër prej nazgjasë se sa prej skamjes! Hajt, thashë, ndoshta bën edhe pa to?! Është e njëmendtë që ngapak djalin e kam ftohë me fjalë prej shkolle, po ata për atë punë nuk është dashtë me ma marrë aq me të keq, madje edhe mue me më marrë nëpër gojë!

Mixha Liman:

Ne jemi të unët për fjalë, për muhabet. Po kohën sot nuk e kam gjetë. Gjuha prej tuli po shkon gjithkah. Për mos me e zgjatë më shumë, po i pres drutë shkurt. Prej shkolle sot për sot, qysh po shihet puna, nuk është mirë të ftohet as djali as çika. Të thashë, me fjalë të tjera se fëmija duhet të mësohet për kohën e vet e jo për kohën tonë! I lashim mbas nesh në kohën e vet, o Zekë.

Zeka:

Paj, këtu s'di çka me të thanë. Edhe mue kjo po më shkon nganjëherë ndërmend. Se si thashë më parë. Djali ja i shkollës, ja i shpisë e ti më the ndryshe ai që është për shpi është edhe për shkollë! Unë mendoj pak më ndryshe. Shkolla është e mirë shumë, po për mua që e kam veç këtë djalë dhe ai më lindi në pleqni, më qejf kam me ndalë kah shpija, qysh më pat ndalë atëherë baba jem. Paj edhe një gjë tjetër. Edhe atje në shkollë nuk janë kah kujdesen aq. Vetë nuk po janë të zotët t'i mësojnë e po thonë ... Prindi nuk e ka kujdesin e duhur, ... Prindi nuk është interesuar, e të tjera e të tjera!... Ndoshta deshtën që prindi me iu çue pula të pjekne atyne!

Mixha Liman:

More djali pastë shëndetin, djali i babës e shpisë së mirë nuk e lë pa dalë i mirë! Dardha pikë nën dardhë! Ti sërish po e drejton ankesën kah mësuesit!

Zeka:

Jo, more Liman, nuk jemi aq të mirë, mirëpo, me të vërtetë, po më vjen njëfarë inati pse kanë thënë për djalin "nuk është i keq, po prindi s'është kujdesur", prindi ... ashtu e kështu!. Unë nuk mund ta çoj lidhun në shkollë... Ata vetë duhet t'i mësojnë... Unë s'kam çka lypi atje. Për njëmend kur filloi vala e punës e kam ndalë do ditë. Insan halli, nganjëherë po kam nevojë me më ndihmue në punë

e nganjëherë me ma ruejtë lopën. S`po bën ndryshe. Goja si deti që s`ngihet ujë edhe ajo po lyp panda me hangër e me pi. Si mos të punojmë tash nuk do të kemi çka me tubue për dimën. E ata po lypkan që nëse e ndali për punë të shtëpisë time djalin tem duhet me marrë leje te ata. Qysh ata me m`u bë zotshpije në shpinë teme!

Mixha Liman:

Edhe mue vjet ma patën dërgue një letërthirrje për në shkollë. Thashë, mbasi hyqymetin po duhet me ndëgjue pa çare, atëherë pse mos me i ndigjue edhe këta të shkollës?! Si thashë më përpara, shkolla është shërbëtore e familjes. Ajo po të ndihmon ty. Në vende tjera i paguejnë shumë mësuesit, madje ka familje që i paguen vetë mësuesit, jo një po shumë. Gjithqysh shkolla duhet me bashkëpunue me familje, po ashtu edhe familja me shkollën. Po shkollën duhet edhe na me ndëgjue besa edhe me ndihmue me mundësitë tona që kemi. Kush sa mundet e kush sa di. E kemi shpinë e përzieme me shkollën, o Zekë!... Më shumë fëmija po rri në shkollë se me prindin në shtëpi. Për ata patjetër duhet të merren vesh në mes veti prindi edhe mësuesi. Nejse, nuk po e zgjas, para se me shkue atje e bleva një paqetë cigare sipas kydretit tem.

Zeka:

Paj, pa dhënë e pa pasje kurrkund nuk po shkohet dhe kurrkush nuk po do me ndie për ty!

Mixha Liman:

Jo more jo, s'di si më ndodhi që cigaret e mia as që munda t'ua ofroja. Vallahi, ishin do djem të mirë. Ata mue më nderen me cigare, më pritën fytyrë hapur, madje njëni nga mësuesit që ishte kujdestar i klasës, qysh po i thoshin, më mori me vete në klasë, aty ku po mësojshin fëmijët.

Zeka:

Ashtu - a! Bash po më interesojka! Qysh po mësonin, çka po bënin? A veç po haliteshin!?

Mixha Liman:

Paj ndjeva shumë fjalë të mira. Nuk di të rrëfej, por me të vërtetë më kanë lënë përshtypje të thella, shumë të mira. Për çudi gjithë ata fëmijë, por të gjithë si ushtarë ishin të disiplinuem. Dijenia shumë e mirë. Mjer ne, thashë, që nuk patëm mundësi me u shkollue si duhet e nga mësuesit tanë kur ishim të vegjël! Mbas kësaj dite kam shkue edhe tjera herë. Edhe para do ditësh, si të thashë, isha atje kur i ndanin dëftesat dhe me atë rast dhanë një shfaqje të

rastit. Kah recitonin, këndonin, bënin lojna lloj-lloje, me të vërtetë ta lenin synin çelë. Unë u ndava shumë i kënaqun. Disa nga nipat e mbesat e mia morën libra-dhurata. Sa u gëzuen ata s'mund ta shpreh! Por më duket se edhe unë u gëzova edhe ma shumë se ata. Më falenderuan edhe mua. A di pse? Sall pse unë kishe jam kujdesë për ta. Pse kam shkue ndonjëherë deri te mësuesit dhe kam pvetë për fëmijët e si po thonë për "mbarëvajtjen" e tyre. S'ka më mirë se kur të lavdojnë në tubim, në kallaballëk! Po nuk iu ndejte gati fëmijëve ata lehtë mashtrohen. Fëmijët pa drejtues në shpi e pa mësues në shkollë mund të zhyten gjithkrah. Munden me e thye qafën lehtë!...Të thash se shkolla po bën rroghtarllëk për ne! Vallahi, kurrkush në shtëpinë teme nuk kish mujtë me i mësue fëmijët ashtu!

Zeka:

Po vallah ashtu është, fëmija është pasqyra e shtëpisë. Këqyre fëmijën e sheh familjen, edhe të babës, po edhe të nënës, thonin pleqt e mençëm.

Mixha Liman:

Mirë e ke o Zekë Rrafshaku. Nuk je i pamençëm, jo. U çova se boll ndejta, falemnderit për pritje e për këtë bisedë.

Zeka:

Rrimë, se tash na del buka. Më gëzove shumë që erdhe bile pak ma ke largue atë farë merzie që nuk po më lë rehat.

Mixha Liman:

Mërzi e telashe ka njeriu i gjallë, o Zekë. Pa mërzi është veç i pamendi, po ato është mirë me i bë sa më të lehta. I mençmi thonë edhe mërzitë e mëdhaja di me i bë të vogla, të përballueshme! Burrat e fortë edhe mërzitë e mëdha i bëjnë të vogla! Fjalët nuk sosen, ato duhet me i këputë nganjëherë... Nuk është mirë me e teprue me asgjë, as me fjalë. Sa për ndejë, unë nuk kam kohë me ndejtë më shumë. E sa për bukë nuk është nevoja. Unë nuk jam i largët, tash po shkoj në shtëpinë time, se ndoshta më ka ardhë ndokush. Po ti eja kur të keshë kohë se në odë më gjen me siguri.

(Del.)

Zeka: *(Tue e përcjellë.)*

Udha e mbarë e mirupafshim! *(Kah kthehet.)* Njeriu shumë po duhet me ditë. Për dije shumë gjëna po na shkojnë dëm. Shumë punë po bëhen dhe pa mend. S'po di njeriu se qysh po vjen e mbramja. Edhe mue qysh më polli kjo telashe me djalin tim.

(Bie perdja.)

Skena e tretë

/Ngjarja zhvillohet në odën e Zekës. Kur të hapet perdja Zeka shihet ulur këmbëkryq në postaje. Flet./

Zeka:

Shumë gjëna mësova, por grushti u çel, zogu fluturoi. Djali më mbeti *i dobët*. Nuk dita me e dashtë as djalin as vetveten! Me të vërtetë dëmtim i rëndë! Hej, një hap me mbetë mbrapa shokëve në rend kur prashitet a di sa humb njeriu, sa duhet me i dhënë zor për me i mbërri shokët, po treqind hapa kur njeriu mbetet mbrapa shokëve, mozomakeq, a di sa humbje të madhe ka?! Ndoshta edhe s`mundet me i zënë kurrë më shokët e vet?! Me siguri djali më është sëmuni për këtë punë. Nuk është pak ai ka mbetë treqind ditë mbrapa shokëve!... Dikuj i ka ra hise lavdimi, kurse djalit tim zehërimi! Dhe këtë zehër s'ja paskan dhënë ata në shkollë po më fort unë!... Po-po, unë!... Tash që m'u sëmuni djali kurrkush nuk po ma ka gajlen. Hallku po flasin kështu e ashtu, por gjithkush po fle në shtëpinë e vet, kurse unë me telashe as vetë s'po mund të fle, as gruaja s' po është e qetë!

(Ndërkohë ndiehet zëri i fqinjit /Bardhyli/)

Bardhyli:

O Zekë, o Zekoooo! A je kësajd, o burrë i dheut!

Zeka:

Popo, këtu jam, urdhnoni e për *burrë të dheut* s`e di?!

Bardhyli:

Po mos u dorëzo he burrë, shyqyr të tëra të mirat i ke. Besa edhe trimni e burrni ke dhe përherë ke pasë. *(Hyn brenda dhe ulet.)*

Zeka:

Mirëseerdhe, more kojshi. Është e drejtë fjala që thonë se në fatkeqësi e në lumtuni, në deka e në dreka, më të afërt e ke fqinjin se vëllanë e një gjaku, por që e ke larg me shpi!

Bardhyli:

Ngjatjeta! O Zekë Rrafshaku, sot kam ardhë si me punë. Tash po vi prej shkolle. Ata më ftuen e unë shkova. Edhe ty të kishin ftuar po ti nuk iu kishe përgjegur thirrjes. Atje veç tjerash u bisedua për mue e për djalin tem, po edhe për djalin tënd e edhe për ty! Aty e kam bërë një argat për ty e për djalin tënd!

Zeka:

A s`po kanë punë të tjera ata, veç të bisedojnë për ne-a! Edhe mue më kishin thirrë po nuk shkova. Thashë s`kam çka lypi mbasi djalin ma kanë ngelë! Po çfare argati bëne për mue, oj?!

Bardhyli:

Po na e kishim bë punën për me folë ata për ne! Aty i kishin pasë thirrë krejt ata, fëmijët e të cilëve kishin marrë nota të dobëta.

Zeka:

A qenë aty krejt prindët si unë pa shkollë-a?

Bardhyli:

Prej anës tonë djali jem kish mbetë për riprovim me dy edhe i yti me një notë të dobët.

Zeka:

Po qysh edhe i yti?! Ti ke bile edhe shkollë!

Bardhyli:

Po edhe kjo ndodhi. Ka lloj-lloj rastesh! Po gaca ku të prek të djeg, po ne na ka prekë shyqyr maje gishti që shërohet shpejt se me na pasë prekë mosallah në sy e në gjuhë më shumë do të lëngonim!

Zeka: *(E ndërpret.)*

Mue jo gacë po më duket se më ka ra vala e nxehtë e më ka përvlue! Po ti çfarë argati bëne për mue e për djalin tem, të pveta! Djali m'u ka sëmune. Shkolla a merak u i shkollës ma qiti djalin buzë vorri. *Shkolla, shkolla... nota!* - po i përftohen edhe në jermi! ... Nganjëherë s`po kam qef as me bisedue rreth kësaj pune. Ishalla djali më shëndoshet dhe ishalla e harron punën e shkollës!

Bardhyli:

Aiih, Zekë, sa shumë paske ndryshue. Unë nuk të njoh ty si njeri kaq të paarsyeshëm, edhepse të kam fqinj të parë! Puna nuk e ka me gjaknxehtësi. Kurse puna e shkollës as pak as tak nuk do hidhërim. Ti ke të drejtë të idhnohesh në mue që nuk të kam ardhë më herët me bisedue për këto punë të fëmijëve tanë!? Te dytë jemi rrëzue prej të njëjtës dardhë dhe duhet t`ia ndiejmë dhimbjet njëri tjetrit. Po unë nuk e kam marrë punën aq me ters si ti.

Zeka:

Jo Bardhyl, ti e ke shpinë tande. I ke hallet e tua!?

Bardhyli:

Kemi edhe halle të përbashkëta. Po të tregoj se kam folë e jam zotue në emën tënd si për vete?!... Merret vesh se zotimi jepet vetëm për atë që ka njeriu besim! E unë kam besim në ty. Ti sigurisht nuk ma prish?!

Zeka:

Fol ti fol, hajrli qoftë, çfarëdo që të jetë, çka do që të vijë mirë se ardhë! Po çfarë zotimi a argati ke bë për mue, o Bardhyl?!

Bardhyli:

Tregova se ti je njeri i arsyeshëm dhe u zotova si me pasë qenë ti aty se punën do ta kryejmë së bashku dhe qysh e lyp vendi e kuvendi.

Zeka:

Sa i përket shkollës nuk di se çka ke me bë për mue. Ata ma kanë ngelë djalin. Vetë kanë thënë se djali i zgjuet ... e andej këndeje, po faji i prindit! Çka kam me folë për atë punë më. Nuk është për pak o Bardhyl, djali nuk ka mbetë disa hapa mbas shokëve, po rrafsh treqind ditë?! Mbasi u thye ky farë kulaçi a mos është më mirë që Bardhin tash unë mos me e çue fare në shkollë! Djali po druaj se ka me më mbetë me ilet! Ka nisë me u kollitë ngapak. Shkolla edhe më shumë ka me ia rëndue sëmundjen!

Bardhyli:

Po unë për ata kam ardhë me të tregue se djali yt edhe djali jem nuk kanë ngelë. Ata kanë mbetë në riprovim. Dhe sado miza e mornica që ty të lëvrojnë nëpër krye, ti djalin nuk ke me ndalë kurrë nga shkolla. Djali të ka kaluar nëse ti kalon. Më mirë me thënë: djemtë tanë nuk i kanë marrë ato nota të dobëta po ato i kemi marrë në radhë të parë ne prindët e tyre. Pra, unë edhe ti. Po,po. Notë të dobët kam marrë unë që s`jam kujdesë sa duhet për djalin tem. S`e kam këqyrë se kah po shkon e qysh po sillet pas një flame që i pat ra. Unë i jepja pare për ilaçe e ai hajt në qytet. Ia kam plotësue dëshirat për së tepërmi dhe nuk e kam kontrollue e ai ish halitë me duhan e... besa edhe me ndonjë gëllënkë raki etj.! Po notë të dobët ke marrë ti se pak je kujdesë për të. E ke ndalë për pak send nga mësimet. Për me ta pru qerren te ara. Me ta lëshue lopën me kullotë. Jo andej, jo këndeje, veç sa me ia ftohë shkollën djalit! Krejt këto punë kishe mundë vetë me i krye edhe pa djalin, po edhe me djalin, por pa ia ftohë shkollën. Për ata po them, djali të ka kalue nëse ti kalon?!

Zeka: *(Habitshëm.)*

Qysh, ç'je kah thue, bre!... Folë pak më qartë. Qysh unë nëse kaloj, djali ka me kalue?! Unë s'di me shkruë as me këndue mirë veç tue belbëzue e ti?! Djalit kam dashtë me e mësue, atë që di vet, atë që më ka mësue baba jem mue: qysh ngjitet qetë. Qysh lavrohet. Qysh ruhet lopa e të tjera e të tjera. Qato i di. Edhe djalit ia mësoj. Marre është djali burrë e mos me i ditë këto punë të bujku. Po për ato punët e shkollës nuk i di, prandaj s'kam qysh me kalue! Po nuk po e fsheh dobësi kam edhe unë se djalit ia kam ftohë shkollën deri diku!

Bardhyli:

T'i lëmë ato fjalë. Fjalamujtas nuk duhet me folë. Mos u shtir se gjoja nuk po kupton?! Kurrkush nuk po thotë mos me e mësue djalin edhe me punë të bujqësisë e të blegtorisë. Po është e vërtetë se djali do të kalojë nëse kalon ti. Tash ke ti një provim me dhënë për hatër të djalit. Qysh të ka ndihmue djali ty në punë, ti tash duhet me i ndihmue atij! Ndëgjo! Gjatë pushimeve djali ka me i lexue ato libra që s'i ka lexue me kohë, po që janë të parapara me program për mesimin e tyre në shkollë. Duke u bazuar në aftësitë e djemve tanë, se më përpara kanë ka kalue mirë në shkollë, siç u tha në mbledhjen e arsimtarëve, me siguri djali yt si dhe imi në riprovim do të kalojnë. Kështu që ata përsëri me një vrap të vogël që do të bëjnë pasi të mësojnë gjatë pushimit do të mundën vitin e ardhshëm me i zënë shokët dhe bashkë me ta me i ndjekë mësimet në klasës vijuese. Për këtë punë ne duhet t'i ndihmojnë tue mos i penguar, më së pari me qëndrim, me fjalë e së dyti me punë! Pra unë në vend tëndin e kam vra me pushkë inatin dhe kokëfortësinë për mos me bashkëpunue me shkollën!

Zeka:

Unë për vete pata bë njëfarë pleqnie që shyqyr po kryhet gajla e shkollës dhe djalin do të mbajë pranë me më ndihmue.

Bardhyli:

Ato mendime hiqi mendsh. Nuk të duhen ty as mua. Kjo punë veç u mor vesh. Pa shkollë kush e lë djalin ai është armik i tij. Kjo është ai provimi i parë që duhet me e dhënë ti bashkë me mue.

Zeka:

Më thuej ti, lopën kush do të ma ruaj?

Bardhyli:

E se gjithë ato lopë që m'i ke. Ashtu si edhe unë nga një bisht lope kemi! Madje, me thanë të drejtën, një, po më mirë se dhjetë të dikurshmet po qesin tamël, kur po i ushqejmë qysh duhet. Mbaje mirë në ahër, pastroje çdo ditë. Ushqeje qysh po thotë veterineri dhe tambël merr sigurisht më shumë. Rrallë nganjëherë nëdash lëshoje sa për qejf, sa me marrë ajr. Mbaje më fort me krunde, me sanë e me jonxhe. Më mirë e më lehtë për ty. Më mirë e më lehtë edhe për të e për plakën tënde. Sivjet arën a livadhin theje e mbille jonxhe. Nëse nuk të ka qëllue farë eja merr sa të duhet te unë. Sanë e jonxhe nëse s` të ka qëllue për sivjet eja merr te unë. Në mot ma kthen. Unë t`i di mundësitë tua. Nuk e kam fjalën veç si fjalë po e kam përnjëmend fjalën si punë. Dihet se në këtë mënyrë më shumë po fitojmë edhe pleh edhe tamël. Plehu nuk po na hup fushës e malit, por edhe qumësht po qet lopa më shumë. Sa argati humb tue ruejtë lopën a po e bën mend ndonjëherë!? Më shumë fiton me ble ushqimin për të e kur ta keshë ushqimin tënd, atëherë vërtet ndahesh me fitim. Këtë s`e luan topi. Kështu është. Pra mos e bën punën llugë e therrë, pa qenë as shkurrë e vogël ajo. Tash po e sheh se nuk ka më kullosa as për ty as për mue as për askënd, pra edhe një e mirë tjetër: nuk na digjen e lodhen fëmija gjithë ditën në diell e në kohë të keqe. Paj fundi i fundit nuk kemi hesap t'ia humbim kohën fëmijës mbas një bisht lope, kur ka derëdalje tjetër bile edhe më të mirë dhe më me fitim. Djali le ta vazhdojë shkollën. Madje edhe le të punojë çka mundet e çka duhet domosdo në shtëpi e për shpi të vet.

Zeka:

Po djalit çka t`i bëj që m`u ka sëmënë?!...

Bardhyli: *(E ndërpret.)*

Po e di se çka po do me thënë. Djalit ia gjejmë ilaçin. Ashtu siç ia kam gjetë djalit tim. Krejt varet prej teje. Ti mos ia nxi jetën atij. Bardhi kish folë me djalin tim dhe i kish treguar për ilaçin që e shëron.

Zeka:

Si? Me ia ngreh pak veshin-a?

Bardhyli:

Arsimtarët, si të thashë më parë, folën për të dhe erdhën në përfundim se nëse nuk e pengon ti djali në riprovim ka me kalue, ngase ka aftësi për të vijuar mësimin në klasën vijuese si më i miri nxënës. Ata konstatuan se ti e ke ndalë disa herë prej shkolle

dhe ia ke bë me dije djalit se po ke qejf me e ndalë krejt prej shkollë. Nuk i ke folë kurrë mirë për shkollë e ku ta di!... Këtë nuk duhet t'a bësh më. Pikërisht kjo ftohje kish ndodhë edhe me djalin tim po në një tjetër mënyrë. Ata të dy janë shoqnie ngushtësisht. Po djali jem kish bë edhe do dreqnillëqe të tjera tue shfrytëzue zemërbutësinë e nënës së vet si dhe moskontrollin tim! Çka me bë janë në moshën më delikate të jetës së tyre. Me fjalë të tjera, as unë as ti s` duhet me i ftofë prej mësimit. Sigurisht duhet me i angazhue edhe në punë të tjera të rëndësishme, po punën e shkollës nuk bën me ua ftohë. Na duhet me u dhënë fëmijëve zemër drejt rrugës së drejtë, drejt shkollës. Nuk po të flas më shumë. Të gjitha i di ti më mirë se unë, por nuk është mirë me lejue që edhe të tjerët të përzihen në punët tona! Kur ka njeriu vullnet i kryen punët më mirë pa lënë gjë keq si punët e shkollës, ashtu edhe punët e shpisë, që po thue ti.

Zeka:

Si i thonë fjalës, unë po dorëzohem, veç mirë le të bëhet. Le t`i gjindet ilaçi djalit!

Bardhyli:

Nuk është gabim fjala që thuhet se nëpër pësime korren mësim!... Ku është Bardhi, sillmani këtu menjëherë t`ia japim bashkë ilaçin. Atë ilaç që ia dhashë edhe djalit tim... *(Nëna vjen së bashku me Bardhin. Bardhi përshëndetet me Bardhylin.)*

Nëna:

Qashtu djali i nënës, sa mirë di me u përshëndetë!

Zeka:

Pse është pak paqejf, goja s'iu ka marrë, ishalla!

Bardhyli:

Jo more, shyqyr djalin e keni si drita. *(I drejtohet Bardhit.)* Ty Bardh që të due si djalin tim, s'dua ta shoh më buzën në vaj e qehren e mvrenjtur. Mos i bën më merak prindët. Dua të të shoh vetëm me buzët në gaz. Ashtu qysh të duan edhe prindët. Më duket se ajo që ndodhi më nuk do të përsëritet. Nuk po e zgjas ma shumë. Tash është puna qysh e di edhe ti: duhet të riprovohesh në lëndën e caktuar, ashtu si edhe djali im. Duke u bazuar në aftësitë dhe vullnetin tënd si dhe të djalit tim mund të konstatoj që tani se ti edhe djali im keni me kalue vitin. Dhe vitin e ardhshëm duhet me mbledhë mend dhe me dalë ndër më të mirët në klasë. Bile edhe përpiquini me marrë dhurata. Por më së pari, ju lutem, të na i falni ato notat tona të dobëta e pastaj përmirësoni edhe ato të juajat! Ne kemi

vendosë qysh e japin besën burrat se nga shkolla kurrë nuk do t`ju ndalim, as nuk do t`ju ftohim. Këto libra i mora në bibliotekë për ju. *(Ia jep disa libra të lekturës që i nxjerrë nga çanta.)* Konsultohu edhe me djalin tim. Lexoni veç e veç e pastaj diskutoni bashkë. Nëse ju duhen libra të tjerë shkoni e merrni vetë në bibliotekë. Lexoni, mësoni e mos e humbni besimin në forcat e juaja, se ajo që ndodhi besoj se nuk do të përsëritet më. Dorëzan e kam vetë Zekën. *(Dhe i drejtohet Zekës.)* A është ashtu?!

Zeka: *(E miraton me krye dhe ofshan duke u rrudhe krahët.)*
S`kam çka shtoj asgjë për këtë punë!

Bardhyli:

Pse po ofshan, burri nuk lëshon gjëmë për të madh gazep.

Zeka:

Po më punë të rëndë e kob që kam bë unë kush nuk ka bë. Djalit ia ftoha shkollën dhe ia solla gjithë këto kokëçamje.

Nëna:

O Zot shyqyr, po kah erdhi kjo zbutje zemre, prej teje, o burrë! Lumja unë, edhe djali m'i çeli sytë. I erdhi çehërja qysh duhet. Unë e kam ditë se djali m`u sëmune për punë të kësaj shkolle! *(Flet dhe del prej ode.)*

Zeka:

Ndëgjo këndeje Bardh, ndoshta s'kam mundë kurrë me të gëzue. Jo pse nuk të due, po pse s`kam ditë! Sigurisht se prindi eulatin e do shumë, madje më shumë se vetveten, po nganjëherë ndoshta edhe nuk di me e dashtë! Kurrën e kurrës mbas tashit nuk kam me ta pre hovin e mësimin. Dije mirë se gjithmonë kam me të ndihmue me mundësitë e mia që kam. Tash mbas tashi në shkollë do të vij nganjëherë me i pyetë e me i njoftë edhe mësuesit e tu!

Bardhi: *(E përçafon.)*

Babi im i mirë asgjë nuk dua prej Jush pos mirëkuptimit. E di se sa i mirë që je!... Edhe unë do të angazhohem më shumë e me gjithë zemër edhe në kryerjen e punëve në shtëpi e rreth shtëpisë!

Zeka: *(Ia jep dorën si burrat.)*

Tashmbastashti mësimin ta keshë në radhë të parë e për punë të tjera sa të mundesh. Për atë që shkoj, goftë e kalueme dhe e harueme. Ndëgjo këtu. Atë notën e dobët nuk e ke marrë ti po unë e kam marrë, qysh po thotë me të drejtë Bardhyli.

Bardhi:

Jo babë, unë e kam hisen më të madhe të notës së dobët. Më fal se kam mundur të angazhohem më tepër edhe në punë të shtëpisë edhe në punë të shkollës, po...!

Bardhyli: *(E ndërpret.)*

Urime e suksese në punë e në jetën që rrjedh! Veç e kam edhe një lutje për Bardhin. Atë lëndën tjetër në të cilën ka me u riprovue djali im të lutem ta ndihmosh se më kanë thënë se ti e njuh atë lëndë shumë mirë.

Bardhi:

Falemnderit! Sigurisht do ta ndihmoj.

Zeka:

Falemnderit! Jo për një argat, por për shumë më ke shti borxh, o Bardhyl, veç ishalla ta shpërblej me të mira!

Bardhyli:

Po na fqinj jemi. I kemi borxh shoqishojt. Djemve u dëshirojmë suksese në shkollë, në punë e në jetë! Po çohem tashti.

Nëna:

(Nëna sjell petulla me mjaltë për shëndet të djalit dhe për me nderë Bardhylin.)

Jo përzete, s'po na shkon bash ashtu, që i pruna këto petulla sa me njomë pak gojën! Po mjaltën e ujin e pakam harrue!

Bardhi:

Qe unë po shkoj me marrë ujë taze!

(Mbyllet perdja.) **(Fund.)**

(Ferizaj, nëntor 1961)

JO SHKULJE PO PËRNGULJE

(dramë)

- Personat:**
1. Xhelë Kodrisha, (burrë i moshuar nga qyteti)
 2. Nëna (gruaja e Xhelës)
 3. Vahidi (djali i Xhelës)
 4. Besnikja (e shoqja e Vahidit)
 5. Agimi e Gimja (nxënës, fëmijë të tyre)
 6. Hoxha
 7. Xheka (serb), i njohuri i Xhelës
 8. Ahmeti (fshatar i moshuar)
 9. Mësues Sylja, nga fshati
 10. Mësues Skënderi, nga qyteti
 11. Plaku: një fshatar i moshuar dhe të tjerë

/Ngjarja supozohet të ketë ndodhur në fillim të viteve '60, fill pas të të ashtuquajturit Aksion për mbledhjen e armëve në Kosovë, kur, sidomos gjatë dimrit të viteve 1955-56, u ndërморën masa represive drakonike kundër shqiptarëve, me qëllim të thyerjes shpirtërore si dhe për përshpejtimin e shpërnguljes së tyre në Turqi. Veprim ky që, edhe pse la pasoja, në njëfarë mënyre, njëherazi, u kthye bumerang kundër vetë dhunuesve dhe qëllimeve të tyre.)

Skena e parë

Pamja e parë

/Në një rrugë tipike të qytetit Xhela me fes në kokë dhe me veshje të zakonshme qytetare, sapo ka dalë nga xhamia së bashku me imamin. Ndëgjohet biseda e tij me hoxhën.)

Xhela:

Të thashë, efendi, se veç Zotit s` di kush mundet me na ndihmue. Na u ka flugë keq zullumçari.

Hoxha:

Po Zoti, xheleshanuhu, na porosit që edhe na vetë me u mundue me i ikë rrezikut. Për ata ti ka dhënë Zoti mendt e të gjitha sifattet e tjera. Kulli i Zotit duhet me qallshtisë vetë. Kush mundohet me marrë rrugën e dinit e të imanit edhe Zoti pashybe e ndihmon. Edhe ti mirë e ke. Mbështetju Zotit! Allahu ka kydretin e madh. Unë për vete e kam ndërmend me shkue këto ditë në Istambull. Atje ma kanë gjetë një vend në një xhami. Atje kam boll akraba. Disa prej të mive qysh moti janë shkulë atje. Do të kabiles teme, lavdi Zotit, janë edhe mirë me idare e disa hala jo.

Xhela:

Këqyr, lumë Hoxha, edhe pse e kam porositë edhe Hafëzin, që iku më herët, si të shkosh atje, kujdesu edhe për familjen teme. Se po më duket se nuk kam çare pa u shkulë edhe unë. Kur më thirrën atë ditë në Stanicë, një milic më tha: - A hala s'e ke shitë shpinë me shkue në Turkie - a?- Jo, i thashë, ndoshta më ke ndërrue me ndonjë tjetër se unë nuk jam turqeli dhe atje nuk e kam kurrnjë temin?! Shpinë nuk e kam qitë në pazar! -Çka, çka, - më tha,- kujtova se ti je më i mençëm se e ke gjetë derën e shpëtimit, po ti, si duket, nuk po kuptojshe hiç shyp! Unë e di mirë, - vazhdoi ai, - se kush je ti. Ti s`mendon mirë për dërzhavën tonë! - kështu ma la damkë në zemër dhe shkoi. Dertin ia qava edhe atij kojshi Xhekës. Edhe ai ma la çelë shkuljen për Turqi.

Hoxha:

Po ata veç ta paskan bë me dije se veç shkulja prej këtuhit të shpëton prej telasheve të këtyneve. Inshalla edhe ata në Turqi nuk na dalin në rrenë. Edhe atje boll ka që janë mbushë qyfy e haram, që prej kohës së Ataturkut! Po s'ka tjetër rrugë, ja me pranue poshtnim e dekë për së gjalli këtu, ja me ia mësyje për selamet në Turqi! Nejse, nëse është kysmet: shkoj e zë vend para teje atje, qysh u morëm vesh, do të kujdesem edhe për ty. Po ti ngutu me pazar. Si ta marrësh kaparin, sa e qysh kallëzomë, qatëherë mundet me u dijtë se me aq pare çka mundemi me bë atje. Sa me u kapë pak se mbasandej, e dhëna e Zotit! Në fund të fundit, shyqyr që e kemi atë Turqi për me gjetë derman, sa herë që biem shumë në zor!

Xhela:

Po po, do të përpiqem sa më parë. Natën e mirë efendi!

Hoxha:

Selam, ejvallah.

Xhela: (Vazhdon rrugën vetëm.)

Njeri me mend është ky hoxha. Këtu punët mirë edhe atje ku do të shkojë e ka ndreqë vendin. Dikuj shulevek po i shkojnë punët e unë i ziu as këtu mirë e pale atje. Kush e di se çka do të bëhet me mue e me familjen teme?! O Zot më ndihmo edhe më drejto! Lail-lahe-ilallah! Edhe atjehen dikush po ma lavdon shumë e dikush jo. Zoti e di se qysh është e qysh do të bëhet. Pale qysh e ka shkruje Zoti?! Unë kysmetin e hajrit po e lypi. Si po duket, patjetër më duhet me u shkulë prej këndeje e çka bëhet e qysh më del atje në dorë të Zotit!

Pamja e dytë

(Pak më tutje po në rrugë e takon fqinjin serb Xhekën.)

Xhela:

Xhekë, ku je bre kojshi!

Xheka:

Mirë bre *pobratim*, mirë jam, po mundet njeriu me qenë edhe më mirë!

Xhela:

A ke hecë për atë farë punën teme a mos më ke harrue?!

Xheka:

Për ata që folëm atë ditë po të kallëzoj se kam bërë diçka. Qysh të pata thënë. Unë i thash atij djalit të kushërinit që punon në *SUP* (në *Shtëpinë e Madhe*) se ty të kam dost edhe kojshi. Se nuk je as nuk ke qenë kurrë shërri i kurrkujt. Je njeri *bogolinë*. I thash se me pasë ai pushkë ja unë kisha më marrë vesh ja kurrkush.

Xhela:

Ah, bre Xhekë! Na njihemi qysh moti. Po unë, vërtet, nuk kam qenë kurrë e keqja e kurrkujt. A i kallëzove atij nipit se, vërtet, baba në kohën e *Bivshes* ka pasë punë me kaçakë. Po, me sa di unë, ata atëherë me zor na patën hy në shpi! S`ka mujtë baba as me i përzënë as me i pre në besë. Mbasandej mbasi ata do u shpërndan dikah e do kaluan në Allbani dhe na për me shpëtue prej tehit të sakicës së hyqymetit u detyruem me e shitë katundin dhe, vërtet, deshtëm me shkue në Turqi. Po ata të Ambasadës së Shkupit nuk na pranuen se nuk ditëm asnjë fjalë turqisht. Kështu atëherë në Turqi pa e mësue bile pak turçen nuk pranojshin, kurse në Allbani nuk ke kysmet. Ndërkohë baba më vdiq, rahmetlija. Me paret e tokës dhe të mylkut të katundit patëm hy njëherë me qira në qytet e mbasandej e pata ble këtë shpinë këtu jo larg teje. Ndërkohë e pata ble edhe atë dyqanin për nallone që ma pate shitë ti. Kojshi me ty u bëmë dhe kaluem mirë, unë sa për idare: nallonexhi e ti zanatin tand saraç. Kurrë nuk ta harroj të mirën tënde kur ma more çirak djalit tem Vahidin dhe ia dha zanatin që edhe tash po i jep bukë.

Xheka:

Po more qysh jo. Po Vahidi ka pasë punue shumë mirë, pa pritesë. Ka pasë merak e për ata tash po ia sheh hajrin zanatit. Po, pa ndihmën teme e të shokëve të mi as që kish me mujtë me përparue as me pasë *sluzhbë* e *druzhbë* e besim aty në *preduzeqen* ku tash po punon!

Xhela:

Faleminderit! Po a po të kujtohet, bre Xhekë, që në kohën e Shqypnisë qysh t`i pata shpëtue robtë e shtëpisë prej italianit, besa edhe prej gjermanit. Sa herë bijshe në zor mule e te unë! Italianët këqyrshin me jua shnjërzue robnimin, kurse gjermanët deshtën me të marrë syrgyn, kujtojshin se jini gabelë. Mos me pasë qenë unë patën me të humbë krejt me sojesorollop. Po unë i përzjeva familjen tënde me familjen teme!... Këta të rijtë këto punë sot nuk po i dinë se a di qysh thojshin pleqt tanë: *uji shkon, tretet po zalli mbetet!*

Xheka:

Po po, Xhelë, pasha fenë, ashtu ka qenë atëherë. Po tash këta të rinjtë nuk po na ndigojnë. Tash po thonë *uji (hyqymeti) gjithmonë ka me mbetë e zalli ka me u ndërroe, ka me u tretë!*... He, more kojshi, kur nisa me i folë mirë për ty ai më priti keq, po mbasi e kemi edhe kumbarinë në një vend, u zbut pak. Po më kallëzoi diçka që po ta them vetëm ty, si në besim, e ti mos e shkep!

Xhela:

He, çka të tha?!

Xheka:

Sherri, -tha-, nuk është veç te na këtu, po atje naltë. Prej së nalti po u ardhkan *naredbat* e *uputat* që juve turqelive që keni lidhje me *allbanca* duhet me ju pakue sa ma shumë. Si në kohën e *Bivshes*, bile edhe më shumë. Atëherë qysh patën marrë masa ashtu edhe tash po donë me punue. Ti për mos me pasë kurrëfarë gajle, qysh e ke pleqnue edhe vetë: duhet me e shitë shpinë dhe me shkue në Turkie a në Shypnie a kah të mundesh. Një këmbë e më përpara më mirë. Se këtu s`kanë me të lënë rehat kurrë. Jo këta tanët sa ata qenat e Beligradit! Që kanë për qëllim me zhdukë fenë e farën e juej. More, qysh po e sheh edhe vet, veç tanëve, s`po ju lënë rehat edhe do të farës juej. S`po duan me ju lënë as xhami, as kurrëgjë fetare e kombëtare në këmbë. Do xhamia qysh e di edhe ti i bënë magazina drithi e depo takrravatesh. Po edhe ato tjerat do t`i bëjnë kafehane, ku do të përdoret raki e mozomakeqe të tjera, do kanë thënë me i bë salla për me luejtë fëmijët me top! Kështu po thonë. Bile për këtë punë po prijnë, qysh të thashë, edhe do *komunista* të farës së juej!

Xhela:

Mozomakeq. Çka kemi pritë e çka kemi me provue mbas tashti, more kojshi!

Xheka:

Edhe më keq po flasin për tash e mbas. Kur ata të hyqymetit, do komunista që e kanë në dorë sot, s`kanë fe, o Xhelë, s`ka me pasë as rahmet në *narod*, as për turk as për kaurr! Edhe më keq për ju. Po thonë që do xhamia më në zë, do t`i kthejnë në kisha, jo për hatër të fesë tonë, po pse ashtu paskan qenë moti, para kohës së Turkes! Kështu po thojka shkolla - historia, me dokumenta! E në ato jo me u kryque se njëherëpërnjëherë s'ka kush, po me i ruejtë *spomenika!*... Prandaj unë po të flas ty si me i folë zemrës seme! Një gjë dihet se kurrnjë e mirë nuk pritët për ju. More për ju jo se jo, po as për ne, as për fenë tonë. Mozomakeq! Por, për ju tash ka derëdalje, qysh po e di edhe ti, një këmbë e më para duhet me i shitë shtëpitë dhe me u shkulë në Turki. Shqyqyr që ju keni ku me shkue, o në *Turki-e*, o në *Allbani-e*.

Xhela:

Në Shqypni, s`bën hiç. Atje po thonë për fe është bë edhe më zi se këtu!

Xheka:

Për Allbani nuk di, por për Turkie tash nuk ka *smetnje*. Nuk pengon kurrkush. E di se atje ka liri: *slobodë e demokraci!* *Turska* ka lira të kuqe! Atje për muslimanin është xheneti i dynjasë, po atje mundet njeriu me marrë me duer të veta më kollaj çelësin për ahiret, për xhenet! (Flet pak më me zë të ulët.) Ndëgjo çka po të them, po të flasë si në besë, si të kisha mundësi edhe unë do të shkulesha atje, e mos me u përzie me këta *naselenikat* e *kollonistat* e rij që kanë ardhë, por edhe që kanë ndërmend me i pru prej dreqit të mallkuem, pale sa, pa hesap, shumë! Po kam qillue në tjetër fe e me ndërrue fenë s`pa kam se qysh! Me ndie kush se çka po them munden me më bë batare! Po nuk dihet! Ndoshta edhe unë do ta shes shpinë për me dalë njëherë në Shkup e mbasandej me u shkrue ndoshta si boshnjak a ku ta di, ndoshta edhe si serbjan pravosllav ortodoks se edhe na atje në Stamboll e kemi kishën më të madhe të fesë sonë *ortodokse*, më të vjetër se atë të *Rusies* dhe të *Holandarit tonë* e të *Grekies!* Ndoshta është kysmet na edhe atje me u bë kojshi! Veç në atë mënyrë ndoshta mundem me ardhë edhe unë në *Turkie!* Se këtu beli nuk jetohe!... Mos me e zgjatë, ai më tha, se ty mundet me t`u hjekë *dava* për atë farë pushke, veç nëse e qet shpinë në pazar.

Xhela:

Po unë shpinë e kam qitë në pazar!

Xheka:

E kur i thashë se ti shpinë e ka qitë në pazar, ai shtoi se jo veç me e qitë në pazar sall me fjalë po edhe me e shitë përnjëmend. Prandaj po e përsëris, ti vepro qashtu, shite shpinë sa më shpejt, ndryshe, si tha ai djali, nuk mundet me të dalë në ndihmë kurrkush. Dhe në fund po të tregon dosti ty. Ta kam gjetë një mushteri të mirë. Çoje djalin për me e pre pazarin dhe me e marrë kaparin. Le të vijë Vahidi në kafe te unë po kuvendim qysh me e lidhë *ugovorin*, po e lidhim vetë a po e bëjmë në prani të avokatit? Ti e di se unë me pak pare po i endi këtu punët e shitblemjes së shpijave, po për ty punoj pa pare. S` ke nevojë të më paguejsh kurrgjë. Veç më së mbrami mundesh me më *çastitë* diçka. Ta dish, veç për ty se unë pa më pague bile më përpara, me pare në dorë, këmbën s`e luej për kurrkend! Pra të tjerët më paguejnë për me ua gjetë mushteritë e ty ta kam gjetë vetë një myshteri të mirë. Tash po ka shumë shitës e pak blerës. Po për ty, të thashë, po të tregoj, si në besim, se me kaq pare sa të bën shpija jote, ti mundesh me ble në Turqi, jo një si kjo që e ke këtu po pesë shpija edhe më të mira bile! Qaq të lira janë shpijat atje, qysh po thonë!

Xhela:

Jo, edhe atje më tha hoxha se nuk janë aq lirë. Po kur t`ia tregoj shumë ai do të më japë njëfarë xhevapi.

Xheka:

Pale, ku ka këqyrë ai hoxha yt, ndoshta midis Stambollit a pale! Në Turkie edhe toka është shumë më lirë se këtu. Turkia është vend i madh, po edhe nafakën e ka të madhe! Po edhe sendet, të gjitha janë më lirë atje! Këto fjalë kanë rrjedhë prej burimeve tona të sigurta, drejtpërdrejt prej Konzullatës sonë atje!

Xhela:

Po sa tahmine bën shpija jeme? Qysh po shkon pazari i tyne?

Xheka: (I thotë diçka me zë të ulët.)

Po t`i mbaje pak më naltë! Po më mirë le të vijë djali, se ai merr vesh ma mirë për vleftën e pareve sot. Pazarin leja djalit!

Xhela:

Dihet, pazar bën më lehtë me atë që e ka mallin e babës se mallin që e ka fitue vetë. I mençëm je o Xhekë!

Xheka:

Vërtet, ty më shumë të dhimbet se atij, po mos u gajlo se unë nuk kam me lënë me ju shkelë kurrkush në pazar!

Xhela:

Po mirë besën ta kam dhënë se shpinë jam marrë vesh me djalin gjithqysh me e qitë në pazar dhe me e shitë. Unë ty të besoj se ti e di se nuk më rren dhe nuk më bën bishta, po edhe djali nuk më luen. Kujtoji edhe njëhërë të mirat që t'i kam bë, me atë kaçikun tem, në ato ditët e zeza për ty!

Xheka:

Për qata po t'i kallëzoj do sende si në besë, qysh thomë na, na *poverenje*, se të tjerëve ku s'kam besim nuk u kallëzoj hiç. Do të vijë një ditë, që shumëkushi kanë me i lënë shpijat shkret. Pa pare pa pullë kanë me e braktisë këtë vend, veç me pshtue kryet. Prandaj ti ngutu ma shpejt, si të thashë. Bile nuk është keq me iu kallëzue edhe atyre tuve në katund. Në mënyrë që edhe ata më herët le të bëjnë diçka në këtë drejtim. Sa më herët më mirë. Krejt këto po t'i them si në besim!

Xhela:

Po na njihemi qysh moti. Besimi në njëri - tjetrin na ka mbajtur gjallë e me kojshillëk të mirë deri tash.

Xheka: (E ndërpret.)

Pasha fenë, pasha dritën e diellit, unë të mirat e tua nuk mund t'i harroj, jo!! Për ata po të them që shite shpinë sa të bën pare tash dhe bëne ndonjë çare e mos prit. Tash, s'po them se kanë me ju shti me kryque, po gjithqysh kanë me gjetë vang për me ju përzënë. Dikë ndoshta edhe tue vra, dikuj tue ia marrë mallin me moh e qyshmos! Sidomos tash do ta kenë ma lehtë se në kohë të *Bivshes*. Po thonë se tash *dërzhave* jonë është edhe më stabile. Krejt bota po e përkrahin! Qysh po e ndien edhe qysh po e sheh edhe vetë. Tash është bë më e fortë se kurrë!

Xhela:

Falemderit, o Xhekë. Po shkulja punë e zorshme, bre! Jemi të lidhur edhe me miqasi të gjanë. Po si thue ti, më mirë me u shkulë sot me serma në dorë sesa pa kurrgjë nesër. Kur e pata shitë katundin e

erdha në qytet këtu, ndryshk më pati mbetë katundi. Kam pasë mylk të mirë atje. E kam pasë lënë kullën e re! Po nejse mbasi dola këtu gjallnova diqysh. Tash kjo shpi, të drejtën me ta thënë, më pak po më dhimbet se atëherë kur me babën e shitëm katundin. Ditën e mirë o Xhekë jarani! Të mirat tueja nuk mundem me i harrue kurrë! Në qoftë se ai farë djali juej ma largon hyqymetin prej shpine s` di qysh me ju shpërblye të dyve?! Shumë po e kam merzi, bre, tash si plak, me më përzi me turlifarë hajni, dilinxhie, katili e ku ta di unë! A di sa mirë më ka ardhë, kur një ditë nuk më la me pritë tanë ditën para Stanice. E po i mirë m`u duk. Falemenderit prej tij!

Xheka:

Hajt, bre ti, mos ke dert. Edhe në të thirrtë kush, thua je emnin tem e dert mos ke mbas tashit. Veç mos harro se çka të thashë! Shtini paret e shpisë në xhep se parja edhe ujin e kthen përpjetë. Me pare gjithçka e rregullojmë më shpejt e më mirë!

Xhela:

Mirë, mirë. Po edhe diçka, bënu fjalë mirë mos të m`i vonojnë "vesikat".

Xheka:

Edhe këtë punë ta kryej unë ose hiç pa pare ose fort me pak pare. Se janë do qafira aty, ngapak edhe po lypin hupca, si me thënë, po ngjyjnë me gishtin e gjashtë, që *punom shakom*, - qysh po thonë te na, po zhvoshin me krejt dorën, por ama punën po ta kryejnë! Edhe për këtë punë mue më ke.

/Përsëndeten. Secili vazhdon rrugën e vet./ (Mbyllet perdja.)

Skena e dytë:

(Skena paraqet një odë tipike fshati. Disa burra duken ulur këmbëkryq ballë oxhakut rreth e qark. Po ashtu në anën e djathtë të arallakut ulur në pastaja janë edhe dy-tre të rinj, të cilët të shoqëruar me qifteli e sharki nisin të këndojnë. Vargjet edhe mund të recitohen.)

Tue dhanë shpirt Turqia plakë
Tanë Ballkanit iu dha flakë.
Flakë e tym n'tokat shqiptare
I bënë forcat grabitqare:
Bisha t'unta a sa përbindësh!
Që i ranë Shqipes krahësh e brijësh!
...Dikah serbi, greku dikah,
Malazeztë e ndoj pejdah...
Keq e shkyen Shqipen pa mëshirë
Tue i hjekë gjymtyrë - gjymtyrë!
...Po do trima në Vlonë te deti
Shqipnin' shpallën shtet më veti!
Po kur n`luftë u rras Evropa,
Azi mbrëmta dhe krejt bota,
Shqipnisë keq në fund iu shtrua sofa:
Jashtë i mbeti Lulë-Kosova!...
Kështu shqiptarëve prej kësaj kohe
Kurrnji e mirë s`u shkoi për dore!
Se shumë mbeten nën sund të barbarit
Kralit t`serbit - Jugosllavit!
Që s`u la shkolla, s`u la këndim,
Për me i rrëxue pa hy n`provim...
Që me i robtue e me i përzënë
Kishe këtu s'kanë plang e të qenë!
Po zogu i shqipes thonë s`përkulet
Vendit të parëve kurrë nuk zhgulet.
- Nuk i lëshojmë, jo, - thanë, - tonat troje
as me hatër as me shumë zore!
Me na djeg mujnë me na na kallë
S' e lëshojmë vendin për së gjallë!...
Kështu na mësuen trimat e kohës
Si Ramë Bllaca e do njerëz të kokës
Që na lanë edhe amanet:
Me i ruejtë trojet me gajret!
Të gjitha vuejtjet me i përballue
Kurrqysh trojet mos me i lëshue!
...Po n` Luftë të Madhe dhe pak ma vonë
Disa të drejta zumë po i gëzojmë:

*Po mësojmë dije, po ndjekim shkolla
Gjithë tue u gëzue n`këto trojet tona!
Amanetin, shokë, mos me harrue
Rrajët n' këto troje me i forcue!*

Mësues Syla:

Ju lumt goja, more djem! Qenka këngë e re se nuk më ka ra rasti me ndie kështu më përpara.

Ahmeti:

Fjalët në këngë lehtë po ujdisen, kurse punët pak më vështirë. Po e mirë është kënga, po ta flladit shpirtin kur po këndohet. Kënga s`bën me u ndalë kurrë. Këto troje deri sot, njëmend, u ruejtën me mund, po edhe me këngë. Po mbas sotit s`di a mund do t`i ruejmë? S`di sa mund të durojmë?! S`di sa e qysh do të këndojmë në të ardhshmen! Se edhe me këndue nuk është kollaj!

Mësues Syla:

Edhe në kohë të Turqisë edhe më përpara shqiptarët janë shpërngulë nga këto troje, për arsye të ndryshme, por ata më të mirët, më të fortit mbetën këtu. Qëndruan. Trojet nuk i lëshuan! Trojet nuk i zbrazën!

Ahmeti:

S`di a më të mirët a më *qyqanat* mbeten këtu! Një mendje nganjëherë po më thotë se këtu mbeten pa u shpërngulë vetëm njerëzit e tokës, do qyqana! Na kemi qëndrue deri sot tue durue si lloçi në rrugë. Eja një rrotë prej e shkil, na lloç se lloç. Eja dikush bjer me grusht, kap e ndrydh, na baltë se baltë. Eja një tjetër shtrydh e ndrydh, na tokë se tokë. Po ky dheu ynë kështu gjithherë papçë se papçë!

Plaku:

Mos e bën krejt zi. Po ka pasë raste që kemi jetue edhe pak më shlirshëm. Qëndruem, u shumuem, u trashëguem, besa edhe luftuem! Hej sa munda është derdhë e sa vorre janë mbrumë me gjakun e dliurë të njerëzve tanë. Në këtë dhe të përgjakun dalin edhe lule të kuqe të përgjakta që na thonë për mos me e harrue amanetin e të parëve, qysh tha kënga.

Ahmeti:

Po-po, ashtu është po s`di sa ditë të bardha gëzuem se, kur dihet se këtë botë tonën e ka shkelë më sa dihet rrota e qerres së Romës, e të Bizantit, e Dushanit dhe e Shejtanit, dreqit e të birit dhe

tash më po dihet. Po njerëzit e mençëm e me shkollë, ku deshta me e qitë fjalën, kur po bijnë në zor s`po munden me durue, ata po ikin jashtë e s'po rrinë këtu si na njerëzit e lloçit. Ata me shkollë, po më duket si atëherë edhe tash po gjejnë shkas, më lehtë me u përbirue për me ikë dikah! Qysh dihet shumë njerëz të tillë shkuan më përpara e që po shkojnë edhe sot në Turqi, në Arabi, madje edhe në vende të tjera, deri edhe kah Rusia! se për Itali, Amerikë e Australi mos të flasim, po dihet! Kështu kemi mbetë veç na do qyqana që s`po kemi derëdalje tjetër. Ndoshta edhe na do të ikim dikah si të bëhemi pak më të zotët!

Plaku:

Unë për vete më mallë e bëj me ikë vetë e me hy në varr me këmbë të mia se me ikë në tjetër vend, edhepse po më thotë mendja nganjëherë se po bëni e u çel ndonjë derë e kollajshme krejt do të rinj axhami do ta braktisin këtë vend! Pra jo ata të shkollës, po do axhaminj! Për mendimin tem s' ka më mirë se njeriu me jetue edhe me pritë dekën në vend të vet. Edhe në hjekt keq s'ka dert. Në dhe të huej edhe buka e ëmbël t'vjen e idhët, kurse deka është tepër e rëndë! Veç axhaminjte munden me u mashtrua me dhena të hueja e jo ata me shkollë, qysh tha Ahmeti! Kurbeti është tjetër send. Nevoja të çon edhe në derë të hasmit, edhe në dhe të huej, po kur të mirat kthehen në vend e me vend mudi shpaguhet! Mjerim e gajbet është me e lënë tokën e bukës shkret dhe me lyp bukë në kurbet! Këtë e bëjnë veç, si e thashë, axhamia, njerëzit e papjekun!

Ahmeti:

Unë, s'di pse e çela këtë muhabet se edhe unë e kam mendimin tënd, por ka diçka edhe në drejtim të ikjes. Njoh edhe do me shkolla të nalta që po na ikin edhe sot se s'po munden me durue si na dikush-dikushi!

Mësues Syla:

Fjalët tueja, more Ahmet, vetëm pjesërisht janë të pranueshme. Vërtet, ka pasë raste që njerëz tanë me shkollë kanë ikë jashtë, por ata kanë ikë zakonisht prej ndonjë zori tepër të madh. Porse ata edhe atje nuk e kanë ndalë veprimtarinë për të drejtat e popullit të vet. Vendin e të parëve nuk e harruen assesi. Dhe dikush - dikushi po luftojnë edhe sot, qoftë me pendë, me diplomaci e me shkrime, qoftë me ndihma të tjera të ndryshme materiale. Vetëm në sajë të tyre është arritur që deri diku të njihen edhe hallet tona këtu e jashtë. Po si më kryesorë jemi na që jetojmë e veprojmë këtu. Pa ne as puna e tyre nuk do të vlente gjë. Dihet se anmiku

e di se njerëzit e dijshtëm e me shkollë janë më të rrezikshmit për të, për atë shkak edhe ata më së shumti i ndjekin, i burgosin, i mendojnë, besa edhe i vrasin me moh e qyshmos. Pra ikja jashtë është e lejueshme vetëm për ata që u rrezikohet jeta, jo për të mbetur atje por me ndihmë vendin tonë prej atjeshit me ndëgjegje të plotë, qoftë materialisht, qoftë politikisht e shkencërisht. Madje dihet se punët diplomatike e me pendë janë veprimet më të zorshme e me vlerë se punët tona të kazmës e të lopatës! Besa edhe vuajtjet e tyre jashtë janë shumë më të rënda se vuajtjet tona këtu!

Plaku:

Po edhe na këtu që kemi mbetë duhet të qëndrojmë edhe të rrënjëzohemi edhe më thellë në trojet tona dhe të punojmë që të përforcohemi sa më shumë, qysh na porositi kënga. Lisin me rrënjë të cekta e shkulë fryma, kurse atë me rrënjë të forta jo kurrë. Ndonjë degë mundet me ia thye, por rrënjë assesi s'mundet me ia zhgule.

Mësues Sylja:

S` është vendi këtu t`i kujtojmë ata që luftuen këtu dhe erdhën nga jashtë. Me organizimin të mirë edhe këtu brenda mund të jepet ndihmesë shumë - shumë e vlefshme për çështjen tonë. Ne duhet me iu dhënë zemër këtyre *qyqanave*, që po thue ti, që mos të shpëngulen, mos të shkulen, siç po thotë dikush-dikushi, por të ngulen e të përngulen sa më fortë. Me një fjalë, të kthehen sa më shumë në këto troje, le t'i sjellin fitimet e kurbetit dhe njëherësh mos të joshet për shpërngulje më askush. Kështu që me punën tonë ta ndryshojmë klimën në të mirën tonë. Na duhet ta njohim veten. Ne kemi forca dhe kemi mundësi në vetvete, po pak po e njohim vetveten. Pak po i njohim pasuritë dhe mundësitë që ka vendi ynë për me na përmirësue jetën tonë këtu e mos t`u marrim lakmi vendeve të huaja. Vërtet, po na ndodhin rrebtica të ndryshme, siç qe *Aksioni famkeq i mbledhjes së armëve*, por edhe këtë e përballuam e duhet t'i përballojmë edhe ndërskamcat e tjera! S`duhet bërë qejfin armiqve që siç po shihet tash riçelën dhe po e mbajnë hapët rrugën e shpërnguljes për Turqi.

Plaku:

Besa janë do gjind që po enden diku diku nëpër katunde me do farë *vesikash!* Po te unë ato letra nuk pinë ujë.

Mësues Syla:

Pikërisht për këtë punë kam ardhë sot te ti, o baca Ahmet. Kam ndëgjue se kushëriri ynë Xhela, që është shpëngulur në qytet që në kohën e Jugosllavisë së Kralit e paska qitë shpinë në pazar dhe po përgatitej për t`u shpëngulur. Ai s`ka kurrfarë motivi tjetër, pos faktit, siç më tha i biri, Vahidi, pse po i shkojnë shokët e tij, por edhe pse e kanë frikue dikush nga ata të "Shpisë së Zezë" për do gjëra të vjetra. Po ia lypkan një pushkë të kaçakëve e ku ta di unë! Atij, si duket ia kanë futë lepurin në bark dhe paska vendosë me u shpërngulë gjithqysh!

Ahmeti:

Po more kam marrë vesh diqysh edhe unë. Madje më thanë se axhën Xhelë e paskan pa kënde, para do ditësh. Ish hallallshtisë me ara e livadhe, me kodra e me male, edhe me këtë kullë prej së jashtmi! Se, për çudi, mbrenda nuk kishte hy. Kishte bë dua edhe te vorret e të parëve, po unë nuk kam qëllue këtu. S`di çka mund të bëjmë për të?

Plaku:

T`i thoni mos me u zhgulë. Kjo nuk është fjalë e vogël. Me i thënë se asaj pune i thonë: jo udhambarë prej nesh! E pa thënë i veti udhambarë ajo udhë kurrë nuk mundet me dalë e mbarë! Kush ka mend nuk niset për atë udhë.

Ahmeti:

Ashtu me i thënë po se po, po tutem se s`mund t`ia mbushim mendjen, sepse nuk po mund t`ia hjekim dajakun shpinës, qashtu qysh s`po mundemi me ia hjekë dajakun as vetvetes! T`i thomi qëndro se ernat ndërrojnë ndoshta e mashtrojmë, se s`po dihet se qysh do të ndërrojnë ato ernaa për mirë a për keq!? S`di çka t`i thomë, pasi që na s`e kemi pushtetin. E pushteti është ai që bën zullumin dhe shtypjen, që e sjell erën pas breshnit apo erë e breshën bashkë!

Mësues Syla:

Fundi fundit pushteti, pak si fshehtë e pak si haptas, e bëni të veten ndaj nesh, po na duhet ta bëjmë tonën. Gjithmonë kundrejt pushtetit të huaj na kemi reague tue formue njëfarë pushteti tonin. E kemi ntrashë dashninë ndaj njëni tjetrit. Ia kemi lidhë varrët njëri tjetrit. Mirëkuptimi e ndihma që ia japin na njëritjetrit janë armë e fortë që e paaftëson anmikun me bë gjithçka. Fundi i fundit axhës Xhelë t`i thomë se edhe kjo dhunë e armikut ka marrë hirrë a së shpejti ka me marrë edhe erë si tambëli i prishur. Tash

veç ka nisë me iu ndie duhmë e rëndë që ka me i zënë frymën vetë atij që e ka nisë. Zullumi këputet prej së trashi! Gjithqysh na duhet të shkojmë me bisedue me të. Për që e ka qitë shpinë në pazar ne s`kemi çka përzihemi, se kjo po i lëvërdiste edhe Vahidit, por që ka qitë fjalën me shkue në Turqi pa e pvet as djalit, as anëtarët e tjerë të familjes, as miqt e farefisit... për këtë edhe ne kemi çka me i thënë! Edhe na kemi hise edhe borxh me folë me njëriun tonë. Nuk po e zgjas. Kam marrë njëfarë selami, pra, që unë edhe ti, baca Ahmet, duhet me shkue gjithsesi dhe me e zbutë paksa çështjen në raportin me Xhelën.

Plaku:

Shumë mirë e paskët pleqnue.

Mësues Syla:

Njëherësh më ka bë me dije Vahidi se do të hapet së shpejti atje një shkollë për kualifikimin e punëtorëve. Ata nxënës e të rinj që do ta kryejnë këtë farë shkolle do të punësohen menjëherë në repartet e reja të Fabrikën ku po punon ai, ku, si duket, ai do të jetë njëfarë djejtuesi. Kështu nuk është keq që edhe dikush prej familjeve tona ta shfrytëzojnë këtë rast dhe dikë-dikë ta punësojmë atje.

Ahmeti:

Po qenka fort mirë me shkue, pra, sa më parë. Do të përpiqemi patjetër me ia bë batall axhës Xhelë at farë shkulljen a shkuemjen në Turqi. Sigurisht ata që i kanë dhënë zor atij kanë për qëllim që ai ta ngrehë këmbën zhag. Kështu që edhe neve familjen tonë me e tfillue po asaj rruge! Kjo është politikë e vjetër e anmikut! Për këtë edhe neve këtu po na bëjnë presion si edhe atij atje. Nëse atë e ndalim ke me pa që edhe ne kanë me na lehtë presionin.

Mësues Syla:

Shumë mirë ta ka pre mendja. Ky është qëllimi i armikut që ta çajë lirin me pykën e vet!

Ahmeti:

Po te unë ajo kurrë nuk do t`u shitet. Po gjithqysh po vyeka me ia gjetë çelësin edhe kësaj dere. Fundi i fundit na e kemi për detyrë me shkue me e vizitue njëriun tonë. Se Ahmeti e ka bë punën për mos me e harrue katundi. Na ka ardhë në të pame e në përhapime, madje pa ia bë me dije, pa e thirrë e pa e bë borxhli. Pra nuk na ka harrue. Besa edhe në darsma sa herë e kemi thirrë ka ardhë dhe na i ka hjeshue gazmendet. Edhe Vahidi është pika e djalit. Bile

ai përveç shkollës së zanatit, ka krye edhe njëfarë shkolle të naltë me specializim. Ai besa ka punë të mirë në atë Fabrikën e lëkurë-këpucëve, qysh më kanë thënë. Është dallue si mjeshtër edhe si aktivist shumë i zoti. Kjo puna për punëtorë qenka edhe më e mirë. Si ta kryejnë djemt tanë ndonjëfarë zanati, atëherë ndoshta Vahidi mundet me u bë fjalëmirë për me e shti dikë në punë atje! Shyqyr kemi djem prush. Boll kemi edhe për katund edhe për shehër.

Mësues Syla:

Nëse je ti gati po nisemi fill e në qytet te Xhela.

Ahmeti:

Gati jam, veç me u mbathë e po nisemi.

Plaku:

Udha e mbarë e të fala edhe prej nesh. Thuej se e ke selamin prej plakut të katundit: mos me u shkulë, po duhet me ndejtë ngulë. I vetmi shpëtim për ne është me i shti rrënjët sa më fellë në dheun tonë, në trojet tona!

(Ata dalin. Bie perdja.)

Skena e tretë

Pamja e parë

(Skena paraqet një dhomë tipike qyteti. Xhela me të birin Vahidin duken ulur në minder pranë njëritjetrit dhe bisedojnë.)

Xhela:

Si duket shpisë po i del kysmeti dhe vadjë e pagesës nuk është aq e gjatë. Për gjashtë javë, më thanë se do t'i sjellin krejt paret. Për me i krye do punë të tjera, se kapari ndoshta është i vogël, që këtu i kam një qese me pare që i kam rrujtë për ndonjë zor. Do i kam prej babës që i ka pasë nda për haxhillëk e do i kam nda qysh kur e kemi shitë dyqanin e nalloneve. *(Ia jep.)* Tashti zine një avokat të mirë. Siguro "vesikat" dhe kysmet sa ma parë po marrin rrugën për në Turqi. Hafëzi më ka çue fjalë se edhe ai atje ka folë me një avokat për ne dhe do të na mundësojë që pa mashtrime ta blejmë një shpi jo fort larg tij. Kur një punë niset me u bë ajo duhet të kryhet sa më parë. Mbase edhe atje do të gjindemi disi. Parja e bardhë për ditë të zezë, më ka pasë thënë baba! Më ka pasë porositë ja për çabe ja për ndonjë zor shpirti, ndryshe mos me i harxhue këto pare! Unë t'i bëna teslim. Në dorë të Zotit, ndoshta fitojmë, ndoshta sharrojmë!... Ndoshta atje do të më bëhet nasip me bë haxhillëk, edhe për vete edhe me shkue *bedel* në emën të babës.

Vahidi: *(I merr të hollat i shikon dhe ia kthen babës.)*

Paret le të rrijnë te ti. Lë të ruhen, ishalla i shpezojmë, jo për ndonjë zor të madh, po për ndonjë gazmend të madh! Sa për këso shpenzimesh të vogla që u thanë kam pare nëpër duer e për shuma më të mëdha shohim më vonë. Po, more babë, njëherëpërnjëherë nuk i kemi punët për me u ngutë rreth vesikave. Fëmijët i kemi në shkollë, mos t'i ftohim prej mësimit. Miqasinë e kemi këtu duhet ta bëjmë mend edhe me ta. E kemi mjedisin e gjerë. Duhet të mirremi vesh edhe më mirë ndërveti. Mue, mbasi e kreve atë kualifikimin e naltë, më kanë premtue punë më të mirë në Fabrikë. Madje më kanë propozue përgjegjës në Repartin e ri që është në themelim e sipër. Edhe banesën, si kuadër shumë i nevojshëm profesional e udhëheqës, më kanë premtue se po ma sigurojnë. Veç çelësat ende nuk m'i kanë dorëzue. Prandaj më duket se nuk është mirë me u ngutë. Këto pare mbase bë e gjetë për me zënë ndonjë shteg të madh: për mobilje e shpenzime të tjera rreth banesës së re, ndoshta këqyrim me e bë një veturë?! Ishalla i shpenzojmë jo për ndonjë zor shpirti, por ndonjë kënaqësi jete!

Xhela:

More mos folë ëndrra! Ku ka kënaqësi jete në këtë robni! Unë besën ia kam dhënë atij herifit se shpinë ia lëshoj me kohë. Si ta marrë kaparin jam marrë vesh me ia lëshue gjysmën e shpisë e kur t`mi japë krejt paret ia lëshoj krejt shpi e katandi menjëherë. Madje fjalën ua kam dhanë shokëve që i kanë përgatitë *vesikat* se edhe unë do të shkoj sa më parë me ta, ndoshta edhe para tyne. Këtu nuk rrihet më!... Deri tashti kurrkush prej miqsisë nuk ka thënë gjë për me na prapue! Fundi i fundit kurrkush s`ka punë me shpinë tonë. Unë njëherëpërnjëherë e di se na jemi zotshpije në shtëpinë tonë!
(E ngrë zërin paksa.) Ti nuk ma ke prishë deri më tashti asnjëherë! S`po të kuptoj pse tash po thue: mos të ngutemi e andej këndeje!

Vahidi:

Paj, për shembull, s'është mirë me ia lëshue gjysmën e shpisë blerësit. Ku me dijtë se kush qëllon. S'është mirë me e përzie familjen me njerëz të huej. Të huej me farë e me fe! Ndoshta del ndonjë si gjinsi i çika Savës, atij tullusumit, gojëpalamit! Si ta shtin një këmbë brenda më as nuk të paguen as s'mundesh me e largue më prej shpije! Të vardiset në robtë e shpisë!...

Xhela: (E ndërpret me zemrim.)

Po çka me bë?! Tek e mbrama si ta marrim kaparin po këqyrim me dalë na vetë diku me qira! Po s'di sa na rrinë në besë për paret e tjera se! Këqyri ti këto punë më mirë. Je më i kthjellët se unë. Por një gjë e di se çka të niset duhet me u krye sa ma përpara, ndoshta avokati na e shpejton shkulljen. Zine një avokat të mirë. Po ma përmend punësimin këtu. Po ti edhe atje do të gjesh punë. Fëmijët edhe atje do të mësojnë shkollë. Njeriu kudo që jeton e formon shoqinë e vet. Pajtohet me fatin. Mësohet me mjedisin. Po më shkon mendja nganjëherë te komieti, shqyptaria, por.... po thonë se atje, në Turqi, ka ma shumë shqyptarë se sa ka krejt Shqypnia. Veç në Stamboll po thonë ka më shumë shqyptarë se ka krejt Kosova! Boll e kemi se atje nuk do të na rrahin e poshtojnë milicia e të pafeve sa herë që t`u teket. Atje e ke popullin tënd. Besa, me sa di, fëmijët tuaj po munden lehtë me u marrë vesh edhe në turqishte, edhe pse ti nuk i çove në shkolla turke! Atje i kemi xhamitë e mejtepet çelë. Fëmijët mësojnë e kthehen kollaj simbas vendit. Atje e di namazin namaz, xhumanë xhuma e çdo gjë qysh e lyp shejrati!

Vahidi:

Po, babë, të thashë se banesën po ma japin! Pse të ngutemi?! Besnikja tash po e kryen shkollën e...

Xhela: (E ndërpret.)

Banesën nëse ta japim merre edhe menjëherë qite në pazar. Shite, në muejsh me e shitë. Prej thiut, thonë, nxirre një kime!

Vahidi:

E drejta e banesës lidhet me kontratë me punësimin në ndërmarrje, madje me detyrimet ndaj ndërmarrjen për mirëmbajtjen e banesave etj. Nuk lejohet shitja, zëvendësimi, vetëm shfrytëzimi!

Xhela:

Tash shko ku të thashë për kapar a me lidhë kontratë, qysh po i thoni! Xheka po të pretë në kafe të vet. I kam dhënë fjalën dhe unë s`due me m'u bë fjalët e mia si bishti i pelës: me luejtë andej këndeje! Mos me më zënë vendi-vend, mos me më zënë besë më kurrkush! (Vahidi del. Xhela rri mendueshëm. Qeskën me të holla përsëri e fsheh diku në dollap.) More s`di kush ma paska ftohë djalin! Po ... si ta shes shpinë, atëherë s`ka çare pa ardhë përmbas meje. Po ky vetë më shtini me e shitë shpinë e tash po bën vrëngjele! Vërtet, Turqia pak larg. Vend i panjohur, po edhe atje jetojnë njerëzit. Sigurisht do të pajtohet shpejt me kysmetin! Po kujton kush se unë e kam kollaj me u shkulë, po kur s`kemi derëdalje tjetër, kur po i mendoj të këqijat që mund të na vijnë prej këtyre qafirave, atëherë më mirë një këmbë e më përpara duhet me i ikë tehut të thikës. Ndhimoi Zot kullit tënd! Amin!

(Përsëri ulet dhe njuh tespihe.)

Pamja e dytë

(Skena e njëjtë. Xhela ulur në minder njuh tespihe, ndërkohë vjen i nipi, Agimi.)

Agimi:

Bababagjysh, po vijnë dy xhaxhallarë prej Kodrishe.

Xhela:

Hajde mirardhshin! *(Ndërkohë mysafirët hyjnë në odë. Xhela i pret mirë, mirret ngrykë me ta. Pasi përshëndeten në këmbë ulen të gjithë.)*

Hajde mirëseerdhët.

Ahmeti e Mësues Sylja:

Mirësetëgjjetëm! Tungjatjeta! *(Përshëndeten dor më dorë dhe ulen.)*

Xhela:

Lavdi Zotit që ju pruni. Ahmet, s`e kam ditë se të paskam jo kushëri, po bash vëlla e përtej vëllait. Po edhe ti Mësues Sylja mirë ke bë që më paske nderue. Vallahi, po ia dini rendin. Më keni ardhë bash tash kur kam nevojë për me iu shprehë dikuj atë që po më mundon, që po më vlon e po më përvlon këtu mbrenda! *(I kthen duart kah gjoksi i vet.)*

Ahmeti:

Dikush të ka pa që ke qenë kah katundi, po si kaçak! Pse nuk na urdhënove në kullë?!... Veç me dikë - dikë ishe përshendetë si prej së shpati e hajt! Nuk e di a të kishte kapë farë sikleti apo t`u dhimbtë kafja me na pi ne n` katund-a se s`po dimë me i qitë na katundarët?! S`e kam ditë se je bë edhe ti si ai shehërlia i moçëm që kur e kishin pvetë se a u merzite për 7 javë në burg ai përgjigjet:

-S`jam merzitetë, kur më ra puna një natë me bujtë në katund e po merzitna për 7 javë në hapsane! Ma mallë i kish pasë bë 7 javë burg se një natë mysafir në katund!

Xhela:

Mos Ahmet, se e di ti se nuk jam asi njeri unë. Po kam pasë sikletin që e kam edhe sot. Kam pasë mallë e thashë me ndejtë ma shumë mos po më shpërthejnë lotët e ashtu po koritna edhe po ju bëj merak kot edhe juve. Nuk po kam qejf që vogjëlimi ynë e kushdo gjithmonë me më kujtue me lot ndër sy!

Mësues Sylja:

Jo për axhën Xhelë nuk përshtat ajo që the, o baca Ahmet. Axha Xhelë nuk e ka bërë veten me e harrue katundi. Ai për çdo dekë e drekë sa herë e kemi thirrë a e kemi bë me dije na ka ardhë. Madje

në çdo përhaprim, po edhe në të pamira e taksirate na ka ardhë pa thirrë. Të mirat e tij nuk i harrojmë, jo.

Ahmeti:

Po ashtu është. Po nuk është puna veç kur të thirrin. Njeriu te i veti duhet me shkue pa thirë si në të pame e taksirate, por edhe në përhaprime e gazmende. Këtë ne e kemi traditë. E vend për përhaprime ka gjithmonë, si ka edhe për anën tjetër. Qe na kemi ardhë me t'i bë përhapr do pazarllëqe që i kishe nisë... Qysh është puna?! Kemi ndie që shpinë e kishe në pazar? E ke shitë a jo?

Xhela:

Po Ahmet, kysmet, shpinë pothuejse e kam të shitun. Njëfarë kapari hala s`e kam marrë. Për ata, pak pa ardhë ju, fola me djalin dhe i thashë me shkue me këputë pazarin dhe me e lidhë kontratën me atëfarë Xhekën, kojshinë e moçëm. Ai ma ka gjetë myshterinë. Sigurisht paska dalë kah kapixhiku kënde, (Bën me dorë.) mbasi nuk qenka zatetë në ju. Nuk po kam çare pa e shitë. Këtu po na mendojnë shumë. Ju në katund ndoshta e kini më lehtë. E kenë njëni tjetrin. Na këtu s` po kemi më as kojshi as kurrnjë tonin afër. Fqinj të e moçëm, që hiqsha mërzi me ta, pothuejse gati krejt janë shkulë ose po bëhen gati me shkue. Mue m`u kanë mshelë të gjitha rrugët e tjera. Veç xhami e shpi, shpi e xhami, tjetërkund s`po mundem me dalë. I kanë hapë dofarë kafehanesh, ku po pihet raki. Unë aty s`po mundem me hy. Deri edhe udhës po më mundon duhma e asaj virane! Mbasandaj ia nisën edhe me më thirrë në *Stanicë*. Po më lypin pushkë të kaçakve të kohës së Kralit, hej more hej! Kur po i shti mend andej, nganjëherë aq po mërzi sa është drojë me më luejtë mend e kresë! E pleqnova këtë punë me shokë e me imamin. Dhe si shumë të tjerë edhe unë vendosa me shkue në Turqi. Zoti e bëft mirë! Në mujsha me ndreq vendin për veti atje ndoshta ju thërras edhe ju të vini. Nuk dihet se ku qëndron hajri!

Ahmeti:

Tash e mora vesh pse s`je kthye te na, pse s`ke urdhënue në kullë. E ke dijtë se kisha me të pvetë se çfarë zori po të shtyn me shkue në Turqi. Nuk është më koha e Kralit, kur baba yt e shiti katundin se e mundonin xhandaria pse u kish dhënë bukë kaçakëve. Kurse ti kurrfarë buke kaçakëve s`u ke dhënë. Kam ndigjue se të kanë lypë pushkë, qysh na the edhe vetë. Po për një të pvetme që ta bëri një xhandar kaq shumë i trembe-a? Mue më kanë mbajtur 7 ditë rresht para *Stanicës*, Postë-komandës së policisë! Besa do netë më kanë futë edhe mbrenda. Më kanë lyp mitraloz. Më kanë tushkitë po për kaçakët e vjetër edhe për të rinjtë! Po veç urrejtjes më te madhe

ndaj tyne te unë as një ligshti s`kanë mujtë me mjellë. Ka me ardhë dita që na vetë kemi me lypë hak, besa edhe me i nxjerrë këto haqe! Sillet rrota, o axha Xhelë! Ata po të duket se na kanë në dorë, por jo Xhelo, jo! Zoti mundet me na pasë në dorë jo ata. Dhe Zoti kemi shpresë se gjithmonë nuk ka me ua lënë në dorë hyqymetin atyne.

Xhela:

Ishalla bëhet mirë!

Mësues Sylja:

Veç ka nisë tash me marrë frymë puna edhe te ata. Ke me pa se së shpejti ka me i dalë tymi kësaj punës qëllimkeqe të tyre. Është e vërtetë se pushteti i keq të dëmton, por në anën tjetër edhe të forcon, nëse je i vendosur me jetue në trojet tua!

Ahmeti:

Tash kemi edhe ne do njerëz me shkollë e do t`i kemi edhe më shumë. Fundja i kemi të çeluna edhe do shkolla tona! Gjithsesi kemi shkollarë e të dishëm shumë ma shumë se që kishim në kohën e Kralit! Ishalla do të kenë më shumë fat se ne që kishim në të rinjtë tanë!

Xhela:

Po ju keni ardhë more kushërij mbas kohe. Unë ia kam dhanë paret për vesika avokatit. Jemi bë razi krejt dhe s`ka çka na ndalë më. Në kohën e Kralit na kthyen prej Shkupit, pse nuk ditëm turqisht, kurse tash po thonë as që të vesin se a di a s`di turçe. Veç merri "vesikat", hipi trenit e *bllum* e në Stamboll! Po edhe në pvetë kush tash edhe fëmijët tanë kanë mësue prej shokëve e rrethit këtu diçka-diçka turqisht. Ma kollaj tash është me shkue atje se atëherë.

Mësues Sylja:

Atëherë kanë bë mirë që ju ka ndalë paksa ankesa e Shqipnisë. Kurse tash kjo qeveri këtu, edhepse është më e fortë se ajo e Kralit, nuk guxon me punue ashtu bash ashiqare, por po këqyr pak si me moh! Pra kjo *xhentlemania* e sotme po del, vërtet, më e keqe se ajo e atëhershmeja, sepse është më e fshehtë, por tash na jemi bë pak më të mençëm. Për fat tash kemi njerëz që po shohin më mirë e disa po punojnë edhe në organe ku hahet pasula nga një kokërr. Shqiptarët nuk do të shpëngulen jo. Kemi dhe do të kemi edhe na gjithnjë e më shumë, njerëz tanë në pushtet. Duhet të përpiqemi që pushtetin vërtet ta ketë vetë populli! Kjo është e do të jetë pjesë e

përpjekjeve tona. Po ku të gjetën ty si viktimë kaq të lehtë se! Kjo nuk është për me u çuditë. Ata i gjejnë do pleq labil, të luhatshëm, por që rrjedhin prej familjeve të njohura dhe me autoritet. Kjo është arsyeja që ata ty kanë filluar me të bë presion. Ata shkojnë tue prekë. Njëherë lypin pushkë e të frikësojnë në gjithfarë mënyrash. Në qoftë se u shitet, atëherë i shtinë kojshitë me bë propagandë! Shpikin a montojnë ndonjë organizatë e ku ta dimë. Jo se dikush e paska pa ndonjë ëndërr e ku me dijtë se çka u pjell ajo mendja e sëmurë e katile e tyre. Po kur shohin se njerëzit janë të vendosun në idealet e veta dhe s`japin fakte ata largohen dhe e tentojne ndonjë pretekst tjetër. Pse je ligsh tue ti kaq shumë kurrë nuk kisha me besue! A di qysh na thojsh ne: Njerëzit s` duhet me u ba si dhentë: një me ra në ujë krejt të tjerat shkojnë mbas saj! Madje thojsh se yrushit të ujit, të zjarrit dhe të hyqymetit është mençuri me dijtë me iu shmangë e mbasandej me u gjindë me lehtë besa edhe me iu kundërvu.

Xhela:

Qashtu kam thënë, po edhe unë s`po kam çare pa i ra lumit, si shokët! E ai që shkon me shokë mundet me u fikun, po nuk mbetet i koritun! Me u nda prej shokëve edhe mund të mbetesh i koritun e ndoshta edhe i fikun! Po kjo dallga e këtij hyqymeti hiç s'po di me u ndalë! Po kam drojë se pa na bitisë ne s'ka të ndalun!

Ahmeti:

Po në çdo zor njeriu duhet me qajtë hall e me bë mend me të vetin. Besa tue ia dhënë krahun shoqishoqit më kollaj përballohen të ligat e papritura. Konkretisht, ti shokë e vëllazën s'i ke ata që po shkulen, po i ke ata që qëndrojnë këtu. Na ke neve.

(Ndërkohë Besnikja i sjell kafet.)

Pamja e tretë

(Në këto çaste hyn djali i Vahidit dhe njofton.)

Agimi:

Babagjysh, ka ardhë mësuesi im. A bën me hy brendë a me pritë jashtë, se po thotë se e ka vetëm një fjalë me ju.

Xhela:

Mirëseardhtë. Edhe pse jam moti në qytet, kurrë mysafirin s'e kam lënë jashtë. Le të vijë këtu!

Mësues Skënderi: *(Hyn në odë përshëndetet.)*

Qoftë mirë! Mirëse të gjeta Mixha Xhelë! Ngjatjeta edhe ju burra!

Xhela:

Ulu, zine vendin! Merhaba!

Mësues Skënderi: *(Ulet.)*

Ngjatjeta! Ngjatjeta! *(Dhe vazhdon.)* Vahidin e takova në rrugë, shkoi diku si përngutë. Ai më tha që të vijë këtu te mixha Xhelë dhe me i tregue për punën që kam ardhë. Më tha se ai kurrgjë s'po punojka pa ia bënë me dije babës!. *(I drejtohet Xhelës.)* Pa e marrë bekimin tënd. Burra, më falni se u nguta... Ndoshta u ndërpreva muhabetin. Mbase patët farë pune diskrete a intime, prandaj për mos me ju pengue edhe më shumë, mënjëherë po tregoj se për çka kam ardhë?

Xhela:

Jo more na jemi në odë e në odë nuk fliten aso fjalësh që largojnë mysafirin. Këta i kam kushërinj nga Kodrisha, nga fshati i vendlindjes. Ky është Ahmeti, baba i tij ma ka pasë ble mylkun tem atje qysh në kohën e Kralit, kur deshtëm me babën me u shkulë për Turqi. E ky tjetri është Sylja, mësues në shkollën e atij fshati. Po edhe këtë s'e kemi të largët. Jemi akraba. Kanë ardhë me ma bënë përhajr që e po e shes shpinë dhe po bahem gati me u shkulë, kysmet, për në Turqi.

(Ndërkohë Agimi i sjell kafën mësues Skënderit.)

Mësues Skënderi:

Faleminderit, s'pati nevojë për kafe!

Xhela:

Kafja gjë e vogël, po edhe e madhe. E nder konakun, e nder edhe musafirin, besa dikuj edhe po i bënë hajr! Edhe ty të bëftë mirë! Para se me u shkulë, është mirë me na mbetë kujtime të mira!

Mësues Skënderi:

E mira të gjettë! Po qysh e ku me u shpërngulë, s'po marrë vesh?!

Xhela:

Paj tash po dihet, për Turqi!

Mësues Skënderi:

Për do punë thuhet hajrliqoftë e për do hajri e ndaftë, more mixha Xhelë! Unë s'po di qysh me thënë për këto që po ndie prej gojës suaj. Vërtet jam i befasuar! E kam fjalën për punën e Turqisë. Po çuditëm?! Pse ti me u shkulë në Turqi!? Unë dembabadem me familje, prej se mbahet mend, jam shehërli dhe kurrfarë lakmie s'i kam marrë Turqisë, po ti pse?! Sigurisht nuk je i informuar sa e si duhet për atje. Unë kam qenë atje mysafir. Një, më së pari në Turqi ti duhet ta ndërrosh mbiemrin si dhe emrat e familjes! Atje s'ka Kodrisha, s'ka Besnike, Agim e Gime etj. Atje ka veç emra turqelish. Dihet, t'ua ndërrosh mbiemrin e emrat fëmijëve nuk është mirë. Dy, shkollë shqipe atje nuk ka. Me lyp shkollë shqipe ta marrin zët. Besa edhe munden me të çue haps. Tre, në anën tjetër Turqia është krejt allafanga, shekullare, do me thënë: jashtë normave fetare. Shejrati s'bën punë hiç aty. Në vend të fesit paçare qesin shapka me strehë e pastrehë, bile edhe asi si të çika Savës, si të atij kojshisë që ti, qysh kam ndie, e ke tullusum! Katër, mund të të vrasin bandat e ndryshme e kush s'jep përgjegjësi. Pesë, në burgjet e tyre shkruen: "Këtu s'ka rahmet!". Do me thanë nuk ka mëshirë të Zotit, sidomos për muhaxhirët!... Të thash se atje nuk lejojnë me u mbajtë as fesi e kapuçi i kuq e jo më plisi i shqiptarëve! S'po njehi më shumë. Kurrgjë nuk ka atje që ty do të pëlqejë. Sistemi i tillë është që deri sa të mëkëmbesh ekonomikisht, nëse të punon zari, shumë e shumë ke me hjekë. Konkurrenca është tepër e pamëshirshme. Atje fytyrë e për fytyrë nuk ruen as nuk punon kush, veç për pare!... Për pare sa për idare, me marre e pa marre! Mafitë e ndryshme herë herë i kanë bandat më të organizuara se vetë organet e pushtetit?! Nuk është vend i qetë e rehatshëm qysh të kanë thënë a qysh ke ëndërrue ti dhe ndoshta edhe tash mendon. Mos i beso gjithkuj! Nëse edhe tash ndien fjalë të mira për shpërngulje dije se është propagandë e armikut. Është e vërtetë se tash sigurisht jo me qëllim të mirë, po shkepet turlifarë propagande!... More mixha Xhelë, atje ka të tjera tabijate. Ka tjetër moral. As turku i këtuhit që i thotë vetes turk, edhepse për mendimin tim nuk është, atje shumë me zor adaptohet e jo më shqiptari që ka krejt tjetër racë, gjuhë e edukatë. *(Pushon pak dhe vazhdon.)* Më falni, s'di pse hyna në këtë muhabet. Fola si shumë.

Ahmeti:

Kur njeriu flet mirë ai kurrë nuk flet shumë.

Mësues Skënderi:

Është e vërtetë se unë kam farefis në Turqi. Do të dëshiroja që atje të kemi sa më shumë miq. Po ata miq të na ndihmojnë neve këtu e jo të na thithin e të na shkombëtarizojnë atje. Shumë prej tanëve që kanë shkue atje janë bë pishman. Më mirë po thonë me deké këtu në kashtë fieri e me një gur nën krye se atje në dyshek e jastëk me pupla që i rralli ka mujtë me i sigurue. Po unë kam ardhë për tjetër punë. Deshta me bë me dije dhe me marrë pëlqimin nga Vahidi dhe Besnikja, se Agimin dhe Gimën, që të dy, si nxënës të mirë e të talentuar që janë, i kemi angazhuar në aktivitete të lira. Agimin në grupin dramatik, kurse Gimën në grupin e recituesve si dhe në atë të valleve (baletit)! Kështu që, si shpi, si prindë, ta keni në dijeni mungesën e tyre të nganjëhershme, sidomos tashti kur po bëhen provat e fundit. Dhe pas nja një jave, qysh e kemi në plan, do të shfaqim një program modest me rastin e përvjetorit të shkollës, prandaj ju ftojme qysh tani të merrni pjesë në atë solemnitët!

Xhela:

More, ju çka doni bëni në shkollë. Shyqyr fëmijët i kanë prindët e vet. Ata mund ta japin pëlqimin. Ata le të kujdesen për ta. Le të vijnë edhe në shfaqjet e jueja. Po ti pse kaq shumë fole kundër mendimeve të mia për Turqi. Gati gati po do me ma rrëzue kullën teme si atë kullën që e ndërtojshim si fëmijë në katund me boça të kallamoqit. Kur të mëdhenjt shkollonin misrin mbasdarke, ne fëmijët herë bënim bunare herë kulla me boça! A di sa m'u dhimbte kur dikush pahiri a me kast ma prishte atëfarë kulle! Po pse edhe ti u bëne kundër meje? U bëne krah me këta kushërijtë e mi! Si me u pasë marrë vesh ndërveti! Po a dini ju se çka po përgatitet kundër nesh këtu! Anmikun e kemi shumë të fortë edhe shumë-shumë katil e dhelpnak. Madje a dini ju edhe diçka se çka do me thanë fjala e burrit. E kam dhënë fjalën se shpinë do ta shesë. Kur të thotë njeriu ashtu, ashtu edhe duhet me mbajtë fjalën. Ju kam tregue shokëve në xhami. Imamit i kam kallëzue edhe ai e pëlqei. Ja kam dhënë fjalën Hafëzit që ka shkue më herët në Stamboll. Besa, e kam porositë me bë pazar për mue ndonjëfarë kolibe në ndonjë vend të pranueshëm atje. Për mos me më bë dallavere për ata më ka thënë dhe unë kam dhënë pëlqimin për me zënë avokat. Këtu Xhekën, atëfarë kojshinë e moçëm, e kam porositë dhe ai ma ka gjetë mushterinë për me ma ble shpinë, besa e kam fjalëmirë edhe për me m'i ndreqë "vesikat" më shpejt. E ju krejt këto po doni me m'i

prishë?! Po kjo puna e shkulljes nuk është e ligështë, nuk rrëzohet aq kollaj si ajo kulla e boçave! Vahidi a Xheka, me sa di unë deritash ia kanë qitë lëmezët majës, kanë krye punë në prani me avokat. Tashpërtash krejt fjalët e juaja janë të mbaskohshme! U çel grushti fluturoi zogu! Avokat atje avokat këtu për me e shpejtue punën dhe mos me lënë vend për dallavere! Mbasia e nisa këtë punë, po kam qejf me e krye një këmb e më përpara! Tash veç duhet me i thënë hajrli goftë kësaj pune!

Mësues Sylja:

Eh, avokat këndeje, avokat andej. Avokati s'ka dert që po derdhen paret e tua. Ai veç për pare punon. Ai s'ta ka gajlen ty. Po ti s'di pse po ngutesh aq shumë. Si duket ke siklet nga paqartësia në këtë punë. Edhe i ke hy kësaj pune edhe s' po di se qysh ka me të dalë?! Për punë të tilla thuhet hajri e ndaftë! Të dihet edhe një punë se të gjithë armiqtë janë katila e djallëzorë. Po armiku më i madh i njeriut është vetvetja, është ajo frika që ia grin palcën e shpirtit!

Xhela:

Po ato punë veç Zoti i di. Insani veç gajles e shpresës, besa edhe tutës, kurrë s'ka të veten!

Mësues Sylja:

Po janë do punë që njeriu i ka detyrim me i krye vetë. Nuk është keq nganjëherë besa edhe me ndëgjue këshillën e dashamirësve. Ti fjalën për me e shitë shpinë mbaje, besën, që po e përmend, mos e thyej. Edhe besën nëse e ke dhënë për me shkue në Turqi mos e thyej. Nëse ke dëshirë atje më së pari përpiqu me shkue si turist? Shihe realitetin qysh është dhe kthehu këtu, bile edhe neve na kallëzo. Kur të kërkosh vizën prej Sekretariatit këtu thuej se po do me shkue atje me ble shpi, se këtu e ke shitë shtëpinë etj. Ata ndoshta e hanë këtë dredhi si të vërtetë, ta japin lejen. A di si thonë: rrencin rreje! Mashtroji të pabesit e mashtruesit. Ti bën ashtu, siç i paske dhënë fjalët. Po pazaret edhe mund të luajnë. Ti shko, pra, njëherë vetë në Turqi, nëse ta do qejfi, provoje. Po unë e di se do të bindesh vetë se jo vetëm këto që t'i tha kolegu, por edhe shumë e më shumë të këqija të tjera do të ndeshesh atje. Se atje është vendi i huej, o axha Xhelë! Vendi i huej sado i mirë e të mira me pasë mbetet i huej. Sa mirë të tha kolegu edhe atje të vjen deka si këtu! Po nuk është njësoj si me vdekë në vend tëndin si në vend të huaj. Turqia nuk është atdheu ynë. Ai mund të konsiderohet vetëm si vend mik. Na vendin tonë e kemi këtu. Këtu duhet të fitojmë lirinë qysh duhet. Dhe këtë duhet ta bëjmë me

punë, me punë dhe vetëm me punë! Me veprimtari të pandërprerë. Në lyptë nevoja edhe me sakrifica të mëdha!... Sa çudi me do njerëz tanë! Shumë të ligishtë po tregohen. Edhe më herët, para nesh burrat kanë durue edhe ma shumë se na. Bile edhe kanë shkrepë në vetëmbrojtje! E na po dorëzohemi jo para plumbit po para fjalëve, pse po na thirrin njëherë a dy te *Stanica*. Po na rrahin, po na maltretojnë e ku ta di unë. E pse po rrihem e po vritemi ndërveti këtë nuk po e kujtojnë fare! Besa dikush-dikushi belave ndërmjet veti nuk po ju priton aq! Dikush-dikushi po kujtojnë se atje në dhe të huaj ku të shkojnë s'kanë me pasë telashe! Ndërsa atje, siç dihet, dalin telashe edhe më të mëdha!

Xhela:

Po merzi, bre, me të thirrë e me të mbajtë para *Stanice*, tashti në pleqni! Me të poshtnue tue të përzi me vjedhca, me nguçaçë e grindaveca, shumë zor bre!

Ahmeti:

Më shumë merzi është me pasë mallë krejt vendin tënd! Më shumë të dhemb, kur do me të dhimtë prej vetvetes një dhëmb se e ramja e anmikut, kur e di se atë e ke anmik! Ma marre e poshtnim a ka se me u tutë burri e për tutë të veten me marrë në qafë krejt familjen! Me i shkelë vorret e të parëve të vet që nuk kanë se si me u shkulë së ketejmi!

Mësues Syla:

Po i lamë njeherë këto fjalë. Për me shkue me jetue për krejt atje, si na tha ne Plaku ynë prej fshati: jo vetëm s'ke udhambarë, por kurrqysh nuk bën as me mendue. Do të na mallkojnë edhe varret e të parëve tanë! Deri sa të adaptohet njeriu është shumë vështirë. Ka ndodhë që dikujt- dikujt me i luejtë edhe mendt e kresë!

Mësues Skënderi:

Më falni unë po çohem. Vetëm desha me bë me dije për punën e fëmijëve dhe të shfaqjes. *(Ngrihet dhe pasi përshëndetet për dore me të gjithë largohet.)* E po tumirëmbetshi! Mirupafshim! *(Del.)*

Xhela: *(Edhe të tjerët, luajnë vendit.)*

Udhambarë! Të gjettë e mira dhe u pafshim për të mirë!

Ahmeti:

He, more axha Xhelë, po a ke mendue se është gjynah prej Zotit me i nda fëmijët prej shkollës. Po a ndahet Vahidi prej punës në

Fabrikë. Sa po hjekim ne me mujtë me sigurue një vendpune e ti hajt dil prej detyre e shko në skej të dynjasë! Po a ndahet reja Besnikja prej gjinisë?! Besa ajo më duket tash edhe pak do me dalë mësuese! A di se çfarë miqsh ke?! A di ti që e rrënjët tua i ke në katund e jo në Turqi. Fëmijët prej dajëve nuk ndahen! Këto më duket se nuk i ke pleqnue mirë. Kujtohu edhe tash më mirë sa s`është bë vonë. Më kryesorja është: Mos ia bën qejfin anmikut! Na të kemi vëlla. Ti kur të mërzitesh, hajde te na në katund. Ne veç qejfi na bëhet me na ardhë ti për vizitë. Bile mundesh edhe tash me ardhë ndonjë ditë edhe si kaçak te na, nëse ka nevojë, për me iu ikë syve të këtyne katilave! Sidoqoftë, pse nuk u dertove bile njëherë këtë punë edhe me ne? Po me ndonjë njeri të huej, në xhami, me kojshi Xhekën! Po ndoshta s`ke faj ti, jo! Faj kemi edhe na se nuk kemi ardhë më shpesh te ti. Rrethanat ta kanë diktue ndryshe qysh është e mbara! Më së pari edhe tash duhet me folë shtruet me anëtarët e familjes e jo me turlifarë hallku?! Edhe na po çohemi. Po dalim deri te Vahidi se e kemi njëfarë pune me të.

Xhela:

Çfarë pune keni me të. Edhe ai tash i ka hallet rreth shkulljes?! Kam një lutje, mos shkoni në katund pa u kthye edhe njëherë këtu! Të marrim vesh qysh po bëhet puna e pazarit!

Mësues Syla:

Do të kthehemi patjetër. Po tash po ngutemi me e zënë Vahidin atje. Ndoshta bëhet fjalë mirë me na u pranue ndonjë djalë në Shkollën për kualifikimin e punëtorëve që po hapet në kuadër të Fabrikës ku po punon ai. Besa, ndoshta bëhet puna me na u punësue edhe ndonjë djalë në Fabrikën e re që po flitet se do të hapet e ku Vahidi do të jetë përgjegjës. Na gjithqysh duhet të mësojmë për afatin e kushtet konkursit për dorëzimin e dokumenteve. Po kemi edhe do punë të tjera që kur të kthehemi këtu më mirë do t`i marrësh vesh.

Ahmeti:

Po të kallëzoj drejt. Jo veç për me shti dikë në punë. Po shkurt e bam -bam! Jemi të interesuem edhe na me e ble ndonjëfarë kolibe këtu në qytet! Mësues Syla po thotë se është parapa që këtu të hapen edhe shkolla të nalta në gjuhën tonë, jo veç për zanate të ndryshme, por edhe për degë të tjera. Madje do të hapen edhe fakultete me mësim në gjuhën tonë. Sigurisht ka me u bë mirë këtu. Për ata na po këqyrim me i ndejtë gati punës më herët. Kështu që edhe unë edhe mësues Syla po kemi qejf me u sigurue njerëzve tanë edhe shkollë, madje edhe punësim. Po ne nuk do të shpërngulemi nga katundi. Po edhe këtu shpija edhe atjehen do ta ruejmë.

Xhela:

Shumë mirë mue qejfi po më bëhet. Po qysh do t'i mbani se?! Mos po mbeteni si ai herifi me dy gra. As të Hata as te Fata po mes lumit në shelqe të thata! *(Qesh Xhela, qeshin edhe të tjerët.)* Po ku po preni pare more ju atje?!

Ahmeti:

Me punë, me vim, po bëjmë pare. Shqyqyr kemi mjaft njerëz të vyeshëm e punëtorë. Punëtori pse thonë se edhe Zotit ia merr bukën me zor! Tokën me punue mirë, gjanë me i këqyrë mirë patjetër del mjaft fitim. Madje edhe mjehstria e kursimi e bëjnë të veten! Pale të këqyrim edhe punësimin qysh do të na dalë! Kur pare ka qyteti katundit i hec prodhimi. Këto punë shkojnë huazash!

Mësues Syla:

Tash po shkojmë dhe këtu do të kthehemi më vonë, siç të tha Ahmeti. Me një fjalë, edhe na kemi nevojë me ble troje ne qytet. Ta këqyrin si po shkon pazari! *(Ata dalin.)*

Xhela:

Gjithqysh kthehuni. Udhambarë po ju them, po selam për atje njëherëpërnjëherë jo!

Pamja e katërt

(Skena e njëjtë. Xhela rri mendueshëm.)

Xhela: *(Prej derës së dhomës e thërret të shoqen.)*
Oj grue, pa eja pak këtu! *(Grueja vjen.)*

Nëna:
Lepe, urdhno, njeri, pse po më thërret në këtë kohë kaq me nguti!?

Xhela:
Pse ti nuk po më kallëzon se çka po sillet e çka po mbështillet rreth meje këtu?! Kur thashë se po e qes shpinë me e shitë nuk folët kurrgjë e kur tregova se Xheka është midis fjalëve dhe se ai ma ka gjetë një myshteri, hajrliqoftë kurrkush s'më tha. As ti, as reja, as nipi as mbesa, po megjithatë, kurrkush nuk ma prishi e kur po them me u bë gati për me u shkulë për në Turqi, diqysh nuk po jepen shenja të mira! Vahidi ka nisë e po më belbëzon! Në anën tjetër jo po më vjen ai mësuesi i fëmijëve!, jo ky mësuesi akraba! Jo ky kushëri, jo ai, jo ky?! Ku është sebepi?!

Nëna:
Mue kurrë nuk më ke pvetë për kurrgjë. S`di pse tash po idhnohesh në mue. E reja e djali janë të rritun, ata pveti se vetë të kallëzojnë. Besa, tash edhe mbesa e nipi janë rritë e nuk janë aq të vegjël. Edhe ata flasin vetë. Ti me ata nuk po ban llafe, po me njerëzit e huej, në rrugë, në xhami, me atë Xhekën e kafes e ku me dijtë se me kë tjetër...! Çka di unë e zeza me t'u përgjegj!?

Xhela:
Pa thirrmi edhe ata!

Nëna:
Besnikja nuk është këtu. Sa duel me mysafirët e katundit. Shkuan bashkë diku. Sigurisht shkuan te Vahidi, kurse fëmijët këtu janë, po mësojnë diçka-diçka. *(Del te dera e thërret.)* O Agim! oj Gime!, ejani këtu se po ju thërret Gjyshi!

Agimi: *(Vjen i pari.)*
Urdhëro Bababagjysh, pse më thirrret?

Xhela:

Çka po mëson?

Agimi:

Po mësoj tekstin për një rol që do të luaj këto ditë në shfaqjen teatrore kundër shpërnguljes. Kur ta japim shfaqjen a do të vish me na pa edhe ti Babagjysh!

Xhela:

Po çka luen ti aty?

Agimi:

Unë interpretoj rolin e një atdhetari që më mirë e pranon vdekjen se shpërnguljen?!

Xhela:

Po Gimja?!

Agimi:

Edhe ajo po e mëson një vjershë që e ka detyrë shtëpie!

(Ndërkohë vjen Gimja.)

Gimja:

Urdhëro Babagjysh!

Xhela:

Çfarë vjershe po mëson, moj bijë?

Gimja:

Një vjershë të Çajupit. (Reciton):

*E dashura mëmëdhe,
të dua dhe kështu si je,
por kur të shoh të lirë
të dua dhe më mirë!...*

Xhela:

Po a ka thënë edhe tjetër llaf ky farë Çajupi?!

Agimi:

Po ky ka shkruar shumë, por mes tjerash tash po më kujtohen veç këto dy vargje që i kam pjesë të rolit tim që e luaj në shfaqje:

*Dhe në vuaj, le të vuaj
të mos tretim në dhe të huaj!*

Xhela:

Shkoni, vazhdoni, mësoni! (Ata ikin duke e përshëndetur gjyshin. Edhe gruaja largohet. Xhela mbetet vetëm. Zbret nga minderi dhe ecën nëpër dhomë.)

More Xhelë, Xhelë Kodrisha, ku i pate mendt. Tash po e marr vesh sa paskam gabue! Po qysh me bë punën me dalë prej këtij lloçaku që vetë me sy në ballë paskam sharrue?! Dihet se një pazar kur nuk bëhet përhajr prej njerëzve tu, s`ka hajr prej tij! Edhe një udhë që merret e nuk urohet me "udhaembarë" ajo nuk duhet të merret, se nuk del rrugë e hajrit! Çdo punë që merret me dymendje, kanë thanë të meçmit, s' ka hajr prej saj!... Është edhe një e vërtetë, se më mirë është të jeshë i dëmtuem se sa i faruem. E unë me punën e shkuljes në Turqi, kam drojë se mos po e faroj krejt familjen?! Haj, haj, këtu me ndej i dëmtuem po, po ka shpresë se mund të bëhet më mirë e me u shkulë atje ndoshta bëhem krejt i faruem! Qysh t`ia bëj. O Zot më ndihmo! La ilahe ilallah! Haj, haj, a thue, si po bëhet puna e pazarit me atë laraman kojshinë?! S'mora vesh kurr gjë. A thue djalit ia ka marrë mendt si mue ai kopil. A thue Vahidi e ka marrë kaparin? A e ka nënshkrue kontratën?! Po për kë po do me ble ai tinzak, dhelpën njeri?! Ndoshta po do me ble për çarë! (Drejtohet kah qielli.) Aman o Zot i madhnueshëm, më ndihmo, qysh qoft më hajr bëne, o Zot! Emri yt shkoft në vend, po mos më dëmto o Zotynë! Po shkoj në xhami më shumë me hjekë merzi se sa me falë vaktin, ishalla Zoti m'i falë gjynahet! S'di se a ka më gjynah më të madh se me largue njeriun pa e pvetë prej shpisë së vet! Vërtet, nuk di! Që prej këtij dakiku, më mallë e bëj me më vra e më gri, copa - copa, se me i çue fëmijët në dhe të huej e me ua humbë me prag e me taprak! (Del.)

Skena e katërt

(Përsëri në rrugë Xhela takohet me Xhekën.)

Xheka:

Ku je more Xhelë a kështu po e mbajshe fjalën ti a? Pse s'erdhe edhe ti me Vahidin me e marrë kaparin e shpisë a me e lidhë *ugovorin* qysh u morëm vesh, po e lë vetëm me ardhë atë bukëpëmbystin! Të thashë se edhe paret e tjera nuk t'i vonoj, qysh u morëm vesh. E djali yt e kish qitë bishtin në shpinë si me e pasë pickue xekrrat!

Xhela:

Po unë Vahidit i thashë me ardhë te ti! Pse, a s'paska ardhë a nuk u morët vesh-a?!

Xheka:

Po ai ishte këtu, po më mirë mos me pasë ardhë. Ai erdhi me do llafe të egra?! Më ka dalë gacë e mbluet ai! Njëherë e rrehi tepër naltë pazarin. Hiç nuk lëshonte pe. Nuk e pranoj kurrqysh as ndërmjetzën teme. Mbasandej i lypke për sot atypëraty menjëherë krejt paret në dorë, mandej lypi afat paafat për mos me e lëshue shpinë, deri sa ta gjejë një banesë tjetër! Kurrqysh nuk u lidhke me fjalë. Nuk pranoi me e lëshue gjysmën e shpisë as kur t'i merr jo gjysmën po as krejt paret! Veç kur të dalë në shpi të re a kur të shpërngulet! Kur i thashë se unë po hy dorëzan kur ish fjala për pare ai ma drodhi! Më tha se nuk më beson dhe nuk më dha myhlet as për një sahat e jo deri në aksham! Kur i thashë hajde po pvesim se qysh duhet me rregullue *ugovorin* te avokati. Nuk e pranoi advokatin tem po më tha me shkue te një advokat katalik, i cili *ugovorin* paska thënë me e hartue në gjuhën shqipe! Jo kështu, jo ashtu, ma shkurt e pashë se nuk po do me ra në brazdë kurrqysh! E lamë punën prishë të dy! Thashë të flas edhe njëherë me ty! S`di çka po ndodhë me juve?! A thue edhe juve s`po ju ndigojnë djemtë -a! Na qysh prej Bivshes *ugovorat* i kemi ndreqë vetë e ju veç kini qitë gisht! Ju kurrë s`keni ruejtë dokumenta. Tash ai djali yt, kapuç me maje, kishe e ka krye njëfarë shkolle, s`do *ugovor* po *kontratë*, madje kërkoi që taksat e Gjyqit me i pague blerësi, d.m.th. unë a myshteria jem! Madje, edhe më keq, *kontratën*, siç të thashë, tha se e do të shkruar veç në gjuhën shqipe. Qashtu e kish mësue aifare *advokat kataliku* e të tjera e të tjera! Lypke hala në përpeq! Shkurt, u idhnuem dhe u larguem pa u krye punë të dyja palët. Për ata deshta me folë me ty edhe njëherë. Po due me të dalë hakut. Këqyr le të ruhet Vahidi, prej avokatëve të tillë, *katalikë* se po ia bëjnë ndonjë sherr! Unë kam folë fjalë të mira

për ty e për Vahidin në Sekretariat dhe e di se kanë me ta dhënë së shpejti lejen për me shkue ti në Turqi. E djali yt po sillet ashtu! Unë pazar pata bë me ty e ai vetëm ka pasë formalisht me lidhë *ugovorin* e ai më doli qysh s'e pritja! Tash s'risht po kërkoj prej teje me ma mbajtë fjalën.

Xhela:

More unë këtë punë ia kam lënë krejt Vahidit, s'di kush e paska mashtruar atë, kështu?! Po pa folë me të s'di se çka me të thënë, veç hajri e ndaftë!.

Xheka:

E kam dijtë se te ti nuk ka hile, po ndoshta ai *kataliku* a dikush tjetër kanë faj?! Këqyr lum jarani, se këta *allbancat* e *katalikat* po këqyrin me iu mashtruar ju turqelive. Na me turqelitë gjithmonë kemi shkue mirë. Allbancat kanë kenë gjithmonë edhe e zeza e turkut, por edhe e zeza e Kralit tonë, por më tepër e zeza e kresë së vet!... Vërtet, disa kanë hy naltë nëpër *sluzhba* tash, po edhe ata sigurisht kanë me i hjekë si të nisë ndonjëni prej tyre me luejtë bisht a me çue krye! Së shpejti kanë me ua shkurtuar brinat edhe atyre luftëtarëve - partizanë! Dihet se shyti me u rrokë me kaprecin nuk ia qet! *Dërzhava* jonë i ka brinat kaprec përpjetë. Është shumë e fortë edhe shumë e mençme! Me hyqymetin tonë nuk mund të shtyhen jo vetëm ata kishe luftëtarët, po as njerëz më të mëdhënj se dikush - dikushi edhe në qoftë *advokat* a njeri me shkollë?! Po kujtojnë se këtu mundën me bë Allbani! Tash ke me ia ndie krizmen kësaj pune, qysh të kam kallëzue!

Xhela:

S`di more kojshi, por unë të kam luejtë në fjalë: ta kam dhënë besën se do ta shes shpinë edhe këtë punë topi s`e luen. Si ta shes shpinë djali më s`ka ku rri. Domsdo ai ka me ardhë me mue. Po këqyri se çka u bë. Kush qenka ai farë *avokat katoliku* që po do me ma marrë në qafë djalin? Unë kysmetin për me shkue në Turki jam tue lypë. Për ata e kam qitë shpinë në pazar. Ajo ka me u bë. Herët a vonë s`e di qysh me të thanë. Po njëherëpërnjëherë pata qejf me shkue unë vetë atje dhe me e bë pazar ndonjë shpi, mbasandej si t`i harxhoj paret atje, djali, si të thashë, s`ka çare pa ardhë mbas meje?! Më vonë, qysh ua kam bë me dije, sipas mendimit tënd, do të vij në me siguri edhe akrabaja prej katundit, por edhe të tjerë!

Xheka :

Mirëde, mirë! Fjalët nuk kryhen në sokak. Mbasi të mirresh vesh me djalin. Eja e më kallëzo. Eja ti se Vahiti më ka dalë agcë e mbuluet, bukëpërmbystë! Ai po harron se ndihma jeme i ka dhënë *sluzhbë e druzhbë (nëpunësi e karrierë)*, qysh të kam thënë, po ato munden me iu këputë a me iu zbehë, nëse i këputet ndihma jeme, edhapse ai rrehet se e ka lidhjen me *ata naltë* ku e ka krye shkollën! Zanati dhe shkolla që e ka krye do t'i ndihmojnë shumë edhe kur të shkoni atje!... Qysh të thashë njëherë për njëherë puna e pazarit mbeti prishë. Veç dije edhe një punë, thueja edhe Vahidit, se në qoftë se ti nuk ma shet shpinë, atëherë zullumin s`mund ta heq prej shpinës. Po nëse ti vendos mos me e shitë shpinë, atëherë dije se unë duhet me ia shitë shpinë teme atij herifit që e kam ngallitë! Qashtu thuej Vahidit! *(Pushon pak.)* Çudi me këta të rinjtë?! Ka nisë me na lënë besimi ndaj njëri tjetrit, o Xhelë! Veç kur ta shesë unë shpinë le ta dijë Vahidi se atë dhe atë avokat katalikun ka me i pi e zeza! Ka me i mbytë dallga e xholit!

Xhela :

Zoti e bëftë hajr! Po çka je sekëlldisë jahu. Deri tash kemi jetue si kojshi, pse tash kaq shumë po egërtohesh?! Djalin mos ma nëm kojshi! Unë s'kam çka vi më te ti. Krejt djalit ia kam lënë. Qashtu qysh ke kërkue ti! Unë fjalët nuk i luej! Djalit do t'i them mos me shkue të xholi!

Xheka :

Pak sende t`i kam kallëzue, do të tjera do t`i marrësh vesh ma vonë?! Ja ata, ja na!?

Xhela :

Hajari e ndaftë, o Xhekë! Ishalla s'vjen puna deri aty, se këta të rinjtë s' kanë me ju ndejtë si na dikur duarlidhë. Të këqijat nuk harrohen, o Xhekë! Ishalla nuk nisim punët me dhunë se qysh po thonë do të rinj, sa ju dhemb atyne aq ka me të dhimbtë edhe juve, në mos më tepër! Po s'duhet me lënë punën me ardhë deri te ajohja!

Xheka :

More, sa ta kemi **dërzhavën** e fortë: ja ata, ja na! Do ta provojmë!

Xhela :

Dihet se besa edhe duresa në fund të fundit kanë me dalë fituese! E dihet se besë e duresë kemi pasë gjithmonë populli i shtypun. Për ju po thonë se keni pasë veç lajka, rrena e dredhi, more Xhekë!

Po thonë se ndoshta gjithmonë kungulli nuk i shkon dikuj mbi ujë!
(Ndahen pa përshëndetje. Xhela vazhdon rrugës vetëm.)
Kurrë më idhshëm nuk e kam pa qafirin! A thue çka i ka thënë
Vahidi. Mos po ia bën ndonjë të zezë djalit ky farë shejtani. O
Zot na ruej prej sherrit të kaurrit!

(Bie perdja)

Skena e pestë

Pamja e parë

/Në odën e Xhelës. Të pranishëm: Ahmeti, Mësues Sylja, Vahidi edhe avokati./

Vahidi:

Tash po kthehet baba! Ju e dini se qysh sillti me të. Unë po shkoj
për ku ju thashë!

Avokati:

Cili do ta njoftojë plakun me përmbajtjen e kontratës.

Vahidi: *(Avokatit.)*

Njoftoje ti se ti je zyrtar. E zyrtarët pleqt i respektojnë më
shumë. Mbase nuk do të hidhërohet për lojën që e luajtëm, prapa
syve të tij! Kur kam dhënë pëlqimin që shpinë me e qitë në pazar
ka mendue se këtë po e bëj se po pajtohem me u shkullë në Turqi.
Megjithatë më duket se tash diçka ka marrë vesh! Zemrën ia njoh
atij se nuk ka me na prishë!

/Në këto çaste mbërrin Xhela. Vahidi del./

Xhela:

Paska burra këtu, dashamirë edhe jabanxhi. Mirëserrini!

(Të gjithë ngrihen në këmbë.)

Avokati:

Mirësevinini! Ju jeni Xhela, i zoti i shpisë, Xhelë Kodrisha, a
po?!

Xhela:

Po unë jam vetë Xhelë Kodrisha.

Avokati:

Unë jam avokati që simbas porosisë suaj më ka zgjedhë Vahidi. E kemi hartuar një kontratë mbi pronësim-shpronësimin e pasurisë së patundshme, me përmbajtjen e të cilës po të njoftoj menjëherë a po pajtohesh ti a jo?!

Xhela:

Po ngadalë, pse po ngutesh bre burrë. Më së pari nuk u përshëndetëm njëni me tjetrin.

Avokati:

Më falni se nuk i njoh mirë rendet e odës. Jam pangeshëm se më presin edhe punë e raste të tjera urgjente! Më presin në gjykatë. Kemi një seancë gjyqësore shumë të ndërlikuar. Shqyrtohet një lëndë për një çështje të montuar penale-politike. Kam me e mbrojtë do anëtarë të një grupi ilegal. Prandaj më falni, po vazhdoj pa humbur kohë me çështjen e Juaj. Para se të firmoset kontrata duhet të ndëgjohet (lexohet) tërë teksti.

Xhela:

Për hajr qoftë, po mue pak përpara më tha Xheka, bile tue blue shumë egër, se kontratën e kishin prishë edhe ai edhe Vahidi. Prandaj pa u marrë vesh ata e pa qenë edhe ata këtu s` di sa vlen kontrata që e paske përgatitë ti?! Unë hala nuk jam takue me Vahidin për me i kallëzue se çka më tha Xheka.

Ahmeti:

Kemi të bëjmë me një marrëveshje tjetër të re se ajo me Xhekën u hirruet! Tash e merr vesh. S'ke çka me i kallëzue Vahidit. Pakashumë krejt i dimë çka të ka thënë aifare kojshi Xheka! Prej anës tënde ti je i pastër. Ti ke bë njëfarë beje që këtë shpi me e shitë. Ashtu le të shkojë beja në vend. Fjala e thanme, besa e dhanme, fytyra e zanme, puna e bame! Po le të tregojë më mirë avokati.

Avokati: (Fillon ta lexojë.)

Kontratë mbi shit-blerjen, përkatisht ndërrimin e pronësim-shpronësimin e pasurisë së patundshme e lidhur mes palëve: 1. Xhelë Bardh Kodrishës me banesë në qytetin P. nr. ___ në njërën anë dhe 2, të Ahmet H. Bardhit nga Fshati Kodrishë, në anën tjetër.

Pika I.

Të lartëpërmendurit janë marrë vesh që të bëjnë trampa (ndërrim pronësimi). Ahmeti do t`i japë për shfrytëzim ish kullën e tij në fshatin Kodrishë me tërë oborrishten, nën listën kadastrorë nr. __, parcela nr. _____, kurse Xhela do t`ia lëshojë shtëpinë në qytetin P., lista kadastrale nr _____, adresa: rruga _____ nr. ___ në P _____.
Shtëpijat do të shpërndërrohen brenda afatit prej një muaji.

Pika II

Ahmeti do t'i paguajë Xhelës një shumë të hollash prej _____ d. si shtesë ngase shtëpia në qytet ka vlerë më të madhe. Gjithashtu edhe taksat e gjykatës i heq blerësi.

Pika III

Konstrata hyn në fuqi menjëherë pasi të nënshkruhet nga të dyja palët dhe të vërtetohet në gjykatë.

Pika IV

Për mosmarrëveshjet eventuale rreth përmbajtjes së kësaj kontrate kompetente Gjykata komunale _____.

Xhela:

Çka është kjo more! Po mulku në katund ka më shumë vlerë se ka kjo shpia këtu. Se kur e pata shitë shpinë në katund me ato pare e pata ble këtë shpi, dyqanin për nallone, por edhe më teproi diçka. Nuk bën me hy në hak të kurrkujt se është gjynah!... Po këto punë nuk duhet të bëhen në emën tem. Le ta nënshkruejë djali pse doli ai jashtë?! Ku iku bash tash?!

Avokati:

Mirëde, mund të mirreni vesh më vonë edhe ashtu. Po në zyrë Vahidi tha se njëherë përnjëherë të figurojë vetën emni i babës. Tekstin e vërtetuar ne mund ta ndërrojmë e modifikojmë si të duam ne. Kështu e kemi ndreqë punën me Vahidin. Formalitetet veç e kemi kryer më herët.

Ahmeti:

Vlefta është dhënë sipas gjendjes së sotme. Madje një arë e zabelet nuk janë llogaritur. Hesapi na doli kështu. Po na mund të bëjmë fjalë edhe mbasandej për pazarllëqe të tjera. Këto pare si shtesë i ke hak. Fundi i fundit për ne kontratë është fjala e gojës e qysh të merremi vesh, kurse kjo kontratë e lidhur kështu po i vyeka si formalitet Vahidit për punë të tij.

Avokati:

Nuk po shoh të nevojshme të jap farë arsyesimi. Të njoftova për më të rëndësishmen, çka është më relevante. Po ti a po pajtohesh që kjo kontratë të lidhet për afërsisht kështu apo të shtohet ndonjë tekst plotësues se kjo hyn në fuqi vetëm pasi të vërtetohet në gjykatë?

Xhela:

Fundi fundit unë po dorëzohem. Vahidi le të nënshkruajë e le të bëjë çfarë të dojë. Merruni vesh me djalin. Po pse kjo u bë kështu prapa shpinës teme se!? (E thotë si me të qeshur.) Po përhajr qoftë e hajri e ndaftë!

Avokati:

E pra, mirë, unë e kreuva. Tash lamtumirë. Ditën e mirë. Mos lueni vendit.

(Të gjithë ngrihen në këmbë. Avokati del. E përcjell Xhela. Në të ndarë dëgjohej fjalët) E po Mixha Xhelë: Lamtumirë! Edhe njëherë përhajr shitblemjen! Formalitet e tjera do t'i kryejmë në zyrë me Vahidin. Zyrtarisht prej ditës së sotme Vahidi s'ka kurrfarë prone të patundshme në qytet, madje as shtëpinë e babës, e cila u shpronësue sipas kësaj kontrate!

Xhela: Përhajr qoftë! (Kthehet në vend.)

Pse kjo lojë është luajtë kështu pa më pvet mue?!

Ahmeti:

Kjo nuk është bë dhe as që do të bëhet pa pëlqimin tënd. Është e vërtetë se unë kam nevojë për një shpi në qytet se po due që dikë me shti në punë këtu. Shpija më vyen edhe për punë të shkollës së fëmijëve, kur të hapen shkollat e nalta e kështu me radhë. Ndërsa për ty e kemi bë mend se po të duhet patjetër shpërngulja! Dhe atë shpërngulje më të mirë për ty a ka se me të kthye për qejf jo për dert në trojet e tua e të të parëve tu?! Dëshirë kjo që e dimë se me të vërtetë të ka mbetë thellë në zemër! Sot të ka ardhë dita që ta kthesh trollin e babës. Po nëse do me shitë përsëri ka kush me ta ble. Jemi shumue shyqyr boll. Po Vahidi njëherëpërnjëherë po ka dëshirë aty me i shti paret! Ti në vend që të shpërngulesh e me dalë rrënjesh krejt, me i lënë eshnat dhenash të huaja të ka ardhë dita me zgjedhë. Në daç rri këtu në shpinë tënde në qytet, po tash në emnin tem, në daç eja në katund dhe merre kullën dhe vendosu aty që tash është në emnin tënd. Bëju zot i kullës ku ke lindë ti edhe baba yt!? Zgjidh. E atë farë punën e Turqisë qite krejt mbas kreje.

Xhela:

Puna e Turqisë, po thoni se paska marrë fund -a! Po t'i pse po e lëshon kullën, o Ahmet Bardhi?!

Ahmeti:

Po e ke pa tash po dal në kullë të re, edhe më të bardhë!

Xhela:

S`po di si do t`ia bëjmë me Xhekën?! Mos po na bën ndonjë sherr!

Mësues Sylë:

Sa i përket atij Xhekës. Ai ose le të pajtohet me fatin ose le të pëlçasë prej inatit. Çka me i bë sherrit tem se prej sherrit të huej ruhem vet. Ai i kish thënë Vahidit se nëse ju nuk e shitni ai do ta shesë shtëpinë e vet! Tash e porositëm Vahidin me i thanë se nëse dëshiron, vërtet, me e shitë shpinë, mësues Sylën e ka myshteri... Do t'ia blej kysmet unë trollin atij!

Xhela:

Kështu veç Zoti me madhni të vet ka ditë me ma lexue zemrën e mendjen. Po një punë po due me ditë se nuk është mirë me hy në gjynah. Po due me thënë se ju keni punue sipas qejfit tem të mëshefun në zemër!, por s`po di... ndoshta nuk pajtohen Besnikja, fëmijët, plaka jeme! Ta shohim çka po thonë ata. Po dal e po i pyes. Mos të bëhet përhapër pazari pa u marrë edhe pëlqimi i tyne.

Pamja e dytë

(Skena e njëjtë.)

Xhela: *(E hap pak derën dhe pa e kaluar pragun thërret.)*

Oj grue, oj nuse, po ku shkoj Vahidi?!

Besnikja:

Urdhënoni babë! Tash ndoshta vjen, shkoj urgjentisht në zyrë! Tha se e ka një punë për shpejt e shpejt!

Xhela:

Po a morët vesh ju për pazarin që sapo u krye? Po a ju ka pvet kush juve?! Hajde hyni edhe ju brenda. Po ju si duket paskët përgjue krejt mbas dere! Hyni, hyni, mos rrini në hajat! Qyqy, edhe plaka qenka këtu! *(Ata hynë: Nëna, Besnikja dhe fëmijët. Xhela vazhdon.)*

Ti Besnike e ju fëmijë a morët vesh se në vend se me shkue me u shkulë në Turqi, Vahidi me këta paskan vendosë me na ngulë në katund: në kullën e babës tem! Plakën nuk po e pves se ajo gjithmonë ka pasë qejf me u kthye në katund! A po pranoni edhe ju që prej qyteti me shkue në katund-a!

Femijët (Agimi e Gimja): (Flasin si në kor.)

Po qysh jo, Babagjysh, ndal të përqafojmë. Ne duam të shkojmë në fshat edhe atje ta kemi shtëpinë tonë. Te kushërijtë dhe fisi ynë. Sa vend i mirë që është atje!

Xhela:

Po mos folni të dy menjëherë se këtu shfaqje nuk kemi! (Të dy fëmijët e përqafojnë.)

Besnikja:

Qysh jo, more babë, kysmet i hajrit qoftë! Ne kemi pasë qysh moti dëshirë me bë edhe një shpi në fshat, ku mund të shkojmë të shlodhemi, por edhe të punojmë! Pse jo? Për fat nuk e kemi edhe aq larg Kodrishën. Me veturë një çerek ore. Në anën tjetër mbasi na po marrim banesë po na vjen mirë që në këtë shtëpi po vijnë këta të Axhës Ahmet. Kështu që ne si të dalim në banesë, këtu do të vendosen tanët. Vahidi ka nisë me i përgatit dokumentet për me e ble një veturë të re me kredi. Vahidit i vyen veç një vërtetim formal që nuk ka shtëpi dhe menjëherë po ia japin banesën tridhomëshe! Në të dyja anët po bëhet mirë. Tash bashkë me avokatin kontratën e shitblerjes do ta vërtetojnë në Gjykatë. Besa tash edhe unë do të diplomoj e mund të punësohem si mësuese diku!

Mësues Sylja:

Ku je Xhelë Kodrisha, ku je! Në vend se me u shkulë përgjithmonë prej vendit ti po përngulesh edhe në qytet në banesë të re edhe po ringulesh në katund më thellë në tokën tënde!

Ahmeti:

Shulevek, iu bënë punët. U bë Xhelë Kodrisha me dy mylqe! Edhe te Hata edhe te Fata pa hypë hiç në shelqe të thata! (Qeshet. Qeshin edhe të tjerët!)

Xhela:

Mos u mahit Ahmet! Po këta në fshat paskan mendjen me shkue veç për qejf, për pushime!

Besnikja:

Do të shkojmë për qejf, por edhe mund të punojmë edhe më me qejf! Pse jo?! Çdo punë me qejf është pushim!

Xhela:

Po ti qysh me i shti këmbët në lloç e në bagla: me mjellë qep e hudra, me mjellë lopën. Plaka tash i ka harrue ato punë.

Nëna:

Jo, jo, s'i kam harrue! Po unë edhe më në qejf e pa pritesë i kryej ato punë! Nuk i kam të harrueme jo?!

Besnikja:

Po mashtrohesh o babë, po unë nuk pritoj nëse ka nevojë edhe me mbajtë edhe ndonjë lopë, pse jo pula?! *(Flet plot gaz.)* Ti babë po kujton se unë nuk di me i krye edhe ato punë-a! Çdo punë është e ndershme e sidomos këto që po i përmendni ju që janë punë edhe të lehta edhe shumë të vlefshme.

Mësues Sylja:

Vetëm njeriu me sedër të sëmurë e ka merzi këtë punë a atë punë. Çdo punë është e ndershme dhe e mirë goftë në katund, goftë në qytet e kudoqoftë! E ti Besnike mundesh me ardhë edhe si mësuese në shkollën tonë. Kemi vend të lirë! Madje mund të organizosh kurse për arsimin e femrave të fshatit!

Besnikja:

Besa mirë e ke, do të shohim, po tash po shkoj me sjellë diçka sa me u ëmbëlzue pakëz!

Ahmeti:

Ashtu të lumtë moj bijë fisnike! E pra për hajr na qoftë ky farë pazari! *(Fëmijët e përqafojnë axhën Ahmet.)*

Besnikja: *(Kthehet me një tepsi me lëngje dhe llokume.)*

Urdhëroni! *(Të gjithë çohen në këmbë dhe e përhapojnë këtë marrëveshje.)*

Xhela:

Po Vahidi, ku shkoi ai?! Pveta njëherë, po edhe njëherë po due me marrë vesh më mirë!

Besnikja:

Shkoj me e dorëzue një vërtetim se zyrtarisht nuk posedon kurrfarë shtëpie banimi në qytet, dokument ky formal që po i duhet për me e plotësue dokumentacionin e domosdoshëm për marrjen e banesës. Sot më ka thënë se e merr edhe vendimin për banesë e një tjetër ditë mbase çelësat!

Agimi:

Qe sapo erdhi babi!

Xhela:

Hajde përhapj! /Ndërkohë hyn Vahidi me vendimin në dorë dhe fort i gëzuar./

Vahidi:

Vendimin ma lëshuen për banesë edhe menjëherë edhe çelësat m'i dhanë. *(Dhe njëherë përgëzojnë. Dëgjohe zërat.)* Gëzuar! Urime! Përhapj!

/Lëshohet muzikë festive./ (Mbyllet perdja.)

Skena e gjashtë

(Skena paraqet po atë kullën në fshat. Xhela tash në vend të fesit ka vënë plis të bardhë vendçe. Në kullë (odë) kanë ardhë fqinj e miq për me ia urue rikthimin.)

Xhela:

Thonë Zotit çka t'ja lypësh, ama me zemër e me shpirt të pastër, po ta jepka! Unë kështu kam pasë dëshirë me u bë, por nuk e kam shprehë asnjëherë botnisht me gojë se nuk i besoja vetes se diçka e tillë do të mund të bëhej përnjëmend! E me plakën nganjëherë kemi bë dert! Veç, si duket, Zoti i madhnueshëm ma ka lexue dëshirën e zemrës dhe shyqyr ma plotësoj atë!

Ahmeti:

Përveç Zotit këtë dëshirë ta ka ndie edhe djali yt Vahidi! Tjetër herë përveç me zemër shprehe dëshirën edhe me gojë, se edhe na me ta pasë ndie më heret ndoshta më herët ta kishim plotësue. Edhe unë pak si vonë iu bashkova mësues Sylës e Vahidit të cilët më herët kishin pasë nisë me e tjerrë këtë farë "dredhie" po e kishin pasë pak sidrojë me ta thënë ngulas. Po bëna hallall se mbase nuk të kemi koritë shumë me Xhekën e shokët e tij, të cilët kishin pasë kujtue se ty me një të thirrme në Stanicë a me një kanosje me fjalë do të shkullnin përgjithmonë për Turqi! Kish pasë kujtue Xheka se na i kemi rrënjët e cekta në këto troje! Qysh të pat thënë. Shite shpinë qetash se vjen dita me e lënë pa pare hiç?!

Xhela:

Paj sherrit të tyre gjithmonë duhet pasur drojë. Kur të rrish në një vend me qen të huej edhe në mos t'u turrshin pleshtat t'i lëshojnë. Edhe po çuditëm edhe po më vjen mirë. Vahidi qysh i mësoi këto farë *marifetesh* me e mashtrua edhe dreqin!

Plaku:

Kallfa i mirë hallall e ka me e vjedhë zanatin prej mjeshtrit të vet, bile edhe me ia kalue atij. Kështu ka veprue edhe Vahidi. I lumtë! Ai sebeb e ti u ktheve. Po ti me kthimin tënd, o Xhelë, na ke hijeshue edhe katundin e nahien se jo veç këtë kullë. Kjo që ke bërë me të vërtetë është punë me mend. Është sevap edhe për vorret e të parëve tuej, për historinë tonë!

Xhela:

Kahdo që të shkojë njeriu vendlindjen kurrë s`mund ta harrojë. Ajo diqysh të ngreh. Qe qysh qe. Për këtë duhet me e falenderue edhe mësues Sylën. Edhe krejt këta të rinjtë që po mjellin dashni edhe më të mëdha për vatanin, për tokën tonë, për tokën e të parëve tanë. Besa e falenderoj edhe Ahmetin, i cili më ka dalë vëlla e përtej vëllait! Unë përpak merakun e katundit pata me vorrue me një kob të zi. Isha gati me u shkullë në Turqi. Kështu me ia hup fijen çdo kujtimi për këtë vend! Po këta shkulljen jo vetëm që ma bënë bajat, po ma kthyen në ngulje e përngulje shumë të fortë. Më rikthyen në trojet e rinisë. Tash kam shti rrënjë edhe në qytet edhe në katund. Ahmetit duhet me iu falenderue jo vetëm që ma mundësoi kthimin, por edhe nuk ma zhveshi odën. Krejt këto të shtrueme ia la odës. Pak është me i thanë faleminderit.

Plaku:

Është adet i mirë i moçëm yni. Le të bëhet çka të bëhet në mes të familjeve. Ata mund të ndahen, po oda nuk dishet. Oda e shqiptarit kurr s'ka qenë vetëm odë e zotit të shpisë, por edhe e vëllaznisë, e mysafirrit edhe e miqsisë. Po ti bëne mirë që u ktheve bylbyl në këtë odë të njohtun dhe nuk punove sipas qejfit të anmikut, do me thënë nuk u zhgule për Turqi e me na lënë odën pa këtë hijeshi, pa bylbyl. Fjala e plakut është për odën këngë bylbyli.

Xhela:

Po fjalës së anmikut të kombit tonë e dhelpnisë së tij ia ka pa sherrin krejt bota.

Plaku:

Krejt botën e ka mashtruar dhe po e mashtron kjo farë *azhdaje*! S`ka qenë çudi që edhe ty me të mashtruar! Po tash kanë dalë do djem tanë me shkollë dhe po shpresojmë se po ia këndojnë edhe atij letrat në xhep. Pa i nxjerrë rrenat hiç për fushë po ia dijnë. Edhe Vahidi e ka vërejtë që aifarë Xheka i kish pasë qitë synin shpisë së juej për me e ble për çarë! Tash ndjeva Xheka paska qejf me ta prishë pasaportën, po ai kot e ka se *pasaportën* për me ardhë këtu s`mundet me ta prishë kurrkushi! *(Qeshin.)*

Vahidi:

Po ai mue më pat thënë se nëse nuk ia shes shtëpinë atij ai do ta shesë të veten. Dhe kur i thash se edhe shpinë e tij do ta blejë mësues Sylja për familje të vet, ai desh plasi!... Më duket se vërtet ka mendjen me u shpërngulë diku në Serbi. Bile po flitet se tashmë veç e ka bërë pazar një truall me shpi atje.

Mësues Sylja:

Po ti çka i the?

Vahidi:

I thashë po më vjen keq ti me u shpërngulë. Ti, me sa di, je banues i vjetër. Kudo që të shkosh ty shqiptar kanë me të thirrë. Mos u përzie ti me *naselenikë e kolonistë*. Veç diçka mbaje mend, i thashë, se disa njerëz tanë të pashkollë e me halle, kur janë shpërngulë në Turqi atje kanë marrë vesh se nuk janë turq po janë shqiptarë. Dhe një serbjan i vjetër që është shpërngulë në Vojvodinë, më ka pasë thënë se atje e ka marrë vesh se nuk ishte si ata, po vërtet ishte shqiptar, ashtu si po u quanin atje dhe se atij ka nisë tash me i ardhë krenari për emnin e shqiptarit!

Mësues Sylja:

Po ata në të vërtetë mund të jenë e disa janë me siguri shqiptarë ortodoksë, po fundi i fundit është punë për ta si e ndiejnë veten! Mjer populli ynë me vetëdije të ulët! I ndarë i përçarë edhe nga feja. Po është e mirë ajo thënia e artë e Vaso Pashës: "*Mos shikoni kisha e Xhamia se feja e shqiptarit është shqiptaria*"! Nëse shqiptari edhe sot, bie fjala, e pranon një fe a një ide a ideologji dhe atë e kupton dhe e respekton si shqiptarë për të mirën e shqiptarisë, feja a ideologjia e tij është e mirë, por nëse hyn në fe a në parti veç me fanatizëm fetar a ideologjik partiak e jo si shqiptar, feja a ideologjia e tij është e dëmshme për shqiptarizëm. Dihet se na, kombësia jonë, ishim shqiptarë edhe para se me na ardhë e me i përçafue këto fe a ideologji!

Vahidi:

I thashë edhe Xhekës, nëse shpërngulesh në Serbi do të na lypësh ne si kojshi, po nuk do të na keshë më!?

Mësues Sylja:

Mirë i paske thanë, veç është dashtë t'ia shtosh edhe këtë se ai ka me ra në zor për ne e na jo kurrë për të.

Xhela:

Shteti i Serbisë e ka rrejtë krejt botën. Po i rren edhe po e mashtron edhe popullin e vet. Po tash s`e di me shqiptarët qysh ka me i dalë pazari?

Ahmeti:

Jo krejt botën, por në radhë të parë disa të parë tanë që edhe sot po i bëhen bisht sakice për me shkatrrue pyllin e familjes së vet! Po tash shpresoj se i kemi çel sytë krejt. Atë që ka thanë Xheka për shpënguljen tonë, ajo ndoshta ka me ndodhë veç atëherë, kur ne të harrojmë me u vu frëngji edhe kullave tona të reja. Veç atëherë kur harrojmë me e përsëritë amanetin që këto kulla t'i ruajnë për jetë e mot e t'i forcojnë dhe t'i zbukurojnë gjithnjë e më shumë! Po nëse na i rrëzon rastësisht farë tërmeti, ne duhet t'i ngrejmë që nga themeli sërish e sërish, po me ata gurët e granitit të lashtësisë, po të përforcuem me armaturë e beton të ri!

Plaku:

Në çdo rast më mirë është me dekë këtu me e pa pushkë në dorë dhe këtu me u bë vorr, se sa në dhe të huej e me t`u bë vorri tyrbe - thojke baba jem!

Xhela:

Vërtet, s` ka më mirë se njeriu me qëndrue në prag të shpisë së vet, në truëll të vendit të vet! Mirëpo, unë po due me thënë diçka tjetër. More, po më vjen mirë edhe po më vjen pak sikeq për diçka: Sa shumë erdhën me ma bë përhajr kthimin në katund, dikush më pruni një kile kafe, dikush një kile sheqer! Dikush atë dikush këtë. Dikushi qingja, po ma kanë pru edhe një dash! Po më shumë i kanë pru plakës pula po edhe knojsi! Ua kthefshim me të mira! S'di se qysh me ua shpërblye me të mira! Po more Ahmet, po më duket se në pleqni po doni me më prishë me plakën, nëse nuk bëhem çoban i dhenve ajo ka me më shti me u bbë çoban i pulave! *(Flet si me të qeshur.)* S'di qysh mundem me i ruejtë ato, s'po di më përpara a pulat a dhentë me i ruejtë?!

Ahmeti:

Leji ato fjalë po na jemi gëzue që na u kthye një vëlla e u bëmë më shumë. Iu ka kthye kullës bylbyli, qysh tha Plaku. Po për ato që po thue ti, nëse s'mundesh me i mbajtë na t`i ruejmë. Na t'i mbajmë qysh i kemi mbajtë deri tash në bylyqet tona. Po në tjetrën anë për ndonjë këndues a pulë, rrunëz a dash, është shumë kollaj. Briskun gjith e mbaj të mprehtë. Veç kallëzona ti kur po do me na bë njëherë një zifafet për qejfi e pastaj vjen rendi mbarë edhe

për të tjerë! Dashin mund ta ruejmë për ndonjë ditë tjetër të bardhë. Por tash është rendi edhe njëherë të çohmi në këmbë e ta bajmë përhapr kullën, së pari Plaku e pastaj unë. (Të gjithë ngrihen në këmbë.)

Plaku:

Për hajr gazmendin e kthimit, ta forcojmë bashkë dashninë dhe kujtimet e mira edhe do t'ua lamë trashëgim brezave. Kjo kullë antike shkëlqeftë gjithmonë! Kullat mos na mbetshin kurrë pa trima, djepat mos na mbetshin kurrë pa foshnja, po as odat mos na mbetshin kurrë pa pleq e pa urtinë e tyne!

Ahmeti:

Urime dhe veprën tonë e trashëgofshin pasardhësit tanë! Bukë e krypë e zemër, sofrat i paçim plot!

Xhela:

Ashtu qoftë! Gjatë pësimeve kam marrë mësim, po tash po e kuptoj më mirë se dashunia dhe mirëkuptimi vëllazënor e bën fuqinë tonë të pathyeshme. Po fjalë unë aq të zgjedhne nuk kam. Le të thotë diçka Vahidi.

Vahidi:

Fuqia dhe besimi në vetvete e kthen mbarë edhe krenarinë e molisur. *Kush prej trollit të të parëve shpërngulet ai gjithmonë ndaj të huejit përulet,* kurse ai që qëndron në truallin e vet edhe nëse hjek e vuan, herdokurë humbës nuk do të jetë se rrezet e shpresës do ta ngrohin dhe do ta ushqejnë edhe me dritën e lirisë. Ne duhet me e forcue dijen e ekonominë, me shkollë e me vim. Duhet të jemi të vyeshëm. Me punë, me dije, me ekonomi të vogël e të madhe besa edhe me organizim e administrim më të mirë ne më së miri dhe me sukses do ta mundim anmikun dhe do ta përparojmë miqëqenien tonë këtu në trojet tona pa qenë nevoja me marrë kurbetin!

Xhela:

Zgjatna Zot më të mira! Mundësona, oj Perëndi, që këso gëzimesh të kemi sa më shumë. Faleminderit!

(Merren ngrykë. Pasi ribëhet përhajrimi. Sjellin llokume e pije. Dikush çon ndonjë gotë: Për jetë e mot! Pastaj ulen. Këngëtarët ia marrin këngës. Vargjet edhe mund të recitohen.)

*Përhajr trim kthimin n` këto troje
T`bëft mirë ujë që pi në këto kroje!
Çdo shqiptar, që i thonë burrë,
trojesh të veta s'zhgulet kurrë...
Po n' këto troje të shqiptarisë
Ia forcon rrajët historisë.
Kush rranjsh zhgulet krejt del fare
I shkon jeta n' vuajtje, n' gajle!
T'i përtërijmë, pra, tonat kulla,
Me këngë të reja: këngë për burra,
T'i mësojmë fëmijët me këqyrë n' frëngjia!
Se pa penë e pushkë s' ruhet trimnia!
Urojmë gratë dhe tonat motra:
Mos me na u shkymë kurr tymi n' votra!*

(Mbyllet perdja, ende vazhdon melodia.) **(Fund.)**

(Ferizaj, mars 1964)